

**Banka Popullore e Republikës së
Maqedonisë së Veriut**



Raporti vjetor i vitit 2021

Shkup, prill 2022

Përmbajtja

Fjala e guvernatorit.....	5
I. Politika monetare në vitin 2021.....	13
1.1. Qëllimet e politikës monetare.....	13
1.2. Pozicionimi i politikës monetare.....	14
II. Ambienti ndërkombëtar	18
III. Zhvillimet makroekonomike në vitin 2021	22
3.1. PBB dhe inflacioni	22
3.2. Tregu i punës	25
3.3. Financat publike.....	28
3.4. Bilanci i pagesave, PIN dhe borxhi i jashtëm	31
3.5. Agregatet monetarë dhe kreditorë	37
3.5.1. Agregatet monetar	37
3.5.2. Aktiviteti kreditues.....	39
IV. Mjedisi makroekonomik dhe politika monetare në vitin 2022 dhe 2024.....	42
V. Instrumentet monetare	45
Shtojca 1. Zhvillimet në tregun valutor dhe ndërhyrjet e Bankës Popullore.....	47
Shtojca 2. Zhvillimet në tregut ndërbankar të depozitave të pasiguara dhe tregu dytësor i letrave në vlerë	50
VI. Menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore	53
6.1. Gjendja dhe ndryshimi i rezervave valutore	53
6.2. Kushtet e tregjeve ndërkombëtare financiare dhe qasje aktive në investimet e rezervave valutore	54
6.3 Struktura e rezervave valutore	55
6.4. Rezultatet nga menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore	58
VII. Shërbimet pagesore dhe sistemet e pagesave.....	60
7.1. Qarkullimi pagesor i realizuar me instrumente të pagesave jo të gatshme.....	61
7.2.1. Transferet kreditore të inicuar nga personat fizik dhe juridik.....	62
7.2.2. Kartelat pagesore	63
7.2. Infrastruktura pagesore.....	64
7.3. Sistemet e pagesave në vend.....	64
7.4. Mbikëqyrja e sistemit të pagesave në pajtim me standardet ndërkombëtare të pranuar.....	65
VIII. Lëshimi dhe menaxhimi i kartëmonedhave dhe monedhave të Republikës së Maqedonisë së Veriut- operacionet e thesarit.....	67

8.1.	Paratë e lëshuara në qarkullim	67
8.2.	Furnizimi i bankave dhe qendrave të parasë me kartëmonedha dhe monedha	69
8.3.	Përpunimi dhe shkatërrimi i kartëmonedhave dhe monedhave	69
8.4.	Eksperizë për paratë e dyshimta /të falsifikuara	69
8.5.	Kontrolli i zbatimit të standardeve dhe kriterëve për punë me para në dorë te bankat dhe qendrat e parasë	71
8.6.	Shitja e monedhave për qëllime koleksionimit.....	71
IX.	Auditimi i brendshëm.....	72
9.1.	Puna e Komitetit për auditim.....	72
X.	Menaxhimi me resurset njerëzore	74
XI.	Menaxhimi me rreziqet në Bankën Popullore në vitin 2021	76
11.1.	Rreziqet strategjike.....	76
11.2.	Rreziqet operative.....	76
11.3.	Menaxhimi me rreziqe në kohë krize.....	78
11.4.	Rreziqet financiare	79
11.5.	Rreziqet nga ndryshimet klimatike.....	79
XII.	Realizimi i Programit për punën për vitin 2021	81
	Qëllimi strategjik 1 - Ruajtja e stabilitetit të çmimeve përmes kursit stabil të denarit kundrejt euros.....	83
	Qëllimi strategjik 2 - Ruajtja e sistemit bankar stabil dhe të sigurt, si parakusht themelor për stabilitetin financiar dhe rritje të qëndrueshme ekonomike të vendit.....	84
	Shtojca 3. Përmirësimi i vazhdueshëm i rregullativës bankare dhe supervizionit ër shkak të harmonizimit me dispozitat e Bashkimit Evropian	84
	Qëllimi strategjik 3 - Ruajtja dhe menaxhimi i rezervave valutore në përputhje me parimet e sigurisë dhe likuiditetit dhe sigurimi i kthimit optimal.....	89
	Qëllimi strategjik 4 - Rritja e efikasitetit të sistemit të furnizimit dhe përpunimit të kartëmonedhave dhe monedhave dhe rritja e cilësisë dhe funksionalitetit të parave të gatshme në qarkullim.....	89
	Qëllimi strategjik 5 - Funksionimi i sigurt dhe efikas i sistemeve të pagesave dhe zhvillimi i tregut të shërbimeve të pagesave	90
	Qëllimi strategjik 7 - Nxitja dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i veprimtarisë hulumtuese në fushat që janë vendimtare për arritjen efikase të qëllimeve të Bankës Popullore.....	91
12.1.	Komunikimi me publikun	96
12.2.	Edukim dhe inkluzion financiar	97
12.3.	Puna e muzeut, bibliotekës dhe arkivit.....	98
12.4.	Strategjia dhe preventiva	99
12.5.	Aktivitete të tjera të korporatës.....	102
	Qëllimi strategjik 11 - Ruajtja e sistemi informativ stabil dhe përmirësimi i tij në përputhje me kapacitetet ekzistuese dhe standardet ndërkombëtare	103

Fjala e guvernatorit

Të nderuar,

Nëse viti paraprak ishte vit i ballafaqimit me pasojat e drejtpërdrejta nga kriza shëndetësore, për vitin 2021 mund të thuhet se është vit i rimëkëmbjes graduale pas goditjes së parë të pandemisë. Për dallim nga kriza paraprake globale, që shkaktoi pasoja në periudhë më të gjatë, kriza e koronës ka shkaktuar pasoja të shpejta dhe të ashpra, me efekt fillestar më të madh dhe më të përhapur në krahasim me krizën botërore financiare, por me rimëkëmbje më të shpejtë që vazhdon edhe gjatë vitit 2022. Megjithatë, rimëkëmbja ekonomike u ballafaqua edhe me sfidat e nevojës për riaktivizim të masave për mbrojtjen e shëndetit, në kushte të llojeve të reja të virusit korona. Lëvizjet e këtilla në suaza globale shkaktuan ndërprerje në zinxhirin e furnizimit, që solli rimëkëmbje të ngadalshme të prodhimitarisë industriale dhe rritjen e çmimeve të produkteve themelore në bursat botërore, para se gjithash të naftës dhe produkteve ushqimore ndërsa muajt e fundit të vitit kishte rritje të konsiderueshme edhe të çmimit të energjisë elektrike dhe gazit. Në rrethana të këtilla, fundi i vitit u shënuar me debat lidhur me rreziqet për inflacion në nivel global.

Këto lëvizje globale ishin të dukshme edhe në ekonominë vendore gjatë vitit 2021. Shikuar për gjithë vitin 2021, ekonomia ka regjistruar rritje reale prej 4%, që është brenda pritjeve nga projekcioni i tetorit (3.9%). Ekonomia e Maqedonisë, e cila është e varur nga importi, si për nevojat e prodhimit, ashtu edhe për konsumin, ndjeu efektet e rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe kishte lëvizje në rritje të inflacionit, sidomos në fund të vitit. Gjithashtu, norma e inflacionit për tërë vitin 2021 ishte mesatarisht 3,2% dhe ishte brenda pritjeve sipas projeksioneve të ciklit për tetorin.

Realizimet në planin makroekonomik janë vërtetim për marrjen e duhur të vendimeve monetare në vitin paraprak, duke i arritur qëllimet ligjore të Bankës Popullore. Gjithashtu, është kyç që theksohet se Banka Popullore ka mundur mbajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe stabilitetit të valutës vendore dhe sistemit bankar, si investim për mirëmbajtjen e stabilitetit makroekonomik.

Politika monetare gjatë tërë vitit mundësonte mbajtjen e kushteve të volitshme për realizimin e rritjes ekonomike. Norma e interesit e instrumentit bazë, bono thesaret, në fillim të vitit u ul në nivelin 1,25%, gjë që forcoi efektin e masave lehtësuese monetare nga viti paraprak. Në këtë mënyrë, kemi mundur uljen e mëtejshme të kostove të kredive për sektorin e korporatave dhe popullatën, për mbështetjen e mëtejshme të aktivitetit investues dhe konsumin. Kështu, aktiviteti kreditues është përshpejtuar këtë vit, duke arritur rritje prej 8,3% në fund të vitit. Kjo sigurisht që është rezultat i pozitës së fortë të kapitalit dhe likuiditetit të sistemit bankar para pandemisë, por edhe reagimit të shpejtë dhe të fortë të Bankës Popullore me masat e marra për lehtësimin e kushteve financiare në ekonominë vendore dhe rritjen e likuiditetit të bankave. Aktivitetet e bankave u mbështetën me rritje solide të bazës së depozitave, ku në bazë vjetore depozitat e përgjithshme në muajin dhjetor ishin më të larta për 7,5%, që është mbi rritjen vjetore (prej 7,1%) e projektuar për tremujorin e katërt të vitit 2021.

Fondi Ndërkombëtar Monetar ka arritur në përfundimin se është arritur udhëheqje përkatëse dhe menaxhim me sfidat e rimëkëmbjes ekonomike nga **kriza shëndetësore nga ana e Bankës Popullore**, në suazat e raportit të rregullt për misionin e vlerësimit të nenit 4. Gjithashtu, raporti ka vërtetuar pozicionimin e duhur të politikës monetare dhe qëndrueshmërinë e mbajtur të kursit valutor si spirancë e stabilitetit të ekonomisë vendase. Në këtë drejtim janë edhe lëvizjet e rezervave valutore, të cilat mbahen në nivele të përshtatshme për të mbështetur stabilitetin e valutës vendore. Mbështetje shtesë dhe likuiditet të mjaftueshëm devizor ofron repo-linja bilaterale e vendosur me Bankën Qendrore Evropiane, e cila është konfirmim i vlerësimeve pozitive të këtij institucioni lidhur me kapacitetin e Bankës Popullore për të kryer politika të duhura në kuadër të kompetencave të saj.

Vitin e kaluar morëm vërtetim domethënës në lidhje me përpjekjet tona të vazhdueshme për të përcaktuar kornizë rregullatore që mundëson sistem bankar tregu dhe konkurrues në pajtim me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Kjo njohje erdhi nga Komisioni Evropian, i cili miratoi vendim ku thuhet se vendi jonë ka krijuar kornizë mbikëqyrëse dhe rregullatore për themelimin dhe funksionimin e bankave, që është në përputhje me standardet e përcaktuara në Bashkimin Evropian. Me këtë vendim, vendi jonë përfshihet në listën e 26 vendeve në botë, së bashku me vende si Japonia, Kanadaja, Zelanda e Re, Japonia, SHBA, për të cilat është vërtetuar se rregullativa dhe mbikëqyrja e tyre është e barabartë me rregullativën dhe mbikëqyrjen e Bashkimit Evropian. Vlerësimi përcakton se rregullativa dhe mbikëqyrja e brendshme mundëson ruajtjen e stabilitetit dhe integritetit të sistemit financiar, mbrojtjen efikase dhe adekuate të përdoruesve të shërbimeve financiare, bashkëpunimin ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm në tregun financiar, pavarësinë dhe efikasitetin e mbikëqyrjes dhe zbatimin efikas të standardeve ndërkombëtare. Marrja e trajtimit ekuivalent është i rëndësishëm për sa i përket perceptimeve të investitorëve potencial dhe lidhjes më të lehtë dhe më efikase të sistemit bankar vendor me tregjet financiare ndërkombëtare. Vlerësimi pozitiv lehtëson qasjen e institucioneve vendore deri në tregun financiar ndërkombëtar, sjell përparësi në udhëheqjen e politikës monetare të Bankës Popullore dhe lehtëson bashkëpunimin me organet mbikëqyrëse në BE.

Ky vlerësim i Komisionit Evropian është arritje e jashtëzakonshme e Bankës Popullore, por është edhe tregues i rëndësishëm i kushteve të operimit të sektorit bankar vendor gjegjësisht është vërtetim shtesë i kriterëve të rrepta dhe të kujdesshme të funksionimit, për të mbrojtur qytetarët tanë si përdorues të shërbimeve bankare. Mbrojtja e shfrytëzuesve të shërbimeve bankare është një nga aktivitetet që po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme në agjendën e aktiviteteve të Bankës Popullore. Për këtë qëllim, **e kemi rritur transparencën** sa i përket karakteristikave të produkteve më përfaqësuese të kredive dhe depozitave për persona fizik, duke i publikuar këto të dhëna në faqet e të gjitha bankave dhe kursimoreve, por edhe në mënyrë qendrore në faqen e Bankës Popullore. Përkundër praktikës paraprake kur bankat dhe kursimoret zgjidhnin individualisht se cilat të dhëna t'i publikojnë për produktet e tyre dhe në çfarë forme, me qasjen e re të unifikuar të të gjithë sistemit bankar, qytetarëve u mundësohet informacion më i saktë dhe më i plotë për aspektet më të rëndësishme, që duhet të merren parasysh gjatë shqyrtimit të kredive dhe depozitave individuale, për të zgjedhur produktin e duhur, duke pasur parasysh edhe rreziqet e mundshme. Ky aktivitet është pjesë e aktiviteteve të parashikuara me **Strategjinë për edukim financiar dhe përfshirje financiare 2021 - 2025**, që e miratua si kornizë strategjike për veprim me rregullatorët e tjerë financiar. Ky është dokument jashtëzakonisht i rëndësishëm që do të sigurojë qasje sistematike për të gjitha palët e përfshira në mënyrë që të forcohet edukimi financiar i

popullatës, të përmirësohet niveli i përfshirjes financiare, duke siguruar njëkohësisht mbrojtjen e duhur të konsumatorëve. Prandaj edhe është miratuar **Kodi i praktikave të mira për edukim financiar**, me të cilin janë vendosur parimet që duhet të zbatohen nga të gjitha subjektet e përfshira nga sektori publik, privat dhe civil në zbatimin e edukimit financiar. Po ashtu, në fund të vitit në kuadër të Bankës Popullore kemi themeluar një njësi organizative që do të kryejë aktivitete sistematike të punës në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe edukimit financiar të popullatës.

Duke parë se përfshirja më e madhe financiare e popullatës është e mundur përmes zbatimit të shërbimeve financiare digjitale, si dhe përmes aplikimit të shërbimeve fintek, Banka Popullore ka nxitur zhvillimin e versionit të parë të Strategjisë nacionale për mbështetjen e sektorit fintek. Aktivitetet në këtë fushë vazhdojnë në fillim të vitit 2022 kur nënshkruam Memorandumin e bashkëpunimit në fushën e sektorit fintek ndërmjet rregullatorëve financiar. Ky memorandum vendos sistem përmes të cilit rregullatorët do të veprojnë në mënyrë të koordinuar, secili në kompetencën e tij në lidhje me zbatimin e strategjisë nacionale për mbështetjen e sektorit fintek.

Banka Popullore kujdes i ka kushtuar kujdes edhe rritjes së vetëdijes për financat e gjelbra. Për këtë qëllim, kemi identifikuar financat e gjelbra si objektiv strategjik dhe i jemi bashkuar rrjetit ndërkombëtar të financave të gjelbra të bankave qendrore. Duke ndjekur tendencat globale për zhvillimin e ekonomive të vendeve, si dhe nevojat për marrjen parasysh të ndryshimeve klimatike që mund të ndikojnë në çmimet dhe stabilitetin financiar, në vitin 2021 është kryer anketë midis bankave tregtare për aplikimin e deritanishëm të konceptit "financat e gjelbra". Sipas rezultateve të anketës, rreth 70% e bankave miratojnë kredi për projekte që kanë ndikim pozitiv në mjedis, ndërsa rreth 43% e bankave kanë vendosur sistem formal për identifikimin e projekteve të gjelbra. Pjesëmarrja e kredive të gjelbra është rreth 150 milionë euro, ose vetëm 2,5% e kredive të përgjithshme. Kjo përqindje relativisht e ulët e këtyre kredive tregon nevojën për forcimin e mëtejshëm të aktiviteteve të Bankës Popullore në këtë segment, që qëndron në detyrat programore të planifikuara për vitin 2022, sipas të cilave parashikohet mbledhja më e hollësishme e të dhënave, analiza e rrezikut nga ndryshimet klimatike për sistemin bankar dhe përgatitjen e udhëzimeve për bankat për financat e gjelbra si dhe planifikimin e testimit të stresit të qëndrueshmërisë së sistemit bankar ndaj ndryshimeve klimatike.

Disponueshmëria e statistikave cilësore dhe të verifikuara është një nga parakushtet për marrjen e vendimeve cilësore si nga politikëbërësit ashtu edhe nga sektori i korporatave dhe qytetarët. Në këtë kuptim, Banka Popullore ka vazhduar me realizimin e projekteve në vitin e kaluar për përmirësimin e të dhënave statistikore në dispozicion. Gjithashtu, përfundoi me sukses projekti për harmonizimin e mëtejshëm të statistikës së llogarive financiare me standardet e Sistemit evropian të bankave qendrore dhe Bankës Qendrore Evropiane. Ky projekt ishte pjesë e **tuining- projektit "Përforcimi i kapacitetit institucional të Bankës Popullore në rrugën drejt anëtarësimit të sa në sistemin evropian të bankave qendrore"**, që u përfundua në mars të vitit 2021. Qëllimi kryesor i tuining- projektit i financuar nga Bashkimi Evropian (BE) ishte që të mbështetet banka jonë qendrore në harmonizimin e mëtutjeshëm të rregullave, rregullativës, politikave dhe punën me standardet e sistemit evropian të bankave qendrore (SEBQ) dhe me praktikat më të mira ndërkombëtare, për shkak të ruajtjes së mëtutjeshme të stabilitetit makroekonomik dhe financiar. Krahas statistikës, me këtë projekt janë përfshirë edhe aktivitetet në fushën e sistemit pagesorë, mbikëqyrjes bankare dhe analizës së politikave.

Në vitin 2021, Banka Popullore ka vazhduar të forcojë transparencën në punën e saj duke vendosur mekanizma dhe praktika të reja. Në këtë fushë, kemi bërë një hap më tej dhe kemi nisur mision vlerësimi nga Fondi Monetar Ndërkombëtar për të studiuar dhe krahasuar praktikën dhe proceset tona për sigurimin e transparencës në operacione me standardet e parashikuara në Kodin e transparencës të FMN-së, të miratuara në korrik të vitit 2020. Jemi një nga dy bankat në botë ku Fondi Monetar Ndërkombëtar ka bërë vlerësim të tillë dhe sipas zbulimeve të FMN-së, zbatojmë praktika të avancuara për sa i përket transparencës ndërsa Banka Popullore gëzon besim të lartë nga publiku, falë politikave të qëndrueshme që mundësojnë stabilitet makroekonomik. Për ne, transparenca në operacionet dhe komunikimet me publikun është prioritet i lartë, sepse sa më lehtë të kuptohen vendimet e politikës monetare, aq më i madh është efikasiteti dhe efektiviteti i arritjes së qëllimeve të përcaktuara. Kështu që, Banka Popullore, në pajtim me Planin strategjik 2022 - 2024 si një nga qëllimet strategjike ka treguar marrjen e aktiviteteve për informim në kohë për vendimet, aktivitetet, perceptimet dhe vlerësimet e Bankës Popullore, të cilat janë të rëndësishme për subjektet ekonomike dhe qytetarët, duke përfshirë proceset e vendimmarrjes. Për këtë qëllim është planifikuar të zbatohet Projekti për promovimin e transparencës dhe informacionit të disponueshëm për funksionet, aktivitetet dhe operacionet e Bankës Popullore, në pajtim me rekomandimet e misionit të FMN-së si dhe të kryhet sondazh për strategjinë e komunikimit të bankës dhe organizimin e seminareve dhe takimeve të shkurtra me gazetarë.

Këto janë vetëm disa nga të sukseset dhe projektet që i kemi arritur në vitin paraprak dhe së bashku me aktivitetet e rregullta mundësojnë realizimin e qëllimeve ligjore të Bankës Popullore si dhe qëllimet që i kemi vendosur si parakushte të nevojshme që i krijojmë për funksionimin tonë më të mirë dhe më efikas të sistemit bankar për mirëqenien e të gjithë ekonomisë.

Të nderuar,

Banka Popullore, përmes punës ekipore dhe punës mirë të koordinuar, në vitet e fundit ka arritur të përballët me sukses me sfidat e paprecedentë të imponuara nga mjedisi global. Jetojmë në një kohë kur po ndodhin shumë tronditje në rrethin tonë ku kemi nevojë për mbështetje të fortë të ekipit për të përballuar goditjet që mund të na ndodhin. Besoj se në vitin 2021 konfirmuam se kapacitetet e ndërtuara nga Banka Popullore janë shfrytëzuar në mënyrë aktive për zbatimin cilësor të kompetencave tona dhe për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik si mjedis më i përshtatshëm për rritje ekonomike. Megjithatë, për rritje më të shpejtë dhe më të qëndrueshme, është e nevojshme përfshirja e plotë e të gjitha institucioneve përkatëse, të cilat përmes zbatimit të vazhdueshëm të reformave strukturore do të kontribuojnë në rritjen e potencialit të rritjes. Përmirësimi i infrastrukturës ekonomike, sociale dhe digjitale gjegjësisht krijimi i parakushteve për ndërtimin e një infrastrukture të tillë është imperativ për të siguruar rritje jo vetëm më të lartë, por edhe më cilësore të nxitur nga sektorë teknologjikisht të sofistikuar dhe inovativ. Të gjithë duhet të lëvizim në atë drejtim në periudhën e ardhshme.

26 prill 2022

Shkup

Guvenator
dhe kryesues i Këshillit të
Bankës Popullore
dr. Anita Angellovska - Bezhoska

Pasqyrë e shkurtër e zhvillimeve makroekonomike në vitin 2020

Rimëkëmbja e pritshme ekonomike e ekonomisë globale filloi në vitin 2021, pas pandemisë së koronavirusit që u shfaq në vitin 2020 që çoi në rënie të aktivitetit ekonomik global, në rënie të kërkesës dhe si pasojë në ngadalësim të ekonomive në mbarë botën. Pavarësisht lehtësimit gradual të masave parandaluese shëndetësore që krijuan kushte për rimëkëmbjen ekonomike, viti 2021 ishte një tjetër vit pandemie, i shënuar nga lloje të reja të koronavirusit, por edhe nisi një proces i imunizimit masiv, i cili dha njëllot optimizmi për tejkalimin e kësaj krize shëndetësore. Ekonomikisht, në vitin e dytë të pandemisë u realizuan disa nga rreziqet që lidhen me zinxhirët e furnizimit global dhe çmimet e produkteve bazë në tregjet botërore.

Rimëkëmbja e ekonomisë maqedonase filloi në tremujorin e dytë të vitit 2021. Konkretisht, rënia e vogël në tremujorin e parë u pasua nga një rritje e ndjeshme në tremujorin e dytë, në pajtim me bazën e ulët krahasuese nga viti paraprak, dhe më pas me rritje mesatare në dy tremujorët e ardhshëm, gjë që mundësoi rritjen reale vjetore të PBV-së në vitin 2021 prej 4%. Rimëkëmbja ka ardhur kryesisht si pasojë e kërkesës së brendshme, veçanërisht konsumit dhe investimeve personale, të mbështetur nga një mjedis më i favorshëm, nga stimuli i fortë fiskal si dhe nga udhëheqja e qetë e mëtejshme e politikës monetare. Nga ana tjetër, eksporti- neto pati kontribut negativ në PBV, duke përshpejtuar importet, veçanërisht në tremujorin e fundit, pjesërisht nën presionin dhe krizën energjetike.

Gjatë vitit 2021, inflacioni mesatar u përshpejtua mesatarisht, kryesisht si pasojë e lëvizjes së çmimeve botërore të mallrave, veçanërisht të ushqimeve dhe energjisë. Mesatarisht, në vitin 2021, rritja vjetore e çmimeve është 3,2%, krahasuar me rritjen prej 1,2% një vit më parë. Presionet mbi çmimet vijnë kryesisht nga rritja e çmimeve të produkteve themelore, veçanërisht të shprehura në fund të vitit, dhe kryesisht vijnë nga faktorë global në anën e ofertës, pa presione më të mëdha nga kërkesa. Pasiguria në lidhje me ndryshimet e çmimeve është ende e theksuar, në pajtim me efektet e pasigurta ekonomike që lidhen me zhvillimin dhe menaxhimin e pandemisë, si dhe pasigurinë në rritje në tregjet botërore të energjisë, e forcuar më tej nga rreziqet gjeopolitike në Evropën Lindore që u shfaqën në muajt e parë të vitit 2022.

Në vitin 2021, në llogaria rrjedhëse është realizuar deficit mesatar prej 3,5% të PBV-së, që është pothuajse në nivelin e vitit të kaluar, me lëvizje të kundërta në komponentët bazë krahasuar me vitin e kaluar. Përndryshe, këtë vit deficiti tregtar është zgjeruar, pjesërisht për shkak të forcimit të aktivitetit ekonomik, rritjes së çmimeve të energjisë dhe ndërprerjeve në zinxhirët e furnizimit global ndërsa nga ana tjetër, ndryshe nga një vit më parë, kishte normalizim të transferimeve private, në pajtim me masat e relaksuara për lëvizje tej-kufitare në vitin e dytë të pandemisë Rezervat valutore janë ruajtur në nivel të përshtatshëm, duke u rritur më tej kryesisht në bazë të hyrjes nga eurobondi i ri i Qeverisë, shpërndarjes së MPS-ve të reja nga FMN-ja, ndihmës makrofinanciare nga Bashkimi Evropian dhe pagesave të bëra për eurobondet e arritura jashtë vendit. Investimet e huaja direkte janë rritur në 3,7% të PBV-së.

Sistemi bankar karakterizohet nga një nivel i ulët i plasimeve jofunksionale, përfshirë edhe pas përfundimit të periudhës së zgjatjes së kredive për shkak të pandemisë, duke

ruajtur pozicion solid të likuiditetit dhe kapitalit. Lëvizjet pozitive në depozitat dhe kreditë e bankave vazhduan edhe gjatë vitit 2021 (rritje vjetore përkatësisht 7,5% dhe 8,3%, në mënyrë përkatëse). Megjithatë, gjatë pandemisë, ka pasur ndryshim të prirjeve të subjekteve ekonomike, në favor të një kontributi më të madh të kursimeve në valutë të huaj, që zakonisht është në periudha pasigurie, duke sjellë ngadalësim mesatar të trendit shumëvjeçar të denarizimit të depozitave bankare. Është e rëndësishme të theksohet rritja e kreditimit për sektorin e korporatave, krahasuar me një vit më parë, si mbështetje për rimëkëmbje ekonomike.

Në kushtet e inflacionit mesatar, pozicionit të jashtëm solid dhe rreziqeve të imponuara të pandemisë në suaza globale dhe nacionale, Banka Popullore vazhdon të zbatojë politikë të përshtatshme monetare. Pas uljes gjatë vitit 2020, norma bazë e interesit u ul më tej për 0,25 %, në mars të vitit 2021 dhe bë 1,25%, që është niveli më i ulët në histori. Masat monetare të marra gjatë pandemisë, përfshirë masën për zgjatjen e shlyerjes së kredive për sektorin privat (që përfundoi gjatë vitit 2021), kontribuuan në ruajtjen e mbështetjes solide të kredive gjatë pandemisë. Sipas rimëkëmbjes së aktivitetit ekonomik, ka pasur lëvizje më të favorshme në tregun valutor, ku shitjet neto të realizuara në valutë nga Banka Popullore kanë qenë dukshëm më të ulëta në krahasim me vitin 2020, duke reflektuar kryesisht ndikimin e krizës energjetike në tremujorin e fundit të vitit. Gjithashtu, për të përballuar pasojat e krizës së koronës, është veçanërisht e rëndësishme të vihet në dukje qasja e miratuar në likuiditet valutor në euro, që i është mundësuar Bankës Popullore nga Banka Qendrore Evropiane, fillimisht deri në qershor 2021 e më pas u vazhdua deri në mars të vitit 2022 (ku këto fonde nuk janë përdorur). Në mars të vitit 2022, duke marrë parasysh rreziqet gjeopolitike, BQE miratoi vazhdim të ri të repo-linjës deri më 15 janar të vitit 2023.

Rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik në periudhën pas pandemisë mbetet detyrë prioritare për politikëbërësit makroekonomik. Megjithatë, duke pasur parasysh përzierjen e pavoritshme të rrethanave në mjedisin global, zhvillimet makroekonomike do të vijojnë të shoqërohen me pasiguri. Rreziqet për periudhën e ardhshme janë pjesërisht të lidhura me pasojat e pandemisë në nivel nacional dhe global si dhe me pasigurinë në lidhje me kohëzgjatjen e krizës shëndetësore dhe shpejtësinë e procesit të vaksinimit. Gjithashtu, në fund të vitit 2021 dolën në pah ndërprerjet e zinxhirëve të furnizimit global, presionet e shtuara të inflacionit dhe kriza energjetike. Tendenca të tilla të pavoritshme dhe efektet e tyre në ekonomi vlerësohen si të përkohshme, me pritshmëri për stabilizim të tyre gjatë vitit 2022. Megjithatë, përshkallëzimi i krizës ruso-ukrainase dhe armiqësive në muajt e parë të vitit 2022 është faktor i ri, i papritur dhe i pavoritshëm gjeopolitik, i cili imponon rreziqe serioze për ekonominë globale, duke pasur parasysh pasigurinë e përgjithshme në rritje dhe ndikimin e mundshëm në kërkesën globale për energji dhe thellimin e krizës energjetike. Banka Popullore mbetet e fokusuar në përcaktimet për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe stabilitetin e kursit të këmbimit të denarit, përmes përdorimit të të gjitha instrumenteve në dispozicion.

Treguesit bazë ekonomike për ekonominë e Maqedonisë.

ndryshimet vjetore, në %	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Sektori real														
Prodhimi bruto i brendshëm *	5,5	-0,4	3,4	2,3	-0,5	2,9	3,6	3,9	2,8	1,1	2,9	3,9	-6,1	4,0
Inflacioni	8,3	-0,8	1,6	3,9	3,3	2,8	-0,3	-0,3	-0,2	1,4	1,5	0,8	1,2	3,2
Norma e papunësisë	33,8	32,2	32,1	31,4	31,0	29,0	28,0	26,1	23,7	22,4	20,7	17,3	16,4	15,7
Sektori i jashtëm														
Bilanci në logarinë rrjedhëse (% të PBB)	-12,7	-6,8	-2,0	-2,5	-3,2	-1,6	-0,5	-2,0	-2,9	-1,0	-0,1	-3,3	-3,4	-3,5
Bilanci tregtar (% të PBB)	-28,6	-25,8	-21,6	-25,2	-26,5	-22,9	-21,7	-20,1	-18,8	-17,8	-16,2	-17,3	-17,0	-20,2
Investimet direkte të huaja (% të PBB)	6,0	2,0	2,2	4,6	1,7	2,8	2,3	2,2	3,3	1,8	5,6	3,2	1,5	3,7
Borxhi i jashtëm bruto (% të PBB)	48,8	55,9	57,8	61,2	66,1	64,0	70,0	69,3	74,7	73,4	73,0	72,4	80,3	80,2
Bruto rezervat valutore (në milionë EUR)	1494,9	1597,5	1714,5	2068,9	2193,3	1993,0	2436,5	2261,8	2613,4	2336,3	2867,1	3262,6	3359,9	3643,3
Sektori monetar														
Pesha e parave (M4)	11,8	5,7	12,1	9,5	4,4	5,2	10,6	6,9	6,2	5,1	11,8	9,3	6,9	7,0
Gjithsej kredite	34,4	5,2	7,0	8,4	5,6	6,6	10,0	9,6	6,5***	5,4	7,3	7,6***	4,7	8,3
Gjithsej depozita (me depozita në para)	8,9	17,8	12,8	9,1	4,4	5,4	10,5	6,4	6,1	5,0	12,1	9,0	5,7	7,5
Sektori fiskal														
Saldoja buxhetore (% të PBB)	-0,9	-2,6	-2,4	-2,5	-3,8	-3,8	-4,2	-3,5	-2,7	-2,7	-1,8	-2,0	-8,2	-5,4
Borxhi publik (% të PBB)	23,0	26,2	27,2	32,0	38,3	40,3	45,8	46,6	48,8	47,7	48,4	49,2	61,0	60,8
Sektori bankar														
Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (%)	16,2	16,4	16,1	16,8	17,1	16,8	15,7	15,5	15,2	15,7	16,5	16,3	16,7	17,3
Kreditet jofunkionale në sektorin jofinanciar/bruto kreditet (%)	6,8	9,1	9,3	9,9	10,5	11,5	11,3	10,8	6,6	6,3	5,2	4,8	3,4	3,2
Aktiva likuide / aktiva totale (%)	22,9	25,6	30,9	31,2	32,4	31,2	29,8	28,2	28,9	27,1	26,7	26,9	23,3	23,0

Burimi: BPRMV, ESHS, Ministria e Financave.

* Të dhënat paraprake për vitin 2020, të dhënat e vlerësuara për vitin 2021.

** Pa detyrime të qeverisë monetare (pa repo kontrata)

*** E korrigjuar për shlyerjet.


I. Politika monetare në vitin 2021

1.1. Qëllimet e politikës monetare


Ruajtja e stabilitetit të çmimeve paraqet objektivin themelor ligjor të politikës monetare të Bankës Popullore. Një objektiv tjetër, në varësi të qëllimit kryesor, është të kontribuojë në mbajtjen e një sistemi të qëndrueshëm, konkurrues dhe financiar të orientuar drejt tregut. Banka Popullore e mbështet politikën e përgjithshme ekonomike pa rrezikuar arritjen e qëllimit bazë dhe në përputhje me parimin e një ekonomie të tregut të hapur me konkurrencë të lirë. Në aspekt strategjik, nga tetori i vitit 1995 e deri më vitin 2001 e aplikon strategjinë e ruajtjes së stabilitetit të kursit të këmbimit nominal të denarit në raport me markën gjermane dhe më pas në raport me euron.

Nisur nga këto dispozita ligjore, Banka Popullore gjatë vitit 2021 ka përshtatur politikën monetare për të siguruar vazhdimësi në arritjen e synimeve të definuara ligjore, edhe pse akoma ka rrezik dhe pasiguri të shkaktuara nga pandemia e covid-19. Banka Popullore i realizoi me sukses objektivat e politikës monetare, gjë që shihet në ruajtjen e mëtejshme të stabilitetit të çmimeve dhe stabilitetit të kursit valutor. Shikuar nga aspekti i stabilitetit të çmimeve, mesatarisht për gjithë vitin 2021 është realizuar rritje e moderuar vjetore e çmimeve të brendshme prej 3,2%. Presionet e çmimeve vijnë kryesisht nga faktorët në kahun e ofertës, në kushtet e lëvizjes më të theksuar rritëse të çmimeve të energjisë dhe komponentëve ushqimorë (në ndikim të rritjes së çmimeve të importit), ndërsa më e moderuara në inflacionin bazë në mungesë të presioneve më të larta nga kërkesat vendore. Stabiliteti i kursit valutor është ruajtur, ashtu që të gjitha treguesit e mjaftueshmërisë së rezervave valutore ende janë në zonë të sigurt. Në vitin 2021, stabiliteti financiar u ruajt me sukses, si mbështetje shtesë në arritjen e qëllimit bazë. Në kushte të nivelit adekuat të rezervave valutore dhe normës së moderuar të inflacionit, Banka Popullore gjatë vitit 2021 vazhdoi me lehtësimin e politikës monetare, me qëllim të ruajtjes së flukseve kreditore dhe mbështetjes së rimëkëmbjes së ekonomisë së Maqedonisë, në kushtet e tej zgjatjes së pandemisë.

Grafikoni 1
Hendeku i prodhimit dhe inflacioni*




Grafikoni 2
Rezervat valutore bruto



* Hendeku i prodhimit paraqet indikatorin për gjendjen ciklike të ekonomisë dhe përllogaritet si raport në mes të shmangies së PBB së realizuar nga PBB potenciale dhe nivelit të PBB potencial, $(\text{hendeku i prodhimit} = (\text{PBB i realizuar} - \text{PBB potencial}) / \text{PBB potencial})$. Inflacioni i përgjithshëm bazë paraqet ndryshimin mesatar vjetor (në %).


Grafikoni 3

Treguesit e mjaftueshmërisë së rezervave valutore



Grafikoni 4

Treguesit e zgjedhur për stabilitetin financiar



* Sipas rregullës së Grinspan dhe Guidotit (Greenspan-Guidotti rule) është e nevojshme që vendi të ruaj mbulimin e plotë të borxhit afatshkurtër (maturimi rezidual) me rezervat valutore.

** Aktivi likuid përbëhet nga aktivi me likuiditet më të lartë dhe depozitave afatshkurtra të afatizuara te bankat e huaja. Aktivi gjithsej nuk i inkorporon mjetet te bankat vendore.

*** Treguesi u referohet kredive të sektorit financiar dhe jofinanciare, me çka të dhënat për vitin 2016 i përfshinë ndryshimet nga rregullatorëve.
Burimi: BPRMV dhe ESHS

1.2. Pozicionimi i politikës monetare

Banka Popullore vazhdoi me lirimin e politikës monetare edhe gjatë vitit 2021, gjë që kontribuoi në lehtësimin e mëtejshëm të kushteve financiare dhe mbështetjen e mëtejshme të ekonomisë vendase, në kushtet e pasigurisë për ecurinë e krizës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga covid-19. Banka Popullore uli normën bazë të interesit gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, duke e ulur atë në nivelin më të ulët historik prej 1,25%, ndërsa në të njëjtën kohë duke mbajtur shumën e ofruar e boneve të thesarit në nivel prej 10.000 milionë denarë. Në të njëjtën kohë, në shkurt të vitit 2021, Banka Popullore miratoi një vendim që kufizoi përkohësisht shpërndarjen dhe pagesën e dividendëve për aksionarët e bankave dhe kursimoreve, deri në gusht, kur vendimi u shfuqizua. Qëllimi i vendimit të përmendur ishte të kontribuonte në rritjen e mëtejshme të qëndrueshmërisë së sistemit bankar dhe ruajtjen e stabilitetit, në kushtet e pasigurisë dhe efekteve të zgjatura të pandemisë. Vendosja e tillë e politikës monetare kontribuoi në mbështetjen e flukseve të kredisë në ekonomi dhe në rritjen e likuiditetit në sistemin bankar, në një nivel solid rezervash valutore dhe presione të moderuara inflacioniste. Totali i depozitave dhe kredive vijon edhe më tej të rritet me bazë vjetore, pavarësisht pranisë së pasigurisë aktuale pandemike. Banka Popullore monitoron nga afër treguesit dhe rreziqet e mundshme nga mjedisi i brendshëm dhe i jashtëm, për të përshtatur në mënyrë adekuate vendosjen e politikës monetare.

Rrethanat për zbatimin e politikës monetare në vitin 2021 imponuan një karakter të përshtatshmërisë së politikave, për të mbështetur rimëkëmbjen e ekonomisë së Maqedonisë, edhe përkundër që akoma ekziston pasiguria nga pandemia e shkaktuar nga covid-19. Banka Popullore ishte e pranishme në tregun valutor, me ndërhyrje të moderuara për shitjen e valutës. Depozitat e familjeve shënuan rritje, e cila erdhi si pasojë e frenimit nga shpenzimet në kushtet e pasigurisë nga zhvillimi i pandemisë, në kushtet e rritjes së të ardhurave të disponueshme.


Niveli i përgjithshëm i çmimeve në vitin 2021 shënoi rritje mesatare vjetore prej 3.2%, që më së shumti rezulton nga rritja e çmimeve të të gjitha komponentëve kryesore, ndërsa më i shprehur te komponenti energjetik. Realizimi i tillë është në përputhje me normën e parashikuar të inflacionit për vitin 2021 nga projeksionet e tetorit, gjatë të cilit

është bërë një rishikim në rritjen e normës së pritshme me vlerësimet e prillit. Lëvizjet e epërme të inflacionit tek ne, si dhe në kornizë globale, i reflektohet faktorëve global nga ana e ofertës, pa presione të mëdha nga ana e kërkesave.

Aktiviteti ekonomik vendor, filloi të rimëkëmbet nga tremujori i dytë i vitit, me çka rritja ekonomike në vitin 2021 arriti 4,0% dhe ishte në kornizë të pritshmërive. Rritja ishte e mbështetur nga rimëkëmbja e shpejtë e aktiviteteve të eksportit, por edhe të kërkesave të brendshme, e sidomos në rimëkëmbjen të asaj personale në raport me kërkesat investuese.

Grafikoni 5

Revizioni i projeksioneve markoekonomike




Burimi: BPRMV dhe ESHS: Projektionet për të gjitha treguesit kanë të bëjnë me projektimet e makroekonomisë të BPRMV.

Rezervat valutore gjatë vitit 2021 shënojnë rritje, duke mbetur në zonën e sigurt gjatë vitit. Rritja e rezervave valutore ka ardhur kryesisht nga transaksionet në llogari

shtetërore¹. Nga ana tjetër, Banka Popullore ndërhyr me shitjen neto të valutës për të ruajtur ekuilibrin ndërmjet ofertës dhe kërkesës për valutë, dukshëm më pak në krahasim me vitin 2020 dhe kryesisht e koncentruar në tremujorin e fundit, kur u paraqitën efektet e para të krizës energjetike. Megjithatë, flukset solide pozitive financiare brenda llogarisë financiare të bilancit të pagesave mundësuan financimin e plotë të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe rritje shtesë të rezervave valutore.

Grafikoni 6

Intervenimet e BPRMV në tregun valutor (në milionë euro)



Burimi: BPRMV.

Depozitat e sektorit privat vazhdojnë të rriten gjatë gjithë vitit. Pasiguria për shkak të pandemisë, si dhe presionet e çmimeve nën ndikimin e krizës së re energjetike që filloi në fund të vitit, patën ndikim në monedhën, afatizimin dhe strukturën sektoriale. Rritja vjetore e depozitave totale në vitin 2021 në masë më të madhe i reflektohet rritjes së depozitave në para dhe të depozitave në valutë të huaj, ndërkohë që depozitat në valutë vendore kanë shënuar rënie. Gjithashtu, gjatë vitit ka pasur rritje të depozitave afatshkurtra në kurriz të depozitave afatgjata, si dhe rritje të moderuar të shkallës së euroizimit². Nga pikëpamja sektoriale, rritja vjetore e totalit të depozitave vjen kryesisht nga familjet, me një kontribut pozitiv edhe të depozitave të ndërmarrjeve. Për sa i përket flukseve të kredisë, rritja e tyre u përshpejtua gjatë vitit 2021, e ndikuar nga rritja e intensifikuar e kredisë për sektorin e korporatave, si dhe rritja e mëtejshme e kredisë për familjet, ge cila kontriboli për pozicion të mirë të solventitetit dhe likuiditetit të bankave, rritjen e burimeve të financimit, si dhe karakteri i përshtatshmërisë së politikës monetare.

Duke pasur parasysh aplikimin e strategjisë së kursit nominal valutor të denarit kundrejt euros, ndryshimet e normave të interesit në eurozonë, si ekonomi –spirancë, luajnë një rol të rëndësishëm në aspektin e vendosje së politikës monetare në vend. Gjatë vitit 2020, Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka vazhduar me zbatimin politikës monetare të lirë, përmes një sërë masash lehtësuese kuantitative, ndërsa normat e interesit bazë i mbajtën në të njëjtin nivel. Si rezultat i uljes së normës bazë të interesit të Bankës Popullore, u vërejtë ngushtim i diferencës në mes normave të interesit të Bankës Popullore dhe BQE prej 1,5


¹ Euroobligacioni i tetë është lëshuar në fillim të marsit 2021, në vlerën prej 700 milionë euro; tërheqjen e kështit të dytë të ndihmës makrofinanciare nga Bashkimi Evropian, në fillim të qershorit 2021, në vlerë prej 80 milionë euro, nga gjithsej 160 milionë euro të ndihmës makrofinanciare të Bashkimit Evropian për tejkalimin e krizës së shkaktuar nga korona-virusi; përdorimi i të drejtave të reja të tërheqjes (SDR) për financimin e shpenzimeve buxhetore dhe shlyerjen e borxhit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ia dha vendit më 23 gusht 2021, në shumën prej rreth 161 milionë euro. Në të njëjtën kohë, në korrik 2021, shteti ka bërë pagesë për euroobligacionet e lëshuara në vitin 2014 në vlerë prej 500 milionë euro.

² Pjesëmarrja e depozitëve valutor në totalin e depozitëve në sistemin financiar.

p.p. në 1,25 p.p. Sa i përket normave të interesit të bankave në ekonominë vendore, diferenca ndërmjet normës së interesit në denarë dhe normës së interesit për depozitat në valutë në vitin 2021 ka shënuar rënie minimale (nga 0,8 p.p. në 0,6 p.p.), si rezultat kryesisht në lëvizjen rënëse të normës së interesit për depozitat në denarë, gjatë uljes minimale të normës së interesit për depozitat në valutë.


Grafikoni 7

Diferenca e normave bazë të interesit të BPRMV dhe BQE në p.p.



Grafikoni 8

Diferanca e normave të interesit në bankat e ekonomisë vendore në p.p.



Normat bazë e interesit e BPRMV: norma e interesit të boneve të thesarit të BPRMV.

Norma bazë e interesit e BQE: norma e interesit të operacioneve bazë për rifinancim të BQE.

II. Ambienti ndërkombëtar³

Pas goditjeve të fortë të pandemisë, ekonomia globale u rikuperua në vitin 2021 e mbështetur nga stimuli monetar dhe fiskal, lehtësimi i mëtejshëm i masave kufizuese dhe procesi i imunizimit të popullsisë. Rritja ekonomike globale e vlerësuar për vitin 2021 është 5.9%, e cila vlerësohet si rritja më e lartë në 40 vitet e fundit⁴. Rritja e aktivitetit ekonomik ishte e përhapur, por rikuperimi i aktivitetit ekonomik ishte i pabarabartë, me vendet e zhvilluara që pritej të arrinin nivelet para pandemisë shumë shpejtë, ndërsa në vendet në zhvillim të avancuar dhe në vendet zhvillim të rimëkëmbjes ishte më e ngadaltë për shkak të imunizimit më të ngadaltë dhe kryesisht stimujve më të ulët në krahasim me ato të ekonomive më të avancuara.


Projeksionet për rritjen e ekonomisë globale vazhdojnë të shoqërohen me pasiguri të skajshme, lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të pandemisë dhe që nga fillimi i vitit 2022 me tensionet dhe zhvillimet gjeopolitike mes Rusisë dhe Ukrainës. Edhe para paraqitjes së këtyre tensioneve, rreziqet në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme vlerësoheshin si në rënie, lidhur me zgjatjen e mëtejshme të pandemisë të shkaktuar nga lloji i ri i Covid-19 ("omikron") dhe për rrjedhojë rreziku i rikufizimeve të masave të reja. Kjo do të kontribuonte në përkeqësimin e mëtejshëm të zinxhirëve të furnizimit, rritjen e inflacionit dhe pritjet inflacioniste, dhe si rrjedhim në shtrëngimin më të hershëm dhe më të mprehtë të politikave monetare në shumë ekonomi. Rrjedhimisht, këta faktorë mund të rrisin rrezikun e stresit financiar, duke pasur parasysh cenueshmërinë e sektorit publik dhe privat, veçanërisht në vendet me rritje të shpejtë dhe në zhvillim me borxhe të larta, dhe përveç kësaj, pasojat e mundshme që lidhen me ndryshimet klimatike do të kishin një efekt negativ në rimëkëmbjen e këtij grupi të shteteve. Rreziku në rritje i ekonomisë globale është përshkallëzimi i konfliktit ruso-ukrainas, i cili mund të shkaktojë rritje të çmimeve të produkteve energjetike dhe joenergjetike primare, destabilizimin e flukseve të tregtisë globale dhe rritje të paqëndrueshmërisë në tregjet financiare, duke reflektuar inflacionin e pafavorshëm global dhe rimëkëmbja globale ekonomike. Në afat të gjatë, ekonomia globale përballet me rrezikun e një rënijeje më të theksuar të nxitësve kryesorë të rritjes, veçanërisht në ekonomitë në zhvillim të shpejt dhe ato në zhvillim, në kushte të investimeve globale në mjetet bazë, si dhe pasoja mbi kapitalin njerëzor gjatë qasjes së kufizuar deri te shërbimet shëndetësore dhe në arsim. Rreziqe të tjera globale janë rritja e mundshme më e ngadaltë e ekonomisë kineze dhe shfaqja e mundshme e trazirave sociale në shkallë globale. Nga ana tjetër, rreziqet rritëse për rritjen e ardhshme lidhen kryesisht me mbështetjen shtesë fiskale në ekonomitë e zhvilluara dhe adoptimin më të shpejtë të teknologjive të reja, të cilat mund të çojnë në rritjen e produktivitetit dhe një rimëkëmbje ekonomike globale më të fortë se sa pritej.

Norma mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2021 u përshpejtua, e duke arritur më 4,3% (3,2% në vitin 2020) dhe në pjesë më të madhe i reflektohet rritjes së çmimeve të energjisë dhe produkteve ushqimore, në kushte të mospërputhjes së madhe në mes ofertës dhe kërkesave dhe ngushticat në zinxhirin e furnizimit. Shikuar sipas grupeve të vendeve, norma e inflacionit në vitin 2021 në ekonomitë e zhvilluara shënoi përshtypjetim të shpejtë dhe arriti 3,1% (krahasuar me 0,7% në vitin 2020), ndërsa në ekonomitë me rritje të shpejtë ishte 5,7% (5.1% në vitin 2020).


³ Analiza bazohet në "Pasqyra ekonomike botërore" të FMN, e përditësuar në tetor 2020 dhe janar 2021; "Prespektivat globale ekonomike" të Bankës Botërore, janar 2021, raportet tremujorsh të Bankës Popullore.

⁴ I referohet periudhës prej që është filluar publikimi i të dhënave për rritjen globale nga baza e të dhënave të FMN-së (WEO October 2021), nga viti 1980.


Grafikoni 9
Rritja ekonomike globale (në %)



Grafikoni 10
Rritja e PBB në vendet e zhvilluara në (%)



Grafikoni 11
Rritja vjetore tregtisë globale (në %)




Burimi: Pasqyra ekonomike botërore, tetor 2021 dhe azhurimi në janar 2022, FMN.


Sa i përket treguesve sasiorë që pasqyrojnë mjedisin e jashtëm të ekonomisë së Maqedonisë, kërkesa e huaj efektive e vlerësuar shënon rënie vjetore relativisht të lartë në vitin 2021 shënojnë rritje të dukshëm të lartë relative. Përkatësisht, vlerësimet tregojnë rritjes e kërkesave të huaja efektive prej 4,1% (krahasuar me rënie prej 5,1% në vitin 2020), në kushtet e ecures së pafavorshme ekonomike në të gjitha vendet partnere tregtare, me kontributin më të madh negativ të Gjermanisë, Italisë dhe Greqisë. Lëvizjet e tilla janë rezultat i bazës së ulët krahasimore (e sidomos në tremujorin e dytë) dhe rritja e aktivitetit ekonomik në kushte të zvogëlimit të masave restriktive si rezultat i imunizimit masovik, si dhe politikës monetare dhe fiskale të mëtijshme të stimuluar. Sa i përket çmimeve të huaja efektive për vitin 2021, mesatarisht ato kanë arritur një rritje të vogël prej 2,7% (përsheptim krahasuar me rritjen prej 0,3% në vitin 2020), kryesisht si pasqyrë e rritjes së çmimeve të të gjitha vendet, ashtu që kontribut drejt përsheptimit të inflacionit kanë Gjermani, Kroacia dhe Italia⁵.

⁵ Inflacioni i Serbisë dhe Kroacisë është korrigjuar për ndryshimet në kursin valutorë.

Grafikoni 12
Kërkesat e huaja efektive




Grafikoni 13
Inflacioni i huaj efektiv




Burimi: Entet Kombëtare për Statistik dhe Përlogaritje të BPRMV⁶.

Në tregjet e produkteve primare, në vitin 2021, u vërejtën zhvillime të epërme të dukshme. Në fakt në vitin 2021 çmimi mesatar i naftës ishte 59,7 euro për fuçi dhe ishte më i lartë për 61,6% krahasuar me vitin 2020 (37 euro për fuçi), në masë më të madhe si rezultat i rimëkëmbjes globale të kërkesave për shkak të ringjalljes së aktiviteteve ekonomike në kushte të zvogëlimit të masave rresterktive dhe imunizimi masovik, si dhe vazhdimin e marrëveshjes për prodhim të kufizuar të naftës nga ana e vendeve OPEC + gjatë gjithë vitit. Indeksi i çmimeve të metaleve bazë dhe indeksi i ushqimit në vitin 2021 gjithashtu është vërejtur rritje e dukshme, duke arritur normë të rritjes përkatësisht prej 42% dhe 23,5%. Lëvizje të tilla, në kushtet e rritjes së kërkesës globale, ishin kryesisht reflektim i faktorëve në anën e ofertës (zvogëlimi i stokeve metalike, pengesat në zinxhirët e furnizimit dhe rrjedhimisht rritja e lartë e shpenzimeve të transportit, kushtet e pafavorshme të motit në prodhimin e ushqimit).

Grafikoni 14
Lëvizja mujore e çmimeve të produkteve primare energjetike dhe joenergjetike (euro, indeksi: 2010=100)



Grafikoni 15
Lëvizja mujore e çmimeve të naftës së papërpunuar, metaleve⁷ dhe ushqimeve (euro, indeksi: 2010=100)



Burimi: Baza e të dhënave të FMN për çmimet e produkteve primare.

⁶ Kërkesa e huaj efektive llogaritet si shumë e indekseve të ponderuar të prodhimit të brendshëm bruto të partnerëve më të rëndësishëm tregtarë të vendit tonë. Në llogaritjen e indeksit janë të përfshira: Gjermania, Greqia, Italia, Holanda, Belgjika, Spanja, Serbia, Kroacia, Sllovenia dhe Bullgaria. Panderët janë llogaritur në bazë të pjesëmarrjes së eksportit ndaj këtyre vendeve në eksportin e përgjithshëm. Inflacioni efektiv i huaj paraqet një shumë të ponderuar të indekseve të çmimeve të konsumit të vendeve, partnerë më të rëndësishëm të Republikës së Maqedonisë në sferën e importit të mallrave për konsumin e gjerë. Struktura e ponderuar bazohet në pjesëmarrjen e normalizuar të importit nominal nga secili vend në importet e përgjithshme nominale në periudhën 2013 – tremujori i tret i vitit 2016. Në llogaritjen e këtij treguesi janë përfshirë: Bullgaria, Gjermania, Greqia, Franca, Italia, Austria, Sllovenia, Kroacia dhe Serbia.

⁷ Indeksi i metaleve është indeks kompozitë që përfshinë çmimet e bakrit, aluminit, xeheve të hekurit, fletëzave metalike, nikelit, zingut, plumbit dhe uraniumit.

Gjatë vitit 2021, bankat qendrore të vendeve të zhvilluara vazhduan me politikën monetare stimuluese për të nxitur rritje ekonomike, por në fund të vitit disa prej tyre vendosën të nisin një shtrëngim gradual, për shkak të rritjes së presioneve të inflacionit. Banka e Anglisë i mbajti masat lehtësuese sasiore gjatë gjithë vitit⁸, por në mbledhjen e rregullt të dhjetorit bëri një korrigjim në rritje të normës së interesit referentues, e cila u rrit nga 0,1% në 0,25%. Madje, paralajmëroi një shtrëngim i moderuar i politikës monetare ndoshta do të jetë i nevojshëm në periudhën e ardhshme për të arritur objektivin e inflacionit. Nga ana tjetër, FED mbajti diferencën e normës së interesit në nivelin 0 deri në 0.25% gjatë gjithë vitit, por në dy raste (në nëntor dhe dhjetor) vendosi të zvogëlojë volumin e blerjes së letrave me vlerë afatgjatë dhe të thesarit. Ashtu që, FED përmes këtyre dy zvogëlimeve e përgjysmoi blerjen mujore të letrave me vlerë afatgjatë, e cila duke filluar nga janari 2022 do të arrijë në 60 miliardë dollarë, në vend të 120 miliardë dollarëve. Gjithashtu u paralajmërua një ulje e mëtejshme e ritmit të neto-blerjes së aktiveve në periudhën e ardhshme, por ajo do të përshtatet në varësi të perspektivës ekonomike.

Banka Qendrore Evropiane (BQE) nuk bëri asnjë ndryshim në normat e interesit gjatë vitit 2021, por bëri ndryshime në masat për të stimuluar rritjen ekonomike pas pandemisë, si dhe në strategjinë monetare. Në fakt, më 8 korrik 2021 u shpall revizioni i strategjisë monetare, sipas së cilës arritja e stabilitetit të çmimeve edhe më tej paraqet qëllim kryesor i politikës monetare, ndërsa ndryshimet kryesore i referohen përcaktimit të objektivit të inflacionit (2% inflacion simetrik objektiv në afat të mesëm), si dhe zgjerimi i fushës së inflacionit për të përfshirë shpenzimet për banim⁹. Sa i përket masave, gjatë vitit janë bërë ndryshime në kuadër të programit për blerjen e letrave me vlerë për mbështetje të menjëhershme të ekonomisë për shkak të pandemisë (PEEP), ku në tremujorin e dytë dhe të tretë BQE ka rritur ritmin e neto- blerjes së aktiveve, derisa në tremujorin e fundit ka ulur mesatarisht dinamikën e blerjes, ndërsa në pajtim me vendimin e mbledhjes së dhjetorit, zvogëlim shtesë do të ketë edhe në tremujorin e parë të vitit 2022, me çka programi do të mbaron në mars 2022. Madje, periudha e riinvestimit të mjeteve të vonuara në kuadër të këtij programi është zgjatur për një vit, pra të paktën deri në fund të vitit 2024. Përveç kësaj, BQE në dhjetor vendosi të ndryshojë shumën e programit të blerjes së letrave me vlerë (APP)¹⁰. Tensionet e fundit gjeopolitike mund të prolongojnë procesin e shtrëngimit të kushteve monetare nga ana e bankave qendrore udhëheqëse.

⁸ Gjatë gjithë vitit, Banka e Anglisë vendosi të mbajë volumin e blerjeve të obligacioneve të korporatave për investime jofinanciare në 20 miliardë paund dhe të vazhdojë programin ekzistues për blerje të obligacioneve shtetërore, me shumë totale prej 875 miliardë paund, ashtu që volumi total i blerjeve të mjeteve nga këto masa është 895 miliardë paund.

⁹ Për më shumë informacione në lidhje me strategjinë shihni në [lidhje](#).


¹⁰ Në tremujorin e dytë të vitit 2022, neto-blerja mujore e letrave me vlerë do të arrijë në 40 miliardë euro (në vend të 20 miliardë eurove aktuale), më pas do të zvogëlohet në 30 miliardë në tremujorin e tretë, ndërsa duke filluar nga tetori 2022, shuma 20 miliardë euro do të mbahen për aq kohë sa duhet dhe programi do të përfundojë.

III. Zhvillimet makroekonomike në vitin 2021

3.1. PBB dhe inflacioni


Sipas të dhënave të vlerësuara të ESHS-së, në vitin 2021 është shënuar një rritje reale të PBB prej 4%¹¹. Në fakt, pas rënies së thellë prej 6,1% në vitin 2020 si pasojë e krizës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga pandemia e covid-19, gjatë vitit 2021 është vërejtur një rimëkëmbje graduale të ekonomisë vendase. Madje, rritja ekonomike në vitin 2021 është pasojë e disa faktorëve, si përshtatja graduale e sjelljes dhe zakoneve të subjekteve në kushtet e pandemisë, procesi i imunizimit në vend, rihapja e ekonomive dhe aplikimi i masave të synuara dhe më pak restriktive për ballafaqimin me pandeminë, si dhe masat e ndërmarra për mbështetje të ekonomisë. Shikuar sipas komponentëve, rritja e aktivitetit ekonomik në vitin 2021 i detyrohet tërësisht kontributit pozitiv të kërkesës së brendshme, në kushte të rritjes vjetore dhe kontributit pozitiv të të gjitha kategori (konsumi personal, bruto-investimet dhe konsumi publik), ndërsa komponenti i neto-eksportit kanë një kontribut negativ, në kushte të rritjes më të madhe të importit në raport me rritjes së eksporteve. Nga ana e prodhimit, rritja u nxit nga shërbimet (tregtia, transporti, turizmi, informacioni dhe komunikimi dhe patundshmërive), derisa industria u përball me ndërprerje të zinxhirit të furnizimit dhe në fund të vitit, efektet negative të krizës energjetike, ndërsa ndërtimtaria shënoi rënie të mëtejshme.

Grafikoni 16
PBB dhe kërkesa efektive e jashtme (shkalla vjetore e ndryshimit real, në %)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe Eurostat, përlogaritje të BPRMV. Të dhënat për BPP për vitin 2019 janë paraprake, ndërsa për vitin 2021 janë të vlerësuara.

Grafikoni 17
PBB (rritje reale, në %) dhe komponentët shpenzues të PBB (kontribut në rritje, në p.p.)




Shikuar në mënyrë të detajuar përmes anës së prodhimit, rritja e ekonomisë gjatë vitit 2021 është shpërndarë gjerësisht, dhe është më e theksuar në grupin e **veprimtarive "tregti, transport dhe hoteleri"**, e cila gjatë vitit paraprak ishte edhe më e prekura nga kriza e shkaktuar e pandemisë. Përveç kësaj, rritja në **tregti** është për shkak të rritjes së lartë në tregtinë me shumicë dhe tregtinë me pakicë, ndërsa tregtia me automjete motorike shënoi rënie. Gjithashtu, sipas të dhënave të detajuara për transport të

¹¹ PBB-ja reale gjatë vitit 2021 ka ndjekur dinamikën e mëposhtme: tremujori i parë -1,8%, tremujori i dytë 13,4%, tremujori i tretë 3% dhe tremujori i katërt 2,3%.

pasagjerëve dhe mallrave, rritje të aktivitetit shënon edhe **transporti**, në rritjen e aktivitetit në të gjitha llojet e transportit, në kushtet e lëvizjes së lehtësuar të popullsisë, si në nivel lokal ashtu edhe ndërkombëtar, në krahasim me vitin paraprak. Gjithashtu, rritje e lartë e aktivitetit është vërejtur edhe te **hoteleria**, e cila ishte një nga sektorët që ishin më të prekura nga pandemia, e cila rezultoi me rritje të lartë të numrit të turistëve dhe bujtjeve, si dhe në qarkullimin e përgjithshëm. Kur bëhet fjalë për **industrinë**, e analizuar sipas indeksit të prodhimit të industrisë, arrijtjet e kënaqshme në industrinë e përpunimit vërehen kryesisht në veprimtaritë në të cilat janë aktive kapacitetet eksportuese të huaja, siç janë prodhimi i pajisjeve elektrike dhe prodhimi i makinave dhe aparateve (veprimtari e cila vitin e kaluar kishte kontribut më të dukshëm negativ) ndërsa kontribut pozitiv shtesë kanë edhe prodhimi i kimikateve dhe produktet kimikale, si dhe prodhimi i produkteve të gomës dhe prodhimi i tavolinave të plastikës. Kur vjen puna te veprimtaritë tradicionale, një kontribut i rëndësishëm pozitiv vërehet në prodhimtarinë e prodhimeve të tjera jo-metalike minerale dhe prodhimtarinë e prodhimeve të duhanit. Nga ana tjetër, arrijtje të pakënaqshme brenda industrisë prodhuese vërehen në prodhimin e automjeteve (duke reflektuar deri diku ndërprerjet në zinxhirët e furnizimit global që kanë prekur industrinë e automobilave), prodhimin e produkteve metalike të fabrikuarra përveç makinerive dhe pajisjeve, si dhe prodhimin e tekstileve dhe veshjeve. Vlera e shtuar në **sektorin e ndërtimit** ka shënuar rënie në vitin 2021, e cila, e parë përmes të dhënave me frekuencë të lartë, vjen kryesisht si pasojë e rënies së lartë të ndërtimeve të ulëta, ndërsa rënie më e vogël vërehet edhe te ndërtimet e larta.

Grafikoni 18


Kontributi ndaj ndryshimit real vjetor të PBB (në pikë përqindje)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe përllogaritje të BPRMV. Të dhënat për BPP për vitin 2020 janë paraprake, ndërsa për vitin 2021 janë të vlerësuara.

Grafikoni 19

PBB, industria dhe shfrytëzimi i kapaciteteve




Shikuar nga aspekti i kërkesës agregate, në vitin 2021 rritja e aktivitetit ekonomik i reflektohet rimëkëmbjes së plotë të kërkesave të brendshme, ndërsa neto-eksportet patën një kontribut negativ. Brenda kërkesave të brendshme, arrijtjet e favorshme vërehen në të tre kategoritë, ndërsa kontributi më i madh pozitiv ka **konsumi i familjeve**, në kushte të rritjes solide të të ardhurave të përdorshme të nxitura nga rritja e lartë e transferimeve private gjatë lëvizjes ndërkombëtare të lehtësuar të popullsisë, si dhe rritja e pagave në stabilizimin gradual të gjendjes së tregut të punës. Përveç kësaj, **investimet** kanë dhënë një kontribut pozitiv, me rritje të lartë në investimet e huaja direkte, si dhe investimet kapitale shtetërore dhe importet e mjeteve për punë, ndërsa kontribut pozitiv ka pasur edhe **konsumi publik** si rezultat i shpenzimeve më të larta për mallrat dhe shërbimet. Gjithashtu, eksportet u rikuperuan me shpejtësi gjatë vitit 2021 dhe panë rritje relativisht të lartë, nxitur nga rritja e veprimtarisë së eksportit në një pjesë të strukturave prodhuese në

pronësi të huaj. Rritja e eksportit dhe kërkesave vendase kontribuan në rritjen e lartë në importet e mallrave dhe shërbimeve, për shkak të cilës komponenti i neto-eksportit shënoi kontribut negativ në totalin e PBB.

Në vitin 2021, norma mesatare e inflacionit ishte 3,2%, e cila paraqet një përshtepje të moderuar në krahasim me realizimin në vitin 2020, kur inflacioni ishte 1.2%. Shikuar në përgjithësi, rritja e tillë e çmimeve të brendshme gjatë vitit pasqyron ndryshimet në çmimet e prodhimeve primare në tregjet botërore të bursës, e cila është e ndërlidhur me çrregullimin e zinxhirëve globalë të furnizimit dhe rihapjen e ekonomive, efektet e transferuara të ndryshimeve administrative dhe rregullatore të vitit të kaluar, si dhe nga disa faktorë specifikë të krizës pandemike, ndërsa në kushte të lehtësimit të masave restriktive nga fundi i tremujorit të dytë të vitit. Prandaj, presionet e çmimeve gjatë vitit 2021 kryesisht erdhën nga faktorët në anën e ofertës. E analizuar në mënyrë dinamike, rritja e çmimeve të konsumit u përshtepjtua gjatë vitit dhe një rritje pak më e madhe e çmimeve në bazë vjetore u shënuar në gjysmën e dytë të vitit¹².

Grafikoni 20


Inflacioni vendor dhe inflacioni i huaj efektiv, shkalla vjetore e rritjes (në %)



Burimi: ESHS, Eurostat dhe përlogaritjet e BPRMV.

Grafikoni 21

Komponenti i ndryshueshëm (ushqimi dhe energjia) dhe afatgjatë i inflacionit (kontributet vjetore, në pikë përqindje)



Lidhur me komponentët kryesorë të indeksit të çmimeve të konsumit, për dallim me dy vitet paraprake, në vitin 2021, kontribut pozitiv drejt inflacionit total patën të tre komponentët. Kështu, për dallim prej dy vitet e fundit, **komponenti i energjetikës** këtë vit ka shënuar rritje prej 9,3% (një kontribut prej 0,8 p.p. në inflacionin total). Një rritje e tillë është gjithashtu është një pasqyrim i efektit transfertues të rritjes rregullatore të çmimit vendas të energjisë elektrike në gusht 2020¹³, plotësuar me rritjen e lartë vjetore të çmimeve të derivateve të naftës në përputhje me lëvizjet në rritje të naftës "brent" në bursat botërore. Megjithatë, përballë shterimit të efektit transferues të rritjes së çmimit vendas të energjisë elektrike, si dhe rënies së çmimit të ngrohjes qendrore¹⁴, rritja në komponentin e energjetikës ishte më e moderuar në gjysmën e dytë të vitit. Rritja e **çmimeve të ushqimit** prej 3,3% (një kontribut prej 1,2 p.p. në inflacionin total) vjen

¹² Rritja vjetore e çmimeve të konsumit gjatë vitit 2021 kishte dinamikën e mëposhtme: 2% në tremujorin e parë, 2,8% në tremujorin e dytë, 3,5% në tremujorin e tretë dhe 4,6% në tremujorin e katërt.

¹³ Me vendim të KRE, duke filluar nga 1.8.2020, çmimi i energjisë elektrike është më e lartë për 7,4%, përkatësisht tarifa më e lartë arrin 5,95 denarë/kWh, për tarifën më të ulët arrin 2,99 denarë/kWh, ndërsa për matje njëtarifore arrin 4,77 denarë/kWh (<https://www.erc.org.mk/pages.aspx?id=153>). Gjithashtu, me vendim të KRE- së, duke filluar nga 1 korriku 2021, u bë një rritje e çmimit të energjisë elektrike prej 12.4% (pa TVSH-në), por me zvogëlimin e normës së TVSH-së (nga 18% në 5%), çmimi i energjisë elektrike me përfshirje të TVSH-së mbetet i pandryshuar.

¹⁴ Komisioni rregullator më 29.7.2021 miratoi vendim çmimi i energjisë ngrohëse të zvogëlohet për 4%, përkatësisht prej 1 gushti, tarifa e energjisë ngrohëse për amvisëritë dhe institucionet arsimore të jetë 1.8498 denarë për kilovat-orë, ndërsa te konsumuesit e tjerë tarifa do të jetë 2.5898 denarë për kilovat-orë.

kryesisht nga rritja më e lartë e çmimeve të vajit dhe yndyrës, si dhe çmimet e bukës dhe drithërave në përputhje me rritjen e lartë të çmimeve të vajit dhe drithërave në bursën botërore. Kontributet shtesë në rritjen e çmimeve të ushqimit kishin edhe çmimet e mishit të ndërlidhura me rritjen e çmimeve të drithërave që rrisin ushqimin e bagëtisë për bagëtinë, ndërsa rritje kishte edhe në çmimet e perimeve, veçanërisht të shprehura në gjysmën e dytë të vitit. Shikuar dinamikisht, rritja më e lartë e çmimeve të ushqimit mund të vërehet ka fundi i vitit, nën ndikim të rritjes së çmimeve të vajit dhe yndyrës, bukës dhe drithërave, mishit dhe perimeve, ndërsa rritje u vërejtë edhe te çmimi i qumshtit, djathit dhe vezëve, gjë që ndikoi që në dhjetor 2021, Qeveria të miraton Vendim për përcaktimin e çmimeve më të larta të produkteve ushqimore bazë në tregi me shumicë dhe në tregti me pakicë¹⁵. **Inflacioni bazë** shënoi rritje vjetore prej 2,4% (një kontribut prej 1,2 p.p. në inflacionin total), e cila në masë më të madhe mund të shpjegohet me kontributin pozitiv të çmimeve të duhanit si rezultat i ndryshimeve ligjore¹⁶, si dhe nga rritja e çmimeve të restorantet dhe hoteloritë, në kushte të masave më të vogla restriktive, por të cilat akoma janë në zbatim për shkak të paraqitjes së varianteve të reja të covid-19, e cila kushtëzoi që të funksionojnë me kapacitet më të vogël këta subjekte të veprimtarisë shërbyese. Në gjysmën e dytë të vitit, kontribut pozitiv kishte edhe nga çmimet më të larta të trafikut ajror në përputhje me rritjen e udhëtimeve ndërkombëtar nën masa më të vogla kufizuese. Gjithashtu pozitiv, por më pak kontribut në komponentin bazë kishte edhe rritja e çmimeve të prodhimeve farmaceutike, pajisjeve informatike dhe automobila.

3.2. Tregu i punës

Në vitin 2021 në tregun e punës¹⁷ u vërejt një stabilizim të dukshëm dhe ulje graduale të efekteve negative të transmetuara nga pandemia e Covid-19 në këtë segment të tregut. Rënie e numrit të personave të të punësuarve është vërejtur vetëm në tremujorin e parë, derisa në pjesën e mbetur të vitit numri i të punësuarve ka shënuar rritje vjetore. Këto ndryshime janë në përputhje me rimëkëmbjen e aktivitetit ekonomik pas goditjes së parë të pandemisë në vitin 2020. Megjithatë, duke pasur parasysh vazhdimin e pandemisë, rimëkëmbja akoma nuk është e plotë, dhe njëherit edhe numri i personave të punësuarve nuk është kthyer akoma në nivelin e parapandemisë. Gjithashtu, gjatë vitit 2021 është rritur numri i popullsisë joaktive, me çka shkalla e aktivitetit ka shënuar rënie për të dytin vit radhazi.

Gjatë vitit 2021 u miratuan disa masa kundër krizës¹⁸ për të zbutur më tej ndikimin e krizës në tregun e punës, ndërsa u vazhduan me zbatimin e masave aktive të punësimit¹⁹ si

¹⁵ Qeveria e RMV-së më 4 dhjetor 2021 solli vendim për ngrijen çmimeve të bukës, sheqerit, miellit, vajit të lulediellit për ngrënie, qumështit, mishit të freskët dhe produkteve të thata të mishit, djathit dhe gjizës prej 1 dhjetor. Më 14 dhjetor lista e produkteve u zgjerua edhe për çmimet e orizit, vezëve dhe makaronave. Vendimi për ngrirjen e çmimeve të produkteve ushqimore bazë në fillim të dhjetorit ishte e përkohshme dhe me vlefshmëri parimore deri më 31 janar 2022, por më vonë u vazhdua deri më 28 shkurt 2022. Për shkak të mënyrës së vëzhgimit të çmimeve nga ana e ESHS (ka mesi i çdo muaji) ky vendim nuk kishte efekt të plotë gjatë vëzhgimit të çmimeve të dhjetorit 2021 (<https://vlada.mk/node/27162>; <https://vlada.mk/node/27234> dhe <https://vlada.mk/node/27591>).

¹⁶ Rritja ka ardhur si rezultat i ndryshimeve në Ligjin për duhanin, produktet e duhanit dhe produktet e ngjashme, i cili detyron të gjitha paketat e cigareve të kenë 20 cigare nga nëntori 2020 (më parë kishte kuti edhe me 19 cigare), si dhe nga rritja e sasisë së akcizës që paguhet për cigaret. Gjithashtu, rritja vjetore e çmimit të duhanit është reflektim i rritjes së çmimit të cigareve në korrik 2021, në përputhje me rritjen e parashikuar vjetore të akcizës për cigaret për 0,20 denarë/copë, nga 1 korriku 2023.

¹⁷ Analiza e tregut të punës është bërë përmes përdorimit të anketave tremujore të fuqisë punëtore, përkatësisht treguesit vjetorë për vitin 2021 janë nxjerrë si mesatare e të dhënave të publikuara tremujore.


¹⁸ Për më shumë informata për masat e miratuara, qasnu në linkun në vijim: <https://vlada.mk/ekonomski-merki-covid19>

¹⁹ Edhe gjatë vitit 2021, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Agjencia e Punësimit edhe më tej vazhduan zbatimin e masave dhe programeve aktive që synojnë rritjen e punësimit. Me Planin operativ për programe aktive dhe masa për punësim dhe shërbime në tregun e punës në vitin 2021 ka mbuluar rreth 12.000 persona të papunësuar, përmes 8 llojeve të ndryshme të programeve të cilat përfshijnë masa të veçanta (më shumë informata në <https://av.gov.mk/operativen-plan.nspx> dhe <https://vlada.mk/node/27001>).

mbështetje për rritje të punësimit. Numri i të punësuarve gjatë vitit 2021 ka mbetur i njëjtë, me një rritje të njëkohshme të shkallës së punësimit për 0,1 p.p., deri në nivelin 47,3%. Analizuar sipas sektorëve, rritje e punësimit është vërejtur në sektorin shërbyes, ulje të numrit të punësuarve ka edhe te sektori i bujqësisë dhe ndërtimtarisë, derisa në industri numri ka mbetur i pandryshuar. Shikuar më në detaje sipas veprimtarive, zhvillime pozitive janë vërejtur në disa veprimtari shërbyese, kryesisht në veprimtari që kanë të bëjnë me tregtinë me shumicë dhe pakicë, shëndetësinë, "administratën publike dhe mbrojtjen; sigurimet sociale të detyrueshme", si dhe tek informacioni dhe komunikimi. Nga ana tjetër, rënie e mëtejshme e punësimit vërehet në aktivitetet që ndërlidhen me hotelëritë dhe restorantet, bujqësinë dhe "transportin dhe magazinimin".

Grafikoni 22


Treguesit e selektuar të tregut të punës (në %)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave dhe përllogaritjet e BPRMV.

Grafikoni 23

Shkalla e papunësisë sipas grup moshave (në %)



Nga aspekti i ofertës së fuqisë punëtore, në vitin 2021 popullsia totale aktive shënoi ulje prej 0,8%, e cila në të njëjtën kohë rriti popullsinë joaktive prej 0,7%, duke çuar në një zhvendosje në rënie të shkallës së aktivitetit (për 0,4 p. p.), e cila ishte 56%. Megjithatë edhe përkundër zhvillimeve të pafavorshme në kahun e ofertës, stabilizimi i kahut të kërkesës së fuqisë punëtore çoi deri në ulje të numrit të personave të papunësuar për 5,2%, dhe shkalla e papunësisë u ul në nivelin më të ulët historik prej 15,7% (ulje vjetore për 0,7 p.p.). Madje, shikuar sipas grupmoshave, rënia e shkallës së përgjithshme të papunësisë shpjegohet me uljen e papunësisë në grupmoshat nga 25 deri 49 vjeç dhe nga 50 në 64 vjeç, derisa papunësia në kategorinë e personave të rinj nga 15 në 24 vjeç shënoi rritje.

Rritja e pagave mesatare të paguara vazhdoi edhe në vitin 2021, pjesërisht si rezultat i efektit transferues të rritjes së pagës minimale në vitin 2020²⁰, si dhe rritjes së rregullt të pagës minimale nga prilli 2021²¹. Ndikim shtesë për rritjen e pagës mesatare kanë edhe faktorët strukturorë të caktuar, siç është mungesa e fuqisë punëtore në segmente të caktuara, por edhe si efekt i krizës që shprehet përmes zvogëlimit të numrit të të punësuarve me paga më të ulëta se mesatarja. Kështu, pagat nominale neto dhe bruto²²


²⁰ Në pajtim me shpalljen e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, botuar në "Gazetën Zyrtare të RMV" nr. 75/20 dhe Dekretin me fuqi juridike për zbatimin e Ligjit për pagën minimale në Republikën e Maqedonisë "Gazetën Zyrtare të RMV" nr. 88/20, neto-paga minimale nga korriku 2020 është rritur për 3%, përkatësisht për 434 denarë.

²¹ Në prill 2021 është bërë harmonizimi i rregullt për rritjen e pagës minimale (me rritjen për vitin paraprak të pagës mesatare të paguar në RMV, indeksi i shpenzimeve për jetesë dhe rritjes reale të PBB-së - përkatësisht një e treta e rritjes së secili tregues). Në pajtim me shpalljen e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale në "Gazetën Zyrtare të RMV" nr. 80/21 për zbatimin e Ligjit për pagën minimale në Republikën ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 11/12.30/14, 180/14, 81/15, 129/15, 132/17 dhe 140/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Veriut

²² Totali i bruto-pagave të paguara përfshin: neto-pagat të paguara për muajin raportues, tatimin personal të paguar dhe kontributet e paguara (për sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin shëndetësor, punësimin, sëmundjet profesionale). Të dhënat i referohen pagave të paguara.


Kështu, pagat nominale neto dhe bruto²³, (përkatësisht 7,8% dhe 8,3% në vitin 2020). Korrëgjim në rritjen e neto-pagës është vërejtur pothuajse në të gjithë sektorët e aktiviteteve, kurse rritje veçanërisht të lartë është shënuar te veprimtaritë të cilat parimisht ishin më të prekura nga pandemia, si dhe veprimtaritë të cilat mund të ndërlidhen me trendin e rritjes së digjitalizimit, e theksuar në mënyrë plotësuese në kushtet pandemie. Kështu, rritjen më të lartë është shënuar te pagat e veprimtarive që ndërlidhen me "objektet për strehim" (10,9%), "artin, argëtim dhe rekreacion" (10,7%), veprimtari tjera shërbyese (10,5%), "informacione dhe komunikim" (10,1%). Rritje të mëtejshme është shënuar në veprimtaritë profesionale dhe shkencore (9,4%), minierat dhe guroret (7,7%), veprimtaritë administrative dhe shërbyese mbështetëse (7,8%), si dhe tregtia me shumicë dhe pakicë, riparim i automjeteve motorike dhe motoçikletave (7,4%). Madje, në kushte të rritjes së nivelit të përgjithshëm të çmimeve të konsumit, neto dhe bruto paga shënuan rritje reale përkatësisht prej 2,4%.

Grafikoni 24
Bruto dhe neto pagat mesatare
(ndryshimet vjetore, në %)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe përllogaritjet e BPRMV.

Grafikoni 25
Neto pagat mesatare sipas sektorëve
(ndryshimet vjetore, në %)




Për sa i përket treguesve të konkurrencës²⁴, në vitin 2021 vihet re përmirësim. Në fakt, gjatë vitit produktiviteti i punës u rrit për 2,8% (pas rënies prej 4,6% në vitin 2020), si rezultat i rritjes së vlerës së shtuar, në kushte të ndryshimit të numrit të personave të punësuar. Shikuar sipas sektorëve, kontribut pozitiv vjen nga sektori i shërbimit, ndërsa industria dhe bujqësia kanë kontribut të vogël negativ.. Në pajtim me rritjen më të lartë të pagave nga rritja e produktivitetit, shpenzimet për punë sipas njësive prodhuese në vitin 2021 janë mesatarisht më të larta për 2,6% (në dallim me rritjen prej 13,8% në vitin 2020), me rritjen më të lartë të shpenzimeve për punën në sektorin e shërbimit, ndërsa në masë më të vogël edhe në industri, ndërsa rënie të vogël të shpenzimeve për punë është vërejtur në bujqësi.

²³ Normat me të cilat paguhen kontributet në vitin 2021 janë 18,8% për sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor dhe 7,5% për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, njësoj si në vitin paraprakë.


²⁴ Produktiviteti dhe shpenzimet e punës për njësi të produktit për të gjithë ekonominë janë llogaritur mbi bazë të të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave për: PBB, numri i personave të punësuar dhe bruto -paga mesatare. Produktiviteti total llogaritet si një shumë e ponderuar e produktivitetit të llogaritur në nivel të sektorit individual. Brenda secilit sektor, produktiviteti llogaritet si raport ndërmjet vlerës së shtuar në atë sektor dhe numri i personave të punësuar.

Grafikoni 26
Produktiviteti i punës
(kontributet drejt rritjes vjetore, në p.p.)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe përllogaritjet e BPRMV.

Grafikoni 27
Shpenzimet e punës sipas njësisë së produktit
(kontributet drejt rritjes vjetore, në p.p.)



3.3. Financat publike


Deficiti buxhetor në vitin 2021 shënoi një ngushtim të moderuar dhe ishte 5,4% e PBB, pas një thellimi të ndjeshëm prej 8,2% të PBB në vitin paraprak. Zhvendosje të ngjashme janë regjistruar nga bilanci kryesor i buxhetit²⁵, i cili në vitin 2021 arriti në 4,1% të PBB-së, kundrejt 7% të PBB në vitin 2020. Lëvizjet e favorshme në deficitin buxhetor janë rezultat i rritjes më të moderuar në shpenzimet buxhetore, me rritjen e përforcuar të të hyrave buxhetore në kushte të rimëkëmbjes së aktivitetit ekonomik.

Duke pasur parasysh vazhdimi e krizës shëndetësore, si një tronditje globale në dy vitet e fundit dhe paraqitja e varianteve të ndryshme të virusit covid-19, ndërsa me këtë edhe nevoja për lehtësimin e mëtejshëm të efekteve të pandemisë mbi ekonominë, ka mes i vitit u bë korrigjim të përpjetë të deficitit të planifikuar për vitin 2021, nga shuma parimore e planifikuar prej 34.938 milionë denarë (4,8% të PBB) në 46.230 milionë denarë (6,4% të PBB), në kushtet e rritjes më të shprehur të shpenzimeve në raport të të hyrave²⁶. Megjithatë, deficiti i arritur ishte më i ulët në raport të asaj të planifikuar (për 1 p.p. të PBB)

²⁵ Bilanci kryesor i buxhetit është diferenca midis të hyrave totale të buxhetit dhe shpenzimeve totale të buxhetit, të zvogëluara nga pagesa e detyrimeve aktuale në bazë të huamarrjeve të marra (interesat). Ky tregues fiskal konsiderohet më i përshtatshëm në analizën e kursit aktual të politikës, për shkak të faktit se nuk integron shpenzimet fiskale lidhur me sjelljen e politikës fiskale në të kaluarën në lidhje me borxhin publik.

Më 28 korrik 2021 u miratua rebalanci i buxhetit për vitin 2021 ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 171 të datës 28.7.2021), ndërsa më 9 dhjetor 2021 u miratua vendim për rishpërndarje të mjeteve në mes shfrytëzuesve buxhetor të qeveris qendrore dhe në mes fondeve ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 273 të datës 9.12.2021).


Grafikoni 28
Tregusit fiskal (% të PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave dhe përllogaritjet e BPRMV.

Grafikoni 29

Të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme buxhetore dhe komponentët e tyre kryesor (% të PBB-së)




Burimi: Ministria e Financave dhe përllogaritjet e BPRMV.

Të ardhurat totale të buxhetit në 2021 janë 15,3% më të larta në bazë vjetore (pas një rënijeje prej 7% në vitin paraprak). Rritja vjetore e të hyrave buxhetore në një pjesë është rezultat i rimëkëmbjes së aktivitetit ekonomik, me një krahasim bazë më të ulët të vitit të kaluar si reflektim i përkeqësimit të aktivitetit ekonomik për shkak të pandemisë dhe masat për parandalimin e përhapjes së saj, të cilat sollën deri në rënie të të hyrave totale në vitin 2020. Pjesa më e madhe e rritjes së të hyrave totale rezulton nga rritja e të hyrave tatimore. Gjatë vitit 2021, shteti vazhdoi me pagesë të transferove për përkrahje të ndërmarrjeve dhe familjeve, por në mënyrë më të moderuar, ashtu që shpenzimet buxhetore shënuan rritje të moderuar prej 5,7% në bazë vjetore (rritje prej 11,9% në vitin paraprak). Shprehur në tregues relativë, pjesëmarrja e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore në PBB në vitin 2021 ishte përkatësisht 30,2% dhe 35,6%, (përkatësisht 28,9% dhe 37,1% në vitin 2020). Madje deficitin buxhetor i arritur në vitin 2021 në pjesë më të madhe u financua nga huamarrjet e huaja²⁷ të shtetit, ashtu që pjesë të hyrave u mbajtën si depozita të shtetit te Banka Popullore. Njëherit, në këtë periudhë, shteti në mënyrë shtesë morri borxh në tregun vendor të letrave shtetërore me vlerë.

²⁷ Huamarrja e shtetit në tregun e huaj vjen më së shumti si pasojë e euroobligacionit të tetë të lëshuar në fillim të marsit në vlerën 700 milionë euro me afat 7 vjet dhe me interes 1.625% dhe tërheqjes së kështit të dytë të ndihmës makrofinanciare nga Bashkimi Evropian, në fillim të qershorit në shumën prej 80 milionë euro (nga gjithsej 160 milionë euro ndihmë makrofinanciare nga Bashkimi Evropian për tejkalimin e krizës së shkaktuar nga koronavirusi), si dhe përdorimi i të drejtave të reja speciale të tërheqjes (DST) për financimin e shpenzimeve buxhetore dhe shlyerjen e borxhit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ia ndahu vendit më 23 gusht 2021, në vlerë prej rreth 161 milionë euro. Njëherit, në korrik 2021 shteti bëri pagesë të euroobligacionit të lëshuar në vitin 2014 në shumë prej 500 milionë euro.

Grafikoni 30

Struktura e financimit të saldove buxhetore*
(në miliona denarë)




* Ndryshim negativ të depoziteve në strukturën e financimit të saldo buxhetore paraqet rritja e depozitëve të shtetit.
Burimi: Ministria e Financave dhe përlogaritjet e BPRMV.

Rritja e nevojave për financim të buxhetit në vitin 2021 një pjesë u siguruan nga tregu primar vendor të letrave shtetërore me vlerë, ashtu që gjendja e letrave në vlerë të lëshuara u rrit për 18.444 milionë denarë dhe në fund të vitit ishte 146.309 milionë denarë. Emisionet e reja të letrave shtetërore në vlerë në pjesë më të madhe ishin me afatizim më të gjatë nga afatizimi i letrave në vlerë që arrinin për pagesë, e cila kontribuoi për rritjen e afatizimit mesatar të letrave shtetërore të lëshuara, ndërsa me këtë edhe për thellimin e këtij segmentit të tregut financiar, si dhe për rritjen të pjesëmarrjes së detyrimeve shtetërore në strukturën e letrave në vlerë. Zhvendosje të favorshme ishin shënuar edhe te struktura valutore, e cila është e dukshme përmes rritje së portofolisë së letrave shtetërore me vlerë në valutën vendore.

Grafikoni 31


Struktura valutore e letrave shtetërore me vlerë
(në milionë denarë)



Burimi: Ministria e Financave dhe BPRMV.

Grafikoni 32

Struktura afatizuese e letrave shtetërore me vlerë (në milionë denarë)




Në vitin 2021, borxhi i qeverisë qendrore nuk ka shënuar ndryshim në krahasim me vitin paraprak dhe arriti në 51,7% të PBB, ku borxhi i jashtëm dhe i brendshëm i qeverisë qendrore arritën përkatësisht në 31,1% dhe 20,6% të PBB-së (përkatësisht 31,8% dhe

19,9% e PBB-së në vitin e kaluar). Borxhi i përgjithshëm publik²⁸ në fund të vitit 2021 ishte 60,8% e PBB-së (61% e PBB-së në vitin paraprak), me një rënie të lehtë të borxhit publik të jashtëm (nga 40,7% në 39,8% të PBB-së) dhe rritje të vogël të borxhit publik të brendshëm (nga 20,3% në 21% të PBB-së). Në kuadër të borxhit publik, borxhi total i qeverisë (borxhi i qeverisë qendrore, fondeve publike dhe komunave) në vitin 2021 është në nivelin 51,8% të PBB, ngjashëm me vitin paraprak (51,9% e PBB-së), ndërsa borxhi i ndërmarrjeve publike (të garantuara dhe të pagarantuar)²⁹ ishte në nivelin 8,6% të PBB-së. Në fund të vitit 2021, pjesa e borxhit të shtetit në totalin e borxhit publik arrin 85,2% (85,1% në vitin 2020), ndërsa pjesa e borxhit të ndërmarrjeve publike (të garantuara dhe të pagarantuar) në totalin e borxhit publik është 14,1% (14,3% në vitin 2020).

Grafikoni 33

Borxhi i pushtetit qendror dhe borxhit i përgjithshëm publik (% të PBB)



Burimi: Ministria e Financave dhe përlogaritjet e BPRMV.

3.4. Bilanci i pagesave, PIN dhe borxhi i jashtëm


Gjatë vitit 2021, në kushte të rimëkëmbjes së ekonomisë, si dhe problemeve të mëtejshme në zinxhirët globalë të furnizimit dhe pasigurisë së zgjatur të shkaktuar nga paraqitja dhe përhapja e varianteve të reja të covid-19, deficitin në llogarinë rrjedhëse në bilancin e pagesave ka mbetur në nivel të moderuar. Kështu, saldoja negative në transaksionet rrjedhëse ka shënuar zgjerim minimal vjetor prej 0.1 p.p. dhe ishte 3,5% e PBB-së. Shikuar sipas komponentëve, thellimi i vogël i deficitit në llogarinë rrjedhëse është kryesisht për shkak të rritjes së deficitit tregtar (me 3,3 p.p. të PBB-së), përkatësisht rritje më të lartë të importit nga rritja e eksporteve të mallrave, kryesisht për shkak të efektit të çmimeve nga rritja e çmimeve në bursë të prodhimeve primare në tregjet botërore në vitin

²⁸ Borxhi publik është i definuar me Ligjin për Borxhin Publik ("Gazeta Zyrtare" nr. 62/2005, 88/2008, 35/2011, 139/2014 dhe 98/2019), sipas të cilit paraqet mbledhje e borxhit shtetëror dhe borxhit të ndërmarrjeve publike të themeluara nga shteti ose komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, si dhe shoqëritë tregtare që janë në pronësi të plotë ose të përgjithshme të shtetit ose komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit.

²⁹ Në bazë të ndryshimeve në Ligjin për Borxhin Publik nga maji 2019, borxhi i pagarantuar i ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare të themeluara nga shteti ose komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit llogaritet në borxh publik. ("Gazeta Zyrtare" nr. 62 / 2005, 88/2008, 35/2011, 139/2014 dhe 98/2019).


2021, e sidomos më e shprehur te energjetika. Kontribut shtesë drejt deficitit më të lartë në llogarinë rrjedhëse kanë edhe deficitin e rritur të ardhurave primare, të cilat kryesisht dalin nga daljet më të larta të ardhurave nga investimet, si rezultat i vlerës më të lartë të krijuar nga kompanitë me pronësi të huaj në kushtet e rimëkëmbjes së aktivitetit ekonomik. Lëvizje të tilla të pafavorshme të llogarisë rrjedhëse në peshë të madhe u lehtësua nga arritjet e mira të suficitit dhe të ardhurat sekondare. Në fakt ato kryesisht e pasqyrojnë rritjen e transfereve private, para se gjithash si rezultat i shfuqizimit gradual të masave restriktive të ndërlidhura me udhëtimin, për dallim nga lëvizja ndërkombëtare e kufizuar të udhëtarëve në vitin 2020, e cila kontribuoi për rritje të konsiderueshme të të hyrave të efektivitë neto blerjeve në tregun këmbimor. Të njëjtin ndikim kishte dhe rritja e të hyrave valutore përmes kanaleve formale, në kategorinë e transfereve personale. Në vitin 2021, arritje më të mira janë shënuar edhe te shërbimet, të cilat në peshë më të madhe janë kryesisht të rritjes së suficitit të shërbimeve kompjuterike si kategori e cila shënoi rritje të konsiderueshme në fillim të pandemisë, gjithashtu edhe te udhëtimet, në kushte të rritjes së udhëtimeve ndërkombëtare, su dhe te shërbimet afariste.

Grafikoni 34
Llogaria rrjedhëse dhe financiare
(në milionë euro)



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 35
Komponentët bazë të llogarisë rrjedhëse
(% të PBB)




Në vitin 2021, në llogarinë financiare të bilancit të pagesave u realizuan neto-hyrje prej 480,5 milionë euro, ose 4,1% të PBB-së, të cilat mundësuan financimin e plotë të deficitit në llogarinë rrjedhëse dhe rritje të njëkohshme të rezervave valutore. Arritjet e favorshme janë rezultat i neto-hyrjeve të arritura në pothuajse të gjithë komponentët e llogarisë financiare, me përjashtim të kategorisë "monedhat dhe depozitat". Hyrjet në llogarinë financiare më së shumti vijnë nga neto-hyrjet e investimeve e drejtpërdrejta, që shkojnë në 435.2 milion euro në vitin 2021, ose 3,7% të PBB-së, që paraqet një rritje e konsiderueshme prej 2,3 p.p. në raport me vitin e kaluar. Lidhur me strukturën e investimeve të drejtpërdrejta, mbizotërojnë neto-hyrjet neto mbi bazë të borxhit ndërkompanive, në të njëjtën kohë neto-hyrje edhe te riinvestimi i fitimit dhe kapitalit pronësor. Neto-hyrje shtesë në llogarinë financiare u arritën gjithashtu në bazë të huamarrjeve afatshkurtra si rezultat i aktiviteteve specifike të bankës qendrore lidhur me menaxhimin e rezervave të valutore, si dhe mbi huamarrjen afatgjate të institucioneve të depozitave dhe shtetit. Kontribut pozitiv mbi rrjedhat financiare në vitin 2021 kanë edhe realizimet të portofoli-investimeve, të cilat kryesisht varen nga huamarrjet e shtetit në vendet e huaja në bazë të letrave në vlerë të lëshuara të borxhit³⁰, si dhe neto-hyrjet e kredive tregtare. Nga ana tjetër, kategoria e monedhave dhe depozitave kanë shënuar neto-dalje të larta, të cilat në pjesë më të madhe i pasqyrojnë neto-daljet e mëtejshme, por më

³⁰ Në mars 2021, u lëshua euroobligacioni i tetë e Republikës së Maqedonisë së Veriut me vlerë prej 700 milionë euro me afatizim prej shtatë vjet dhe një normë interesi historikisht më të ulët prej 1,625% mjetet në pjesë më të madhe u shfrytëzuan në korrik 2021 për pagesë të euroobligacionit të lëshuar në vitin 2014.


të moderuara në sektorët e tjerë. Lidhur me financimin e transaksioneve rrjedhëse, në vitin 2021 u arrit dhe neto-hyrje në bazë të shpërndarjes së re të drejtave speciale të tërheqjes (DPT) nga Fondi Monetar Ndërkombëtar³¹.

Grafikoni 36
Llogaria financiare
(% nga PBB)



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 37
Investimet e drejtpërdrejta
(% nga PBB)



Deficiti në këmbimin e mallrave jashtë vendit në vitin 2021 shënoi një zgjerim të konsiderueshëm në bazë vjetore prej 49,5% (ose 5,9 p.p. të PBB-së), kundrejt ngushtimit në vitin e mëparshëm. Zgjerimi i deficitit tregtar u ndikua ndjeshëm nga faktorët globalë dhe pavarësisht impulseve fillestare pozitive nga vaksinimi në mbarë botën, variantet e reja të virusit covid-19 kanë shkaktuar efekte të mëtejshme negative nga pandemia. Gjithashtu, mungesa e lëndëve të para të rëndësishme dhe pjesëve të industrisë automobilistike dhe problemet me transportin global shkaktuan persione shtesë mbi tanimë zinxhirët e furnizimit, e cila është e plotësuar me rritjen e çmimeve të produkteve primare në bursën botërore³², negativisht u reflektua mbi saldon tregtare në vitin 2021. Përveç kësaj, eksportet e mallrave shënuan rritje vjetore prej 19,8%, e cila kryesisht është për shkak të kapaciteteve industriale të orientuara drejt eksporteve në pronësi të huaj, si dhe aktivitetit më të mirë të eksportit në pjesën e sektorëve tradicional, më konkretisht në industrinë e përpunimit të metalit dhe minierave. Të dhënat tregtare sipas kategorisë së produkteve tregojnë se kontributi kryesor në rritjen e eksportit janë eksportet e produkteve kimike dhe eksportet e pajisjeve dhe makinerive lidhur me industrinë e automobilitave, gjatë rimëkëmbjes së kërkesave të huaja. Arritjet pozitive në disa sektorë tradicionalë, shikuar përmes rritjes së eksporteve të hekurit dhe çelikut dhe minierave, pasqyrojnë kryesisht efektet e çmimeve, pra rritjen e çmimit të metalit në bursë. Nga ana e importit, rritja vjetore në vitin 2021 ishte më e theksuar dhe ishte 26,9%. Rritja në importet e mallrave është në një pjesë të rëndësishme për shkak të importeve më të larta të energjisë, në kushtet e rritjes dinamike të çmimeve të importit që korrespondojnë me lëvizjet e çmimeve të energjisë në bursën botërore, veçanërisht e shprehur te çmimet e importuara të energjisë elektrike dhe gazit natyror. Përveç kësaj, aktivitet më të përmirësuar në kapacitetet e industrisë automobilistike të orientuara drejt eksportit ka çuar gjithashtu në rritjen e importeve të materialeve të para, ashtu që duke shikuar sipas kategorive të caktuara, kontribut të rëndësishme pozitive kanë importet e pajisjeve dhe makinerive, prodhimet kimike inorganike, si dhe importet e metaleve të ngjyrosur. Rritja në importet e pajisjeve dhe makinerive në një pjesë të caktuar pasqyron edhe arritjet e favorshme në investimet


³¹ Në gusht 2021, Fondi Monetar Ndërkombëtar i dha Republikës së Maqedonisë së Veriut 134.47 milion të drejta të reja posaçme të tërheqjes në vlerë prej rreth 162 milionë euro.

³² Gjatë vitit 2021, pati një zhvendosje të ndjeshme në rritje të çmimeve të prodhimeve primare në bursat botërore, kryesisht për shkak të bazës së ulët krahasuese në vitin e mëparshëm (veçanërisht gjatë tremujorit të dytë) dhe rimëkëmbjes së ekonomisë globale, por edhe si rezultat i ofertës së pajustifikuar të rimëkëmbjes së kërkesës globale, si dhe ndikimet e disa faktorëve gjeopolitikë mbi çmimet energjetike, e sidomos mbi çmimet e gazit dhe energjisë elektrike.

vendas gjatë vitit 2021. Duke ju referuar ecurisë së eksportit dhe çmimeve më të larta të metaleve, është arritur gjithashtu rritje në importet e hekurit dhe çelikut.

Grafikoni 38


Kontributi në ndryshimet vjetore të eksportit (në p.p.)



Burimi: ESHS.

Grafikoni 39


Kontributi në ndryshimet vjetore të importit (në p.p.)



Përsa i përket treguesve të konkurrueshmërisë së çmimeve të ekonomisë së vendit³³, në vitin 2021 kursi real efektiv i këmbimit i deflatuar nga shpenzimet e jetesës është vlerësuar me 1.3% në bazë vjetore, ndërkohë që rritja e indeksit të llogaritur me çmimet e prodhuesve të produkteve industriale është më e moderuar dhe arrin 0,4%. Arritje të tilla dalin nga kursi nominal efektiv valutor, i cili mbiçmohet me 2% në bazë vjetore, si rezultat i nënçmimit të mëtejshëm të lirës turke ndaj denarit. Shpenzimet relative të jetesës dhe çmimet relative të prodhuesve të produkteve industriale shënuar rënie (përkatesisht me 0,7% dhe 1,6%), në kushtet e rritjes më të lartë të çmimeve të huaja krahasuar me ato vendase gjatë vitit 2021.

Grafikoni 40


KKEN dhe KREK, pa produktet primare të përlllogaritura sipas indeksit të shpenzimeve për jetesë dhe çmimet e prodhuesve (2015=100)



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 41

Çmimet relative (2015=100)




³³ Analiza e treguesve për konkurrueshmërisë së çmimeve bazohet në indeksin e RKEK, të kalkuluar me ponder të bazuar në këmbimin tregtar të jashtëm pa produkte primare. Produktet primare që mbeten të papërfshira në përlllogaritje janë: nafta dhe derivatet e naftës, çeliku dhe hekuri, mineralet dhe lëndët e para të importuara për kapacitetet e reja industriale në pronësi të huaj.

Në fund të vitit 2021, pozicioni neto i investimeve ndërkombëtare (PIM) i ekonomisë vendase arriti në 7.307,7 milion euro ose 62,3% të PBB-së. Në krahasim me gjendjen e fundit të vitit të kaluar, ajo është më e ulët për 2,6 pikë përqindje të PBB-së, në kushte të rritjes së mjeteve ndërkombëtare dhe zvogëlimi i detyrimeve ndërkombëtare (përkatësisht për 2,3 p.p. dhe 0,3 p.p. të PBB-së). Analiza sektoriale e PIM-së tregon se pozita më e mirë e ekonomisë është për shkak të angazhimeve më të ulëta neto të sektorëve të tjerë, si rezultat i rritjes së mjeteve në investimet direkte dhe portofole dhe njëkohësisht zvogëlim të detyrimeve në bazë të huamarrjeve afatgjate. Gjithashtu, detyrime më të ulëta neto u arritën gjithashtu në shtet, si rezultat i detyrime të ulëta bazuar në investimet e portofolit³⁴ dhe një pozitë pak më e mirë e investimeve ndërkombëtare neto u shënuar nga institucionet e depozitave. Nga ana tjetër, banka qendrore ka arritur një zvogëlim të neto-mjeteve në bazë vjetore, si rezultat i detyrimeve më të larta bazuar në të drejtat e posaçme të tërheqjes (DPT), e cila i reflektohet shpërndarjes shtesë nga ana e FMN-së.

Grafikoni 42


Pozitata ndërkombëtare investuese (% të PBB)



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 43

Pozitata ndërkombëtare investuese, sipas sektorëve (% të PBB)




Borxhi i jashtëm bruto, në fund të vitit 2021, arrin në 9.411,6 milionë euro³⁵, ose 80,2% të PBB-së, që paraqet ulje minimale në bazë vjetore (për 0,1 p.p. të PBB-së). Një arritje e tillë është për shkak të zvogëlimit të borxhit të sektorit publik për 0,7 p.p. të PBB-së dhe rritje të borxhit privat për 0,6 p.p. të PBB-së. Borxhi më i ulët i sektorit publik është rezultat i një zvogëlimi të borxhit të qeverisë qendrore (për shkak të pagimit të euroobligacionit), si dhe borxhit të ndërmarrjeve publike (shlyerje në bazë të huamarrjeve afatgjate), ndërsa shpërndarja shtesë e DPT-së kanë kontribuar për rritjen e borxhit të bankës qendrore. Nga ana tjetër, rritja vjetore e borxhit privat vjen kryesisht nga borxhi më i lartë ndërkompanive, në të njëjtën kohë zvogëlim të borxhit në sektorë e tjerë si rezultat i huamarrjeve më të ulëta afatgjate.

³⁴ Në vitin 2021, u realizua pagesa e rregullt e detyrimeve të jashtme të vendit mbi bazën e euroobligacioneve.

³⁵ Të dhënat bruto dhe neto të borxhit të jashtëm nuk përfshijnë detyrimet e bankës qendrore bazuar në repo-marrëveshjet.

Grafikoni 44

Borxhi i jashtëm bruto, sipas huazuesve dhe sektorëve institucional (% e PBB)



Burimi: BPRMV.

Treguesit e borxhit të jashtëm të ekonomisë së brendshme edhe më tej mbeten në zonën e sigurt. Pjesëmarrja e vetme e bruto borxhit të jashtëm në PBB-së edhe më tej është në intervalin e huamarrjeve të larta, ndërsa të gjitha treguesit e tjerë tregojnë për huamarrje të ulët në ekonominë e brendshme.

Më 31.12.2021, borxhi i jashtëm neto arriti në 3.537 milionë euro, ose 30,1% të PBB-së, që në krahasim me fundin e vitit të kaluar paraqet ulje prej 0,9 p.p. të PBB-së. Borxhi i jashtëm neto më i ulët vjen si pasojë e uljes të njëkohshëm të borxhit neto publik dhe privat (përkatesisht për 0,3 p.p. dhe 0,6 pp të PBB-së).

Tabela 1

Treguesit e borxhit të jashtëm

	Solventiteti				Likuiditeti		
	Pagesa e interesit/eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Bruto borxhi/eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Bruto borxhi/PBB	Pagesa e borxhit/Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Rezervat valutore/Borxhi afatshkurtër	Rezervat valutore/Borxhi afatshkurtër me maturim të mbetur*	Borxhi afatshkurtër/Borxhi i përgjithshëm
	BO %	BO %	BO %	BO %	COOДHOC	COOДHOC	BO %
31.12.2004	2,4	129,3	47,3	12,4	1,1	0,9	30,3
31.12.2005	2,7	147,0	54,2	11,1	1,7	1,0	26,7
31.12.2006	3,4	131,3	49,8	21,7	2,0	1,3	29,0
31.12.2007	2,8	119,3	51,3	19,4	1,3	1,1	39,8
31.12.2008	2,7	116,9	54,1	10,2	1,3	0,9	35,2
31.12.2009	2,4	131,0	57,8	11,8	1,3	0,9	32,9
31.12.2010	3,2	140,4	59,7	13,9	1,5	1,0	27,9
31.12.2011	3,1	148,4	64,6	16,8	1,8	1,2	25,2
31.12.2012	2,9	142,1	67,6	13,1	1,6	1,0	26,7
31.12.2013	2,5	137,3	67,3	15,8	1,6	1,1	23,3
31.12.2014	3,0	149,1	74,0	17,2	1,8	1,1	22,3
31.12.2015	2,7	143,8	73,2	20,0	1,7	1,1	21,3
31.12.2016	2,4	149,4	79,3	14,9	1,7	1,2	21,9
31.12.2017	2,7	139,2	76,9	12,7	1,3	0,9	23,9
31.12.2018	2,2	131,3	77,3	15,8	1,4	1,0	25,8
31.12.2019	2,1	122,4	76,3	9,0	1,6	1,0	25,6
31.12.2020	1,9	123,0	78,5	13,7	1,9	1,1	20,4
31.12.2021	2,2	127,1	83,9	16,3	1,8	1,3	21,3
Kriteret për borxhin të moderuar	12 - 20%	165 - 275%	30 - 50%	18 - 30%	1,00		

* Kriteri i ngarkesës së moderuar me borxh është matur sipas metodologjisë së Bankës Botërore për përpunimin e treguesve të huazimit, e cila nënkupton shfrytëzimin e proceseve tre vjeçare lëvizëse të PBB dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve si dhe prurjeve tjera si emëruet të përbashkët të përlogaritjeve të këtyre treguesve. E përpiluar në pajtim me „External debt statistics: Guide for compilers and users”, e lëshuar nga FMN. Sipas parimeve të Grinspan dhe Gvidoti, e nevojshme është që vendi të ruaj mbulim të plotë të borxhit afatshkurtë (maturimi i pjesës së ngelur) me rezerva valutore.

Burimi: BPRMV.


3.5. Agregatat monetare dhe kreditorë³⁶

3.5.1. Agregatat monetar

Gjatë vitit 2020, ekonomia e vendit gradualisht rimëkëmbej nga goditja e forte e pandemisë në vitin e kaluar, gjatë pasigurisë të vazhdueshme të shkaktuar nga përhapja e varianeteve të reja të infeksionit të virusit covid-19, e cila edhe më tej pjesërisht ndikojë mbi konsumimin dhe investimin. Në rrethana të tilla, oferta monetare dhe depozitat totale në sektorin financiar³⁷ edhe më tej rriten. Madje, masat shtetërore për përkrahje financiare të kompanive të prekura nga kriza (veçanërisht në sektorin energjetik) dhe pagimi i mjeteve për ballafaqim me pasojat e pandemisë, si në këtë vit ashtu edhe në vitin e kaluar në një pjesë kontribuon për rritje të masës monetare dhe depozitave.

Grafikoni 45


Masa monetare M4 dhe totali i depozitave



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 46

Masa monetare M4, pjesëmarrja në PBB



Masa më e madhe monetare M4, në vitin 2021 shënoi rritje prej 7%, rritje e ngjashme me vitin e kaluar. Shikuar në mënyrë strukturore, në kushtet e rritjes së pasigurisë për shkak të pandemisë dhe tendencës për mbajtjen e aktiveve në formë likuide, shënohet rritje e përbërësve më likuidë të M4 - para të gatshme në qarkullim dhe parave të depozituara, por më e moderuar në raport me vitin e kaluar. Në fakt, paratë e gatshme në qarkullim shënuan rritje vjetore prej 1,8%, në pjesëmarrjen e tyre në masën më të gjerë monetare prej 8,5% (9% në vitin 2020). Nga aspekti afatizues, vërehet një rënie e depozitave afatgjata, duke përshpejtuar rritjen e depozitave afatshkurte. Treguesit e pjesëmarrjes në ndryshimin vjetor të masës monetare në PBB-në janë mbajtur në nivel relativisht stabil dhe në fund të vitit arrin 4,7% (4,8% në vitin 2020). Madje në kushte të rimëkëmbjes së aktivitetit ekonomik, pjesëmarrja e masës monetare në PBB-në në fund të vitit ishte 71,6% në krahasim 74,2 në vitin e kaluar.

³⁶ Të dhënat e depozitave totale dhe kredive nga gushti 2020 e këndej nuk i përfshinë të dhënat e një banke e cila në gusht 2020 i është ndërprerë leja e themelimit dhe funksionimit dhe është hapur procedura e falimentimit. Me qëllim që në mënyrë më reale të shikohen rrjedhat e arritura në sistemin banka, pa efektin e ndryshimit të tillë në pasqyrën e të dhënave të statistikës monetare, e cila realizimet e depozitave të përgjithshme dhe rrjedhave të kreditove në vitin 2020 janë bërë rregullimet e flukseve të të dhënave për bankat përkatëse. Gjegjësisht, korrigjimi i totalit të depozitave është bërë duke përfshirë shumën e depozitave të cilat nuk i nënshtrohen kompensimit përmes FOD në gjendjen rrjedhëse të gjithsej depozitave, ndërsa korrigjimi i totalit të kredive është bërë duke përfshirë të dhënat e korrikut për gjendjen e bankave në gjendjen aktuale të totalit të kredive.

³⁷ Të dhënat i referohen depozitave të sektorit joshetëtor në banka dhe kursimore, mjeteve të institucioneve të tjera financiare në llogaritë në Bankës Popullore dhe mjeteve të njëjësive të vetëqeverisjes lokale në llogaritë e Bankës Popullore. Të dhënat korrespondojnë me ndryshimet metodologjike të Bankës Popullore nga qershori 2018. Më shumë informacion rreth ndryshimeve metodologjike mund të gjeni në linkun e mëposhtëm:

http://www.nbkm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspj.


Tabela 2
Komponentë të masës monetare – gjendjet dhe ndryshimet

	Gjendja			Ndryshimet vjetore		
	2019	2020	2021	2019	2020	2021
	në milionë denarë			në %		
Paratë e gatshme në qarkullim	36.108	43.701	44.480	12,0	21,0	1,8
Paratë në depozitë	139.580	160.765	177.716	18,7	15,2	10,5
M1	175.688	204.466	222.196	17,2	16,4	8,7
Depozita afatshkurtër në denarë deri 1 vjet	49.042	44.042	40.033	-0,9	-10,2	-9,1
Depozita afatshkurtër valutore deri në 1 vjet	120.160	134.950	160.778	4,9	12,3	19,1
M2	344.889	383.458	423.007	9,9	11,2	10,3
Depozita afatgjate në denarë mbi 1 deri 2 vjet	36.845	30.665	27.727	-3,4	-16,8	-9,6
Depozita afatgjate valutore mbi 1 deri 2 vjet	22.294	22.108	24.020	3,9	-0,8	8,6
M3	404.028	436.231	474.753	8,2	8,0	8,8
Depozita afatgjate në denarë mbi 2 vjet	35.767	34.667	29.376	21,8	-3,1	-15,3
Depozita afatgjate në valutë mbi 2 vjet	15.616	16.092	16.876	11,5	3,0	4,9
Gjithsej depozita*	279.723	282.523	298.809	4,8	1,0	5,8
Gjithsej depozita	419.303	443.288	476.525	9,0	5,7	7,5
M4	455.411	486.989	521.005	9,3	6,9	7,0

* pa para depozitare


Burimi: BPRMV.

Grafikoni 47
Masa monetare, ndryshimet vjetore dhe struktura



Në vitin 2021, totali i depozitave në sektorin financiar realizoi rritje prej 7,5%, e cila ishte më e fuqishme në krahasim me vitin paraprak (5,7%³⁸). Analizuar nga aspekti sektorial, edhe këtë vit bartës i rritjes janë depozitat e familjeve, me rritje të njëkohshme të depozitave të ndërmarrjeve. Analizuar nga aspekti valutor dhe afatizues, si në vitin e kaluar është shënuar rritje të kontributeve të depozitave valutor dhe depozitave afatshkurte. Depozitat në monedhën vendase vazhdojnë të rriten (në tërësi si rezultat i parave depozitare), por dukshëm më të ulëta se në vitet e kaluara.

Grafikoni 48
Totali i depozitave (me para depozitare), ndryshimi vjetor dhe kontributi në ndryshimin e aspektit sektorial




Burimi: BPRMV.

Depozitat e familjeve³⁹ shënuar rritje vjetore prej 7,1% në vitin 2021 (4,6% në vitin 2020). E analizuar nga aspekti strukturës valutor dhe afatizuese, gjatë vitit 2021 u përshpejtua rritja e kursimeve të familjeve me afat të shkurtë dhe në valuta të huaj, gjatë zvogëlimit të depozitave afatgjate dhe ngadalësimi i rritjes së depozitave në denarë.

³⁸ Me përfshirjen e të dhënave nga banka në falimentim, rritja e depozitave në vitin 2020 është 6,3%.


³⁹ Të dhënat e depozitave përfshijnë paratë depozituese..

Grafikoni 51
Totali i kredive dhe norma aktive e interesit



Burimi: BPRMV.


Grafikoni 52
Totali i kredive, pjesëmarrja në PBB



Sipas Anketës së Aktivitetit Kreditor të Bankës Popullore, në vitin 2021 shënohet neto-rritje të kërkesës për kredit nga ana e familjeve dhe ndërmarrjeve, gjatë neto-lehtësimit të kushteve kreditore të familjet dhe neto-shtërgim i moderuar të ndërmarrjet. Nga aspekti i rrezikut, të ndërmarrjet edhe më tej shënohet një rritje të perceptimit të rrezikut, por dukshëm më e moderuar se vitin e kaluar, analizuar nga pritshmëritë e bankave për aktivitetin e përgjithshëm ekonomik.


Mbështetja e kredisë për bankat, në vitin 2021, ka qenë pothuajse e barabartë si për ndërmarrjet ashtu edhe për familjet, me një përshpejtim të ndjeshëm të kreditimit të korporatave. Për sa i përket kreditimit për familjet, analiza sipas llojeve individuale të kredisë tregon se nxitës i rritjes është kredia banesore, me një përshpejtim të caktuar të rritjes edhe të kredisë konsumatore. Nga aspekti valutor dhe afatizues, rritja vjetore e gjithsej kredive në masë të madhe është rezultat i kredive në denarë, si dhe i kredive afatgjata.

Grafikoni 53
Totali i kredive, ndryshimi vjetor dhe struktura sektoriale




Burimi: BPRMV.

Grafikoni 54
Totali i kredive për familjet, ndryshimi vjetor dhe struktura sipas dedikimit




*Në totalin e kredive të popullatës nuk janë përfshirë kreditet të veprimtarive të aktivitetit të pavarur - me vetpunësim.

Grafikoni 55
Oferta dhe kërkesa (neto-përqindje)*



* Te kushtet e kreditimit, neto-përqindja negative nënkupton lehtësim të kushteve të kreditimit. Të kërkesa, neto-përqindja negative nënkupton ulje të kërkesës.
Të dhëna më të hollësishme mbi aktivitetin kreditues mundet të gjenden në faqen zyrtare të BPRMV.
Burimi: Anketa mbi aktivitetin kreditues, BPRMV.

Grafikoni 56
Analiza të rrezikut nga ana e bankave (neto-përqindje)*



* Te familjet është paraqitur mesatarja e neto-përqindjeve të faktorëve të riskut të cilat ndikojnë mbi kushtet e kreditimit gjatë miratimit të kredive banesore dhe atyre të konsumit.

IV. Mjedisi makroekonomik dhe politika monetare në vitin 2022 dhe 2024⁴¹

Politika monetare e Bankës Popullore do të vazhdojë të jetë e synuar në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, si qëllim bazë monetar i përcaktuar në pajtim me dispozitat ligjore. Banka Popullore do të vazhdojë të kontribuojë në ruajtjen e sektorit bankar të qëndrueshëm dhe konkurrues dhe do të mbështesë politikën e përgjithshme dhe rimëkëmbjen ekonomike, në kushte të zgjatjes së pandemisë si dhe rreziqeve gjeopolitike, pa rrezikuar arritjen e qëllimit themelor. Për arritjen e qëllimit të përcaktuar me ligj, Banka Popullore do të vazhdojë me zbatimin e strategjisë për ruajtjen e qëndrueshme të kursit nominal valutor të denarit ndaj euros. Rëndësia e kursit valutor për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe pritjeve të qëndrueshme të inflacionit të subjekteve ekonomike lind nga karakteristikat e ekonomisë vendore, si ekonomi e vogël dhe e hapur, me varësi të lartë nga importi. Korniza operativa e politikës monetare, si deri më tani, do të vendoset mbi baza fleksibile, e cila do të sigurojë likuiditet dhe ekuilibër të qëndrueshëm në tregun valutor. Kështu, politika monetare do të kontribuojë në ruajtjen e stabilitetit të përgjithshëm makroekonomik, si faktor kyç në krijimin e një mjedisi të volitshëm për rritje të qëndrueshme ekonomike.

Gjatë vitit 2021, Banka Popullore zhvillonte politikë monetare të aftësuar, duke e ulur normën bazë të interesit në nivelin më të ulët historik prej 1,25%, e cila që nga fillimi i pandemisë ka kontribuar në vazhdimësi në mbështetjen e rrjedhave kreditore dhe ruajtjen e likuiditetit në sistemin bankar si dhe në zbutjen e efekteve të pandemisë në ekonominë vendore. Karakteri i dobësuar i politikës monetare është zbatuar në kushte të nivelit solid të rezervave valutore dhe inflacionit mesatar, nën ndikimin e faktorëve të ofertës dhe mospërputhjeve të përkohshme të ofertës dhe kërkesës, të shkaktuar nga pandemia, të cilat ishin më shumë të shprehura në tremujorin e fundit të vitit.

Sipas parashikimeve më të fundit zyrtare makroekonomike të Bankës Popullore, rimëkëmbja e ekonomisë vendore është në pajtim me pritshmëritë, pavarësisht pasigurisë që lidhet me krizën pandemike dhe shfaqjen e një vale të re të pandemisë në fund të vitit 2021. Kështu, projeksionet e rritjes përmbajnë supozime për përmirësimin e mjedisit të jashtëm ndërsa ka vlerësime për rikuperim më të theksuar të kërkesës së huaj dhe konjunkturë më të volitshme të çmimeve të metaleve, që do të ketë efekt stimulues në segmentin e eksportit të brendshme. Nga ana tjetër, një faktor i pafavorshëm nga mjedisi i jashtëm që është shfaqur në periudhën e fundit janë ndërprerjet e zinxhirëve global të furnizimit, transportit dhe logjistikës, të cilat ndikojnë në procesin e rregullt të prodhimit në mbarë botën, veçanërisht në sektorin automobilistik dhe industrisë ushqimore si dhe presionet në rritje inflacioniste dhe kriza energjetike. Tendenca të tilla të pafavorshme dhe efektet e tyre në ekonomi vlerësohen si të përkohshme, ndërsa pritjet për stabilizimin e tyre gjatë vitit 2022 janë ruajtur. Megjithatë, përshkallëzimi aktual i krizës dhe armiqësive ruso-ukrainase është një faktor i ri rreziku dhe i papritur, i pafavorshëm për rritjen e parashikuar, përmes kanalit të kërkesës së huaj dhe thellimit të krizës energjetike, por edhe përmes rritjes së përgjithshme të pasigurisë. Për sa i përket mjedisit të brendshëm, parashikimet e fundit tregojnë se zbatimi i procesit të imunizimit do të vazhdojë të ndikojë pozitivisht në besimin dhe sjelljen e subjekteve ekonomike, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve ekonomike, me pritshmëri për stabilizim gradual të situatës epidemiologjike dhe përfundim

⁴¹ Në këtë pjesë është dhënë pasqyrë e projeksioneve makroekonomike të Bankës Popullore deri më tetor 2021.

gradual të efekteve negative nga kriza shëndetësore. Sipas kësaj, aktiviteti i brendshëm ekonomik pritet të kthehet në nivelet para pandemisë në vitin 2022, me normë rritjeje të pritshme prej 3,9%. Rritja e ekonomisë do të vazhdojë edhe në vitin 2023 dhe 2024, me të njëjtin rritëm të pritshëm si në prill, prej 4%. Nga pikëpamja e strukturës së PBV-së, ende parashikohet se rritja ekonomike në periudhën e ardhshme do të jetë tërësisht si pasojë e kërkesës së brendshme, e cila do të kishte kontribut pozitiv më të lartë për rritjen, krahasuar me eksportin neto, që do të kishin kontribut negativ më të theksuar.

Pas përshpejtimit të përkohshëm në vitin 2021, nën ndikimin e faktorëve në anën e ofertës, realizimet dhe pritshmëritë e disponueshme në periudhën e projeksioneve të tetorit kanë treguar se gjatë vitit 2022 mund të pritet ngadalësim i rritjes së çmimeve në ekonominë vendore, ku norma e inflacionit mesatarisht do të ishte 2,4%. Me stabilizimin e tregjeve primare botërore dhe uljen e presioneve nga importi mbi çmimet e brendshme, parashikohet që inflacioni të ulet në vitin 2023 dhe të ulet sërish në mesataren historike prej 2%, duke qëndruar në atë nivel në vitin 2024. Kjo lëvizje rënëse e inflacionit paraqitet kryesisht nga supozimet e integruara për rritje më mesatare të çmimeve të energjisë në bursat botërore, për të cilat aktualisht ka rreziqe të theksuara në rritje, të theksuar më tej nga zhvillimet në Ukrainë, të cilat ndër të tjera shkaktojnë presion të fortë mbi lëndët e para të tregjeve botërore.

Vlerësimet për pozicionin e jashtëm të ekonomisë, në pajtim me arritjet e deritanishme, janë të favorshme për periudhën afatmesme. Sipas pritshmërive për stabilizim të lëvizjeve në ekonominë globale në gjysmën e dytë të vitit 2022, deficit i llogarisë rrjedhëse do të mbetet në 3,8% të PBV-së në vitin 2022, me stabilizim të parashikuar të deficitit në tregtinë e mallrave dhe shërbimeve, deficit pak më të ulët në të ardhurat primare si dhe flukse neto relativisht të qëndrueshme nga transfertat rrjedhëse. Për periudhën 2023-2024 parashikohet përmirësim i mëtejshëm i llogarisë rrjedhëse, ku deficit mesatar do të ishte 2% e PBV-së, në kushtet e përfundimit gradual të rreziqeve pandemike, stabilizimit të situatës në nivel global, si me zinxhirët e furnizimit ashtu edhe me presionet e përkohshme të çmimeve sidomos tek energjia, të cilat do të shkaktonin përmirësim të ndjeshëm në saldon e mallrave dhe shërbimeve. Parashikohet që huamarrja e sektorit publik dhe rritja e mëtejshme e investimeve të huaja direkte të jenë burimet kryesore të financimit të deficitit të llogarisë rrjedhëse, gjë që do të mundësonte rritjen e mëtejshme të rezervave valutore. Gjatë gjithë periudhës së projeksionit, rezervat valutore pritet të mbeten në nivelin e duhur. Rreziqet e treguara gjeopolitike kanë të bëjnë edhe me projeksionet në sektorin e jashtëm, duke pasur parasysh varësinë e ekonomisë maqedonase nga importi, por edhe mundësinë e rritjes së refuzimit ndaj rrezikut të investitorëve global, me efekt ndaj rrjedhat e kapitalit.

Aktiviteti kreditues i sistemit bankar mbetet një nga faktorët e rëndësishëm për mbështetjen e rritjes ekonomike. Në këtë drejtim, ruajtja e karakterit fleksibil të politikës monetare si dhe pozicioni i shëndoshë dhe solvent likuidues i bankave, si faktorë që vazhdojnë të kenë ndikim stimulues në ofertën e kredive. Të dhënat e tregut të kredive për vitin 2021 tregojnë për përshpejtimin e aktivitetit kreditues dhe ruajtjen e ritmeve solide të rritjes në tre vitet e ardhshme. Në kushtet e rritjes së ekonomisë vendore, stabilizimit të pritjeve dhe rritjes së kërkesës për kredi nga amvisëritë dhe sektori korporativ, në periudhën e ardhshme pritet stabilizim gradual i aktivitetit kreditor, me normë mesatare të rritjes prej 6,9% në periudhën 2022-2023 dhe 7,8% në vitin 2024. Rritja e kredive, si deri më tani, do të mbështetet nga rritja solide e depozitave, si burim kryesor i financimit të bankave. Sipas vlerësimeve për stabilizimin e mjedisit, forcimin e aktivitetit ekonomik dhe rritjen e mëtejshme të prirjes për kursim në banka, pritet normë mesatare vjetore e parashikuar e rritjes së depozitave prej 7,5% në periudhën 2022 - 2023 dhe 8% në vitin 2024.

Aktualisht, pasiguria dhe rreziqet janë të theksuara, si në nivel global, ashtu edhe në ekonominë vendore. Krahas rrezikut kryesor negativ që lidhet me ecurinë e ardhshme të pandemisë gjegjësisht rreziqet e përhapjes së llojeve të reja, të cilat mund të çojnë në vendosjen e mundshme të masave më të rrepta kufizuese si dhe në përkeqësimin e rrjedhave tregtare globale dhe në prishje më të theksuar dhe afatgjatë të zinxhirit global të furnizimit, u realizua edhe rreziku gjeopolitik, kohëzgjatja dhe efektet e të cilit deri tani janë shumë të pasigurta. Në kushtet e rritjes së mëtejshme të çmimeve të lëndëve të para, zhvillimet aktuale mund të shkaktojnë rritje të presioneve të inflacionit dhe pritjeve afatgjata të inflacionit, duke imponuar nevojën për shtrëngim më të fortë të politikës monetare në vendet e zhvilluara.

Në sferën fiskale, në afat të mesëm, pritet konsolidim gradual buxhetor. Deficiti buxhetor do të financohet në mënyrë të kombinuar nga burime vendore dhe të jashtme. Politika e vendosur fiskale ndiqet me rreziqe që, njëjtë sikur tek politika monetare, dalin nga mundësitë e ballafaqimit të pandemisë, si në suaza vendore ekonomie ashtu edhe në ato globale, por edhe nga ndryshimi i kushteve financiare.

Banka Popullore edhe më tej do t'i ndjek lëvizjes aktuale dhe rreziqet prezent nga mjedisi vendor dhe i jashtëm dhe në mënyrë përkatëse, do ta vlerësojë dhe përshtat pozicionimin e politikës monetare.

V. Instrumentet monetare

Në kushtet e rritjes solide ekonomike mes lëvizjeve të ndryshueshme në ekonominë e brendshme, të shkaktuara kryesisht nga zhvillimet në mjedisin e jashtëm, por edhe nga efektet e pasigurta ekonomike që lidhen me zhvillimin dhe përballimin e pandemisë, Banka Popullore në vitin 2021 ndoqi politikë fleksibile monetare, duke ulur më tej normën bazë të interesit dhe duke mbajtur likuiditetin e valutës vendore në nivel relativisht të lartë. Konkretisht, norma bazë e interesit u ul në nivelin më të ulët historik prej 1,25%, dhe për shkak të rritjes së mbështetjes së likuiditetit të sistemit bankar, zgjerimit të mundësive investuese të bankave dhe mbështetjes financiare të rritjes ekonomike, Banka Popullore ruajti shumën e instrumentit elementar në nivelin e njëjtë. Mbështetja e ekonomisë u mundësua nga zbatimi i mëtejshëm i masës jostandarde në rezervën e detyrueshme, e cila ofron mbështetje kreditore të synuar për sektorët më të prekur.

Gjatë nivelit solid të rezervave valutore, mungesë të presioneve të theksuara të inflacionit dhe përpjekje për lehtësim shtesë të kushteve financiare dhe mbështetje të flukseve reale në ekonomi, Banka Popullore në tremujorin e parë të vitit 2021 vazhdoi ciklin e lehtësimit të politikës monetare. Kështu, në muajin mars, uli për 0,25 % normën bazë të interesit për bono thesaret, në nivelin më të ulët historik prej 1,25%⁴². Natyra fleksibile e politikës monetare, zbatimi i masave më pak kufizuese për përballimin e valëve të reja të Covid-19, imunizimi i popullsisë dhe normalizimi i proceseve të biznesit patën ndikim pozitiv në mjedisin e brendshëm dhe mundësuan tendencë të mëtejshme të favorshme në tregjet vendore financiare, që filluan në gjysmën e dytë të vitit 2020. Konkretisht, në tre tremujorët e parë të vitit në tregun e valutave dhe këmbimoreve, ulja e prirjes së popullatës për fondet e huaja dhe rritja e flukseve valutore nga transfertat private kanë mundësuar rritje të vazhdueshme të ofertës neto në valutë nga këto subjekte dhe normalizimin e saj në nivelet e para krizës. Këto trende kanë ndikuar në rritjen e likuiditetit devizor të bankave dhe në ndërhyrjet e Bankës Popullore për blerje neto të tepricës së valutave nga sistemi bankar. Stabilizimi i pritjeve të subjekteve vendore ishte i dukshëm përmes normalizimit të kërkesës për para të gatshme në denarë⁴³. Në periudhën e njëjtë, masat e synuara buxhetore për revitalizimin e ekonomisë vendore, edhe pse më mesatare krahasuar me vitin 2020, sollën rritje të mëtutjeshme të mjeteve likuiduese të bankave në valutë vendore.


Trendet e volitshme të tregut valutor ndryshuan në tremujorin e katërt të vitit, si pasojë e rreziqeve që vinin nga mjedisi i jashtëm i ekonomisë vendore. Ndryshimet e këtij segmenti të tregut që u pasqyruan me kërkesë të rritur të valutave i udhëhoqën kompanitë e sektorit energjetik, si pasojë e çmimeve më të lartë të karburanteve në tregjet botërore. Rritje e çmimit të karburanteve dhe produkteve elementare në tregjet ndërkombëtare financiare si dhe rritja mesatare e inflacionit në suazat vendore dhe ndërkombëtare, kanë krijuar pritje të mëdha të inflacionit tek popullata, me çka është rritur prirja për mbajtjen e mjeteve të huaja. Këto ngjarje kanë imponuar nevojën për komunikim të përforcuar të Bankës Popullore me publikun, por edhe për intervenime për shitjen e devizave në bankat vendore, duke mundësuar mirëmbajtje të mëtutjeshme të stabilitetit të kursit valutor të

⁴² Rrjedhimisht, norma më të ulëta të interesit janë zbatuar edhe te repo- ankandet për krijimin e likuiditetit dhe të kredive të disponueshme brenda natës, norma e interesit e të cilave është e njëjtë gjegjësisht më e lartë për 0,5% pikë në raport me normën e interesit të bono thesareve, në mënyrë përkatese.

⁴³ Ndryshimi i të hollave të gatshme në qarkullim në nëntë muajt e parë të vitit që e ndiqte dinamikën në vitet para krizës, por edhe më tej ishte në nivel më të lartë mesatar.


denarit. Prezenca e Bankës Popullore në tregun valutor, e mbështetur nga niveli solid i rezervave valutore, ka mundësuar mbajtje të vazhdueshme të likuiditetit valutor të sistemit bankar në nivelin e duhur⁴⁴, kështu që Banka Popullore edhe në vitin 2021 nuk kishte nevojë për shfrytëzimin e mjeteve nga repo-linja me BQE-në, për sigurimin e likuiditetit valutor në euro⁴⁵. Efekti likuidues nga intervenimet e Bankës Popullore me bankat mbështetëse pjesërisht u tejkalua me konsumin e rritur buxhetor, për shkak të mbështetjes financiare të importit dhe prodhimit të energjisë elektrike. Njëkohësisht, për rritjen e një pjese të mjeteve të lira të bankave kanë kontribuar edhe paratë e gatshme në qarkullim, të cilat me përjashtim të rritjes sezonale të konsumi të denarit të gatshëm, pak para festave të fundvitit, në tremujorin e katërt të vitit 2021, kishin dinamikë të shprehur rënës⁴⁶.

Grafikoni 57
Korridori i normave të interesit



* 7DD – depozitat shtatë ditore të disponueshme; DNJD – depozita njëditore; KNJD – kredi njëditore

Grafikoni 58
Bonat e thesarit dhe likuiditeti i tepriçës së mjeteve në bankë⁴⁷



⁴⁴ Menaxhimi me likuiditetin valutor të bankave përfshin mundësi për to që të plasojnë plasmanë pa rrezik në euro te Banka Popullore me afat prej 1 deri 3 muaj. Bankat kishin interes mesatar për plasimin e mjeteve në këtë instrument, që Banka Popullore e aktivizoi në gusht të vitit 2020.


⁴⁵ Në gusht të vitit 2020, BQE vendosi repo-linjë për Bankën Popullore për sigurimin e likuiditetit valutor në vlerë të përgjithshme prej 400 milionë euro. Kjo linjë është e kapshme deri në mars të vitit 2022 dhe krijon hapësirë shtesë për veprim të shpejtë dhe efikas të Bankës Popullore nëse ka nevojë për sigurimin e likuiditetit valutor në euro për bankat e vendit. Në mars të vitit 2022, repo-linja u vazhdua deri në janar të vitit 2023, për shkak të pasojave globale nga kriza ruso-ukrainase.

⁴⁶ Trendi në rënie në tre muajt e fundit të vitit ka shkaktuar rritje dyfish më të dobët vjetore të parave të gatshme në qarkullim (1,3 miliardë denarë) në raport me mesataren e viteve para krizës, me çka janë neutralizuar rreth 50% nga rritja më e lartë të kërkesës të denarit të gatshëm në vitin 2020.

⁴⁷ Fondet e tepërta likuidive të bankave kanë të bëjnë me ditën e parë të periudhës së rezervave të detyrueshme kur mbahen ankandet e boneve të thesarit dhe paraqesin shumën totale të fondeve të rregullta të llogarive të bankave në Bankën Popullore, shumën e arritur e pagesës së boneve të thesarit dhe depozitat e disponueshme të BPRMV dhe kërkesa e tregut të parave, zvogëlimi i detyrimeve të tregut të parave dhe shumën e rezervave të detyrueshme në periudhën vijuese.

Grafikoni 59

Rrjedha e likuiditetit nga faktorët autonom




* FTA – Faktorë të tjerë autonom

Burimi: BPRMV.

Grafikoni 60

Gjendja e instrumenteve monetare



Me qëllim të krijimit të hapësirës për shfrytëzimin e mjeteve të tepërta në denarë për mbështetje të mëtutjeshme kreditore për ekonominë, përkundër rritjes vjetore të likuiditetit në denarë të bankave, i cili është vazhdimisht në nivel relativisht të lartë, Banka Popullore gjatë tërë vitit ka mbajtur të njëjtën shumë të bonove të thesarit prej 10 miliardë denarë⁴⁸. Edhe gjatë vitit 2021, bankat e drejtuan tepicën e parave të gatshme kryesisht në depozitat në dispozicion pranë Bankës Popullore⁴⁹, të cilat mundësojnë fleksibilitet në menaxhimin e ndryshimeve afatshkurtra të likuiditetit dhe disponueshmëri të lartë të mjeteve. Nga aspekti i afatizimit, ngjashëm me vitet e mëparshme, bankat në vitin 2021 në mënyrë të fuqishme i përdori depozitat njëditore të disponueshme, gjendja mesatare e të cilave në fund të vitit ishte 34,5 miliardë dhe ishte më e lartë se niveli para fillimit të pandemisë për rreth 3 miliardë denarë.⁵⁰ Pikërisht për shkak të shumës së lartë të mjeteve të lira, bankat nuk kishin nevojë të siguronin mjete nga Banka Popullore përmes kredive njëditore dhe repo-ankandeve për të krijuar likuiditet (të cilat mbaheshin një herë në javë). Gjithashtu, pozicioni solid i likuiditetit u mundësoi bankave të kenë vetëm nevojë të rastësishme dhe të ulët për huamarrje në tregun ndërbankar për depozita të pasigurta.

Shtojca 1. Zhvillimet në tregun valutor⁵¹ dhe ndërhyrjet e Bankës Popullore

Në vitin 2021, në tregun valutor, në transaksionet e bankave me klientët e tyre, u regjistruan performanca vjetore dukshëm më të mira me personat fizik dhe këmbimoret. Në fakt, masat e synuara për parandalimin e përhapjes së virusit, imunizimin e popullatës dhe lehtësimin e kushteve për lëvizjen ndërkombëtare të pasagjerëve kanë reflektuar pozitivisht në ofertën e valutës nga ana e personave fizik në tregun valutor dhe të tregun këmbimor, e cila ka shënuar rritje solide dhe kontribuoi në rritjen e flukseve valutorë në sistemin bankar. Oferta më e lartë e parave të huaja nga ana e personave fizik në tregun këmbimor (edhe atë veçanërisht në transaksionet me këmbimoret) ka kontribuar në një rritje të ndjeshme (për gjithsej 399,7 milionë euro në bazë vjetore) të tepicës së valutës që këmbimoret jua ofrojnë bankave të vendit dhe normalizimi i plotë i lëvizjeve në nivelet parapandemike. Tendenca të favorshme ka pasur edhe në transaksionet me personat fizik, ku neto-shitja e valutave në bankë për nevojat e këtij subjektit janë më të ulëta për 32.3 milionë euro, në krahsim me vitin 2020.

⁴⁸ Në ankandet e bonove të thesarit, të cilat mbahen në ditën e parë të periudhave të rezervës së detyrueshme, aplikohet tender me shumë (shuma e ofertës së kufizuar dhe norma fikse e caktuar e interesit).


⁴⁹ Normat e interesit për depozitat njëditore të disponueshme me afatizim prej shtatë ditë në vitin 2021 janë mbajtur përkatësisht në nivelin 0,15% dhe 0,30%.

⁵⁰ Plasmanet në depozitat shtatëditore në dispozicion në Bankën Popullore gjatë vitit kanë qenë relativisht të ulëta dhe të qëndrueshme, mesatarisht rreth 1.000 milionë denarë.

⁵¹ Tregu valutor në kuadër të kësaj analize i përfshinë transaksionet në mes bankave dhe klientëve të tyre dhe tregtimet ndërbankare.

Grafikoni 61


Neto –shitja e valutave në bankë për klientët e tyre



Burimi: BPRMV.


Grafikoni 62

Ndryshimet vjetore të ofertës dhe kërkesave për valutë, në klientë



Grafikoni 63


Blerja e valutave e bankave nga këmbimoret, sipas tremujorëve



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 64


Neto – oferta/kërkesat e valutave nga personat fizikë në tregun valutor, sipas tremujorëve



Rimëkëmbja graduale e aktivitetit ekonomik në ekonominë vendase, ndërprerja e zinxhirëve të furnizimit dhe prodhimit në nivel global, si dhe ndryshimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare në tremujorin e fundit të vitit janë reflektuar në ofertën dhe kërkesën për valutë nga kompanitë. Në fakt, neto-shitja e valutës në banka për nevojat e sektorit korporativ ishte më e lartë në bazë vjetore (për 406 milionë euro), në kushtet e rritjes vjetore të kërkesës dy herë më të lartë krahasuar me rritjen e ofertës për valutë. Nevoja e rritjes për likuiditet valutor lindi nga kompanitë që prodhojnë dhe tregtojnë naftë dhe energji elektrike, duke pasur parasysh rritjen e disafishtë të çmimeve të energjisë në tregjet botërore. Ndryshimi i dinamikës së çmimeve të produkteve primare dhe ushqimeve në nivel global ka ndikuar në rritjen e moderuar të kërkesës për valutë nga kompanitë e tregtisë dhe prodhimit të ushqimeve, pijeve dhe duhanit dhe tregtisë me shumicë. Një pjesë e rritjes së kërkesës u plotësua nga oferta më e lartë e likuiditetit në valutë nga kompanitë e shërbimit të sektorit të informatikës dhe kompanitë e industrisë së metaleve dhe automobilave.


Grafikoni 65

Kërkesa e valutave nga firmat në tregun valutor, sipas tremujorëve



Grafikoni 66


Oferta e valutave nga firmat në tregun valutor, sipas tremujorëve



Për rrjedhojë, neto-shitjet të valutës nga bankat për nevojat e klientëve për të dytin vit radhazi mbetën në një nivel relativisht të lartë (769,6 milionë euro). Duke pasur parasysh se bankat kanë siguruar pjesën më të madhe të mjeteve likuide valutore të burimet vetjake, por edhe në tregun ndërbankar të këmbimit valutor (qarkullimi prej 1.025 milionë euro), Banka Popullore ka ndërhyrë për neto-shitje të valutës në vitin 2021 (120 milionë euro) ishin katër herë më të ulëta krahasuar me vitin e kaluar. Madje për dallim nga viti 2020, kur Banka Popullore morri pjesë në tregun valutor vetëm duke shitur valutë (me përjashtim të blerjes së vogël të realizuar në fund të vitit), në vitin 2021 ajo ndërhyr në të dy drejtimet. Në fakt, në rast të tendencave më të mira të tregut dhe likuiditetit solid valutor të bankave në nëntë muajt e parë të vitit, Banka Popullore ndërhyr herë pas here, me neto-blerje të likuiditetit të tepërt në valutë. Rritja e kërkesës për valutë (kryesisht nga kompanitë) në tremujorin e katërt të vitit u transferua në tregun ndërbankar të këmbimit valutor duke rritur kërkesën për valutë. Në rrethana të tilla, Banka Popullore në tre muajt e fundit të vitit ndërhyr në tregun valutor duke shitur valutë. Krahas intervenimeve në spot-segmentin, Banka Popullore në këtë periudhë ka vepruar edhe përmes komunikimit të zgjeruar me publikun me qëllim të normalizimit të pritjeve të subjekteve vendore dhe ruajtjen e stabilitetit të kursit të denarit ndaj euros. Hapësira komode e Bankës Popullore për pjesëmarrje në tregun valutor u mbështet nga niveli solid dhe i përshtatshëm i rezervave valutore, me çka kursi i denarit ndaj euros mbeti në nivel stabil.

Grafikoni 67


Ndërhjert e BPRMV-së në tregun valutor



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 68

Kursi mesatar i denarit në raport me euron




Për arritjen e objektivave të politikës monetare, në menaxhimin e likuiditetit, edhe në vitin 2021 Banka Popullore përdori rezervën e detyrueshme. Krahas funksionit bazë të këtij instrumenti, Banka Popullore vazhdon të aplikojë masën jostandarde të rezervës së detyrueshme (e aktivizuar në mars 2020), me qëllim që të mbështet përkrahjen e pandërprerë kreditore të ndërmarrjeve nga veprimtarit të cilat ishin më të prekura nga kriza

shëndetësore⁵². Në vitin 2021, me normalizimin e mëtutjeshëm gradual të proceseve afariste, aktiviteti kreditues për sektorët e synuar u ngadalësua dhe kontribuoi në uljen gjendjes (për 1.257 milionë denarë) në këto kredi në 5.696 milionë denarë në fund të dhjetorit. Pjesa më e madhe e kredive të synuara (49%) u janë miratuar kompanive me veprimtari "transport rrugor mallrash" i cili që nga shtatori nuk është mbështetur aktivisht⁵³, pasuar nga veprimtarit shërbyese "hotelet" dhe "restorantet" të cilat janë të përfaqësuar përkatësisht me 15 % dhe 22%. Nga fillimi i aplikimit të masës jostandarde në rezervën e detyrueshme, në sistemin bankar janë lëshuar gjithsej 456 milionë denarë.

Grafikoni 69


Ndryshimet e rezervave të detyrueshme të bankave



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 70

Gjendja e kredive totale të veprimtarive të prekura nga Covid -19



Ndryshimet në detyrimet në denarë dhe valutë të bankave⁵⁴ kushtëzuan më së shumti rritjen historike më të lartë vjetore të detyrimit të bankave për rezervat e detyrueshme, për gjithsej 5.518 milionë denarë. Madje, rezerva e detyrueshme në denarë në baza vjetore ishte më e lartë për 2.799 milionë denarë (në nivel prej 29.071 milionë denarë), si dhe rritje e jashtëzakonshme e rezervës së detyruar që bankat e plotësojnë në euro (në kundërvletë të denarit për 2,719 milionë denarë), duke arritur 21.013 milionë denarë në fund të vitit. Ndryshimet e tilla në rezervën e detyrueshme nga aspekti valutë janë reflektim i rritjes relativisht më të fortë të valutës në raport me rritjen e mëtutjeshme të detyrimeve në denarë të bankave⁵⁵.

Shtojca 2. Zhvillimet në tregut ndërbankar të depozitave të pasiguara dhe tregu dytësor i letrave në vlerë ⁵⁶

Edhe gjatë vitit 2021, për shkak të sasisë së lartë të mjeteve të lira në denarë, bankat patën nevojë shumë të vogël dhe të rastësishme për huamarrje në tregjet e brendshme financiare. Rrjedhimisht, në tregun ndërbankar të depozitave të pasigurta, kërkesa (8,93 miliardë denarë) ishte mesatarisht më

⁵² Masa mundëson lirimin e një pjese të mjeteve likuide që bankat i ndajnë Bankës Popullore në bazë të rezervave të detyrueshme, përmes zvogëlimit të bazës së detyrimeve në monedhën vendase për shumën e kredive të reja të miratuara dhe të ristrukturuara, të dhëna për ndërmarrjet të cilat sipas informacionet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ishin më të prekura nga përhapja e covid -19.

⁵³ Nga periudha e shtatorit të përmbushjes së rezervës së detyrueshme, janë bërë ndryshime në fushën e aktiviteteve të mbështetura nga masa jo standarde e rezervës së detyrueshme, duke pasur parasysh listën e veprimtarive të mbështetura nga masat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

⁵⁴ Në vitin 2021, Banka Popullore nuk ka bërë ndryshime në normat dhe bazën e rezervës së detyrueshme. Detyrimet në denarë të bankave ende i nënshtrohen normës së rezervës së detyrueshme prej 8%, për detyrimet në valutë norma e rezervës së detyrueshme është 15%, ndërsa për shumën e detyrimeve të bankave në denarë me klauzolë valutore bankat janë të obliguara të ndajnë mjete në Bankën Popullore në nivel prej 50%.


⁵⁵ Më shumë detaje mbi ndryshimin në pjesën e Agregatit monetarë

⁵⁶ Analiza e tregut të parave në Maqedoninë e Veriut ka të bëjë me segmentet në vijim: tregu i depozitave të pasigurta, tregu sekondar i letrave në vlerë afatshkurte dhe letrave shtetërore dhe letrave shtetërore në vlerë afatgjate (me përjashtim të obligacioneve strukturore), tregu i depozitave të sigurta(repo-tregu).

e lartë në baza vjetore, por ende dukshëm më e ulët (për rreth 80%) në krahasim me nevojën mesatare të bankave për kompensim të nevojave afatshkurtra të likuiditetit në denarë në periudhën 2008 - 2018.

Grafikoni 71


Qarkullimi i tregun ndërbankar në depozitat e pasigurta



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 72

Likuiditeti i tepërt në sistemin bankar ⁵⁷ dhe borxhi i bankave




Kërkesa e dobët për mjete likuide të bankave u reflektua edhe në borxhin mesatar ditor të tyre (rreth 142 milionë denarë), e cila ishte relativisht stabil në nivel vjetor. Krahas likuiditetit solid në denarë, kontribut drejt vëllimit të ulët të tregtimit me depozita të pasigurta ndërbankare në vitin 2021 kishte dhe struktura afatizuese e tregtimit. Në fakt, bankat siguruan pjesën më të madhe (85%) të mjeteve të kërkuara me afat maturimi deri në një javë, që për të katërtin vit radhazi këto depozita të pasigurta tejkalojnë ndjeshëm shumën e huave njëditore. Normat e realizuara të interesit në tregun ndërbankar për depozitat e pasigurta në vitin 2021 kanë mbetur në nivel stabil. Norma mesatare e interesit ndërbankar për të gjitha transaksionet (MINB) në fund të vitit ishte 1,09% dhe ishte më e ulët për vetëm 0,01 p.p. në raport me atë të dhjetorit të vitit 2020. Huat e pasigurta ndërbankare më të përfaqësuara me afatizues prej 1 javë kishin një normë interesi relativisht stabile (mesatarisht 1,07%) dhe në nivel të pandryshuar (rreth 1%) ishte norma e interesit për depozitat e pasigurta njëditore, me të cilat tregtoheshe kohë pas kohe. Norma e interesit ndërbankar për transaksionet njëditore është ruajtur në këtë nivel (MKDONIA).

Vëllimi i letrave me vlerë të tregtuara në tregun sekondar në vitin 2020 arriti në 5.602 milionë denarë dhe ishte më i lartë për 27% në krahasim me vitin paraprak. Nga aspekti i llojeve të transaksioneve, rritja e aktivitetit tregtar vjen tërësisht si pasojë e transaksioneve definitive me letrat me vlerë, ndërsa aktiviteti i segmentit repo-tregut ishte realizuar një transaksion në shumë prej 140 milionë denarë. Në transaksionet definitive ka mbizotëruar tregtimi me letra me vlerë shtetërore në vlerë prej 5.202 milionë denarë (ose 92,9% nga qarkullimi i përgjithshëm i realizuar). Në shumën totale të letrave shtetërore në vlerë të tregtuara, vëllimi i tregtimit me obligacionet shtetërore ishte katër herë më i lartë, gjë që shpjegohet kryesisht me ndryshimet statusore të një banke. Këto transaksione, së bashku me pjesëmarrjen më aktive të bankave në këtë segment të tregut në menaxhimin e ndryshimeve afatshkurtra të likuiditetit, kontribuan në përfaqësimin më të madh (në shumën e përgjithshme prej 4.352 milionë denarë ose 83,6%) të transaksioneve definitive ndërbankare në totalin e qarkullimit të realizuar me letra shtetërore në vlerë. Nga ana tjetër, vëllimi dhe shpeshtësia e transaksioneve me letrat shtetërore me vlerë, ku të paktën një pjesëmarrës është subjekt jobankar, ishin më të ulëta në shtatë vitet e fundit. Megjithatë, pavarësisht rritjes vjetore të letrave shtetërore në vlerë të tregtuara në tregun sekondar, pjesëmarrja e tij në totalin e letrave shtetërore me vlerë të lëshuara në vend është shumë e ulët (0,02%) dhe tregon për likuiditet të dobët të mëtejshëm të këtyre instrumenteve në tregjet e brendshme financiare.


⁵⁷ Teprica e likuiditetit në sistemin bankar paraqet mbledhje e mjeteve të bankave në llogarinë bazë në Bankën Popullore dhe e mjeteve të vendosura në dispozicion, e zvogëluara për shumën e mjeteve të përdorura nga kreditë e disponueshme njëditore.

Grafikoni 73
Qarkullimi i tregut sekondar të letrave në vlerë



Burimi: BPRMV

Grafikoni 74
Struktura e transaksioneve definitive me letrat shtetërore në vlerë⁵⁸



⁵⁸ Koeficienti i likuiditetit të letrave shtetërore në vlerë është raporti ndërmjet qarkullimit të realizuar të transaksioneve të LSHV në tregun sekondar gjatë vitit dhe gjendja mesatare të LSHV të lëshuara në të njëjtën periudhë.

VI. Menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore

Në vitin 2021, rezervat valutore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: rezervat valutore) u mbajtën në nivel të lartë, kështu që Banka Popullore arriti t'i përgjigjet në mënyrë adekuate nevojave për likuiditet dhe të sigurojë kurs të qëndrueshëm të këmbimit të denarit ndaj euros. Në tregjet ndërkombëtare mbizotëruan pritjet në rritje për një rimëkëmbje solide të ekonomisë botërore, gjatë pritjeve të rritura të presioneve të inflacionit, me periudha të përkohshme pesimiste të investitorët e ndërlidhur me paraqitjen e varianteve të reja të virusit. Menaxhimi i rezervave valutore në vitin 2021, përkundër optimizmit në nivel global, u karakterizua me maturi dhe përshtatje të vendimeve të investimit me zhvillimet në ndryshimet në tregjet ndërkombëtare, e cila mundësoi realizim të mëtijshëm të parimeve bazë: sigurinë dhe likuiditetin të rezervave valutore, ndërsa u arrit profitabilitet i caktuar, përmes menaxhimit aktiv.

6.1. Gjendja dhe ndryshimi i rezervave valutore


ë vitin 2022, rezervat valutore u rritën për 283,4 milionë euro dhe në fund të vitit arritën në 3.643 milionë euro, edhe përkundër ndërhyrjeve të Bankës Popullore në tregun valutor, gjatë theksimit të presioneve të inflacionit dhe krizës energjetike në tre muajin e fundit. Rritja e rezervave valutore ka ardhur si rezultat i neto- hyrjeve të vendit nga jashtë vendi në vlerë prej 198,2 milionë euro, e cila është kontribuar më së shumti nga shpërndarja e përgjithshme e mjeteve nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (166,5 milionë euro)⁵⁹. Për rritje kontribuan dhe të hyrat e svop-transaksionet e realizuar të sigurta (103 milionë euro), të cilat aplikohen gjatë menaxhimit aktiv të rezervave valutore, si dhe rezerva e detyrueshme më të lartë të ndara në euro dhe mjetet e bankave vendase në llogaritë MIPS-EUR (90,3 milionë euro). Kontribut më të vogël të rritjes së vlerës së dollarit amerikan dhe arit⁶⁰ kryesisht nga rritja e të hyrave dhe realizimet e favorshme të tregut të letrave personale në vlerë (aksionet) në SHBA-në për shkak të pritjeve në rritje për një rimëkëmbje solide të ekonomisë globale, si dhe perceptimet e investitorëve për një shtrëngim të politikës së FED-it më herët në krahasim me pritjet paraprake.

⁵⁹ Këto mjete janë ndarë nga FMN për shfrytëzimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në gusht të vitit 2021, ndërsa në dhjetor me "Ligji për rregullimin e detyrimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar në bazë të shfrytëzimit të mjeteve nga shpërndarja e përgjithshme neto kumulative e të drejtave të posaçme të tërheqjes miratuara me një rezolutë të Bordit të Guvernatorëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar " u rregullua përdorimi i tyre.

⁶⁰ Dollari amerikan u mbyçua kundrejt euros me 7,7%, gjë që kontribuoi në rritjen e vlerës së arit në rezervat valutore me 4,3%, pavarësisht rënies vjetore të çmimit të shprehur në dollarë amerikanë me 3,8%.

Grafikoni 75


Faktorët e ndryshimit të rezervave valutore, në milionë euro



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 76

Portfolio e rezervave valutore në nivel mesatar, në milionë euro



Edhe në vitin 2021, rezervat valutore ishin të shpërndara në tre portfolie (portfolio operative, likuiduese dhe investuese), vëllim i të cilëve u përshtat në pajtim me nevojat afatshkurte për likuidim të mjeteve valutore në tregun e brendshëm valutor dhe pagesat e ardhshme të borxhit të jashtëm publik. Përkundër nevojave likuiditive afatshkurte, mjetet në përbërje të portofolit janë mbajtur në nivel relativisht të lartë në pritje të kushteve më të favorshme për investim, gjatë përjashtimit të hyrjeve të ulëta dhe negative të tregut ndërkombëtarë financiar. Në strukturën e rezervave valutore, përmes portfoliosë së veçantë edhe më tej u menaxhohej edhe me arin, siguria dhe likuidimi i të cilit është veçanërisht e shprehur në kushtet të ndryshimit të lëvizjeve në tregun financiar.

6.2. Kushtet e tregjeve ndërkombëtare financiare dhe qasje aktive në investimet e rezervave valutore

Në tregjet ndërkombëtare në vitin 2021, mbizotëruan pritshmëritë më të forta të investitorëve në mbarë botën për një rikuperim solid të ekonomisë globale, në kushtet e mbështetjes së mëtejshme të ekonomive nga politikëbërësit dhe ecurisë së procesit të vaksinimit kundër koronavirusit, ndërkohë që periudhat e pesimizmit tek investitorët ishin të përkohshme. Gjatë vitit, me heqjen e masave kufizuese për ballafaqimin me pandeminë dhe rimëkëmbjen graduale të kërkesës personale, ndërprerja e zinxhirëve të furnizimit global u bë më e theksuar, e kombinuar me mungesën e fuqisë punëtore, kontrollet kufitare, kërkesat për paga më të larta dhe aranzhmane më fleksibile të punës, kontribuan në zvogëlimin e ofertës së prodhimit dhe shërbimit dhe e ngritën ciklin e rritjes së inflacionit në nivel global. Presionet inflacioniste u intensifikuan më tej në fund të vitit për shkak të krizës energjetike (veçanërisht në Evropë)⁶¹. Për rrjedhojë, pjesëmarrësit në tregjet financiare ndërkombëtare forcuan pritshmëritë për normalizimin e politikave monetare të bankave qendrore kryesore. Në kushte të tilla, daljet e obligacioneve të shtetërore të SHBA-së u rritën ndjeshëm në bazë vjetore, daljet e obligacioneve më të sigurta shtetërore të eurozonës ndoqën këtë prirje, por në mënyrë më të moderuar (më e theksuar ishte rritja e daljeve të obligacioneve që përmbajnë premi kreditore⁶²) dhe çmimet e aksioneve realizuan normë të dyfishtë të rritjes, duke arritur nivel më të lartë historikisht. Madje, bankat qendrore

⁶¹ Kriza energjetike ka shkaktuar një rritje të fortë të çmimit të gazit natyror (me rreth 254% në bazë vjetore) dhe disa herë rritje të çmimit të energjisë elektrike në Evropë.

⁶² I referohet obligacioneve shtetërore të ekonomive periferike të eurozonës, letrave me vlerë të kolateralizuara, letrave me vlerë të korporatave të bankave, etj.

kryesore treguan fillimin e ciklit të tërheqjes graduale të stimullit monetar dhe normalizimin e kushteve monetare në nivel global, i cili ishte në përputhje me pritjet e tregut. Kështu, në fund të vitit, FED jo vetëm uli blerjet e obligacioneve, por vendosi ta bëjë këtë me shpejtësi. Në mbledhjen e BQE-së në korrik, në përputhje me strategjinë e re të bankës qendrore, u njoftua se normat e interesit pritet të mbeten në nivelin aktual ose më të ulët, me çka inflacioni do stabilizohej në nivel prej 2 % në afat të mesëm. Në dhjetor, BQE-ja paralajmëroi përfundimin e zbatimit të programit për blerje të letrave në vlerë e futur për shkak të pandemisë e shkaktuar nga virusi covid-19 (Pandemic Emergency Purchase Program, PEPP) deri në fund të marsit 2022 dhe paralajmëroi rritje të përkohshme të neto-blerjeve të obligacioneve përmes programit për blerje të letrave në vlerë (Asset Purchase Programme, APP), zbatimi i të cilëve do të vazhdonte derisa të shihet nevoja për të. Presidentja e BQE-së shprehu shqetësimin për presionet inflacioniste dhe konfirmoi se ato janë të një natyre më të qëndrueshme në krahasim me vlerësimet e mëparshme.

Prania e vazhdueshme e bankave qendrore më të mëdha në tregjet financiare dhe programet e gjera monetare dhe fiskale në mbështetje të ekonomive kontribuan në përmirësimin e perspektivës për instrumentet që përmbajnë primet e kredisë, si dhe për institucionet financiare, ashtu që u rinovuan plasmanet afatshkurte të bankat afariste, në bazë të pasigurt dhe të sigurt. Paralajmërimet për normalizimin e politikës monetare dhe për rrjedhojë, rritja e kthimit, kontribuan në uljen e vlerës së tregut të instrumenteve me të ardhura fikse, por hapën mundësi të reja investimi për mjetet e disponueshme dhe në kushtet e kohëzgjatjes së shkurtër të përshtatjes së portofolit, ofruan kushte më të favorshme për riinvestim. Megjithatë, zhvillimet e ndryshueshme në tregjet ndërkombëtare imponuan nevojën e kujdesit dhe përshtatjes aktive të vendimeve investuese në menaxhimin e rezervave valutore, për shkak të arritjes së mëtejshme të papenguar të parimeve bazë investuese: siguria, likuiditeti dhe profitabiliteti. Duke nisur nga parimi i sigurisë së investimeve në rezerva valutore, i cili ka prioritetin më të lartë, Banka Popullore gjatë vitit 2021 një pjesë të madhe të investimeve të reja në rezerva valutore orientoi në instrumentet më të sigurta financiare, ndërsa për të siguruar të ardhura shtesë u vazhduar edhe me menaxhimin aktiv të rezervave valutore përmes lidhjes së repo dhe repo-transaksioneve kthyesë dhe transaksionet e siguruar në ar (svop-transaksionet) me euro dhe jen japonez, si dhe përmes transaksionet me fjuçer (e të së ardhmes).

6.3 Struktura e rezervave valutore


Në vitin 2021, **në strukturën valutore** e rezervave valutore edhe më tej më të përfaqësuara ishin mjetet të investuara në instrumente financiare të dominuara në euro, me pjesëmarrje mesatare prej rreth 93%, e cila është në pajtim me nevojën për disponim me mjetet për mbështetje të strategjisë monetare si kurs valutor stabil të denarit kundrejt euros. Pjesa e mbetur nga rezervat valutore përbëheshe nga të drejtat e posaçme të tërhequra, të përfituara me shpërndarje të përgjithshme të mjeteve nga Fondi Monetarë Ndërkombëtar, jenet japoneze të transaksionet e sigurta të realizuara, si dhe e dollarit amerikan⁶³.

⁶³Struktura valutore është analizuar në raport me gjenden e rezervave valutore e zvogëluar për shumën e arit.

Në janar ishte zvogëluar pjesëmarrja e dollarit amerikanë në rezervat valutore në pritje të nënçmimit të dollarit amerikanë në vitin 2021 dhe toleranca e ulët e rrezikut valutor. Analizat në fillim të vitit drejtonin në vlerë të mundshëm të valutës amerikane për shkak të deficitit strukturor në sektorin fiskal dhe të jashtëm të SHBA-së, rividitimi i strategjisë monetare të FED, zvogëlimi i përparësisë së interesit në tregjet financiare të SHBA-së dhe pritjet për rritje të përshpejtuar të ekonomisë globale e mbështetur pikërisht nga zvogëlimi i vlerës së dollarit amerikanë.

Grafikoni 77

Struktura valutore⁶⁴ dhe eksponimi i rezervave valutore (mesatarja vjetore)



Burimi: BPRMV.

Qasja e kujdesshme dhe aktive ndaj menaxhimit të rezervave valutore, e cila përfshinte kryesisht drejtimin e investimeve të reja drejt instrumenteve më të sigurta financiare për shkak të plotësimit të parimit të sigurt të rezervave valutore, kontribuoi në rritje të moderuar e pjesëmarrjes mesatare të instrumenteve të lëshuara nga lëshuesit/vendet me **pikët më të larta të rejtingut kreditor** (prej "AAA" deri "AA -") (rreth 70%). Këto instrumente kanë ekspozim më të ulët të rrezikut të kredisë dhe konsiderohen si investimet më të sigurta, ndërsa në të njëjtën kohë hyrje të ulëta dhe negative dhe vendosja e të hyrave të lakuara edhe gjatë vitit 2021 nuk ofruan kompensim përkatës për ndërmarrjen e rrezikut të kredisë dhe interesit. Duke marrë parasysh kthimet negative të letrave me vlerë të borxhit, dhe për shkak të ruajtjes së vlerës së rezervave valutore, një pjesë e konsiderueshme e investimeve (ose mesatarisht rreth 18%) janë investuar edhe në instrumente me vlerësim rejtingut kreditor prej "A +" deri në "A-". Këto investime karakterizohen gjithashtu nga një nivel i lartë sigurie dhe likuiditeti, por sigurojnë kthim mesatarisht më të lartë të mjeteve. Shumica e këtyre instrumenteve kanë një afatizues më të shkurtër dhe janë të lëshuara nga banka afariste me reputacion (6,5% e rezervave valutore). Kjo shpërndarje u reflektua në mënyrë adekuate në strukturën gjeografike të plasmanit të rezervave valutore. Kështu, në vitin 2021, pjesa më e madhe e investimeve u drejtuan në instrumente të lëshuara nga ekonomitë udhëheqëse të eurozonës (mesatarisht 48%)⁶⁵, por kthimet jashtëzakonisht të ulëta të këtyre produkteve financiare kushtëzuan ekspozim edhe ndaj vendeve të tjera të eurozonës të Bashkimit Evropian (23,7%)⁶⁶.


⁶⁴ Struktura bazë valutore e rezervave valutore është në përputhje me strukturën valutore të ndërhyrjeve në tregun valutor të brendshëm, detyrimet e vendit jashtë vendit, tregtinë e jashtme të vendit dhe nevojat e tjera për likuiditet. Struktura taktike e valutës përcaktohet në bazë të rishikimit periodik të shpërndarjes strategjike të rezervave valutore, brenda devijimeve të lejuara nga struktura bazë valutore.

⁶⁵ Ka të bëjë a.q. "bërthama e eurozonës", në të cilën përfshihen: Gjermania, Austria, Luksemburgu, Finlanda, Holanda, Franca dhe Belgjika.

⁶⁶ "Vendet e tjera të eurozonës dhe BE" janë të përfshira: Suedia, Lituania, Polonia, Çekia dhe Sllovenia.

Grafikoni 78


Struktura vjetore mesatare e investimeve sipas rejtingut kreditor



* në kategorinë të tjera janë klasifikuar FMN, BIS
Burimi: BPRMV.

Grafikoni 79

Struktura gjeografike vjetore mesatare e investimeve




* INF dhe BZHM – Institucionet ndërkombëtare financiare dhe bankat zhvillimore multilaterale.

Nga aspekti i **llojeve të instrumenteve në të cilat janë investuar rezervat valutore**, edhe më tej pjesa më e madhe e fondeve janë vendosur në letra me vlerë (75,5%). Në mes llojeve të letrave me vlerë, mbizotëruan letrat shtetërore me vlerë dhe letrat me vlerë të lëshuara me garanci shtetërore, të cilat kanë karakterin e investimeve më të sigurta. Gjatë vitit u ripërsosën edhe plasmanet afatshkurte te bankat afariste, në bazë të sigurtë dhe të pasigurtë, por vëllimi më i ulët nga mesatarja në vitin 2020. Gjithashtu pjesë e investimeve në obligacione të korporatave të lëshuara nga institucionet financiare janë edhe në "obligacionet e blerta" e cila është në pajtim me përpjekjet e Bankës Popullore për vendosjen e investimeve të qëndrueshme dhe të përgjegjshme dhe menaxhimi me rreziqet në sektorin financiar të cilat dalin nga ndryshimet klimatike. Pjesë e rezervave valutore në vitin 2021 u mbajtën edhe në llogaritë rrjedhëse (mesatarisht rreth 12,6), edhe atë kryesisht te bankat qendrore dhe një pjesë e vogël edhe në bankat e huaja afariste, për shkak të sigurimit të likuiditetit të rezervave valutore, por edhe në pritje të kushteve më të favorshme për investim, në pajtim me projeksionet për rritje të hyrjeve gjatë tërheqjes graduale të stimullit monetar nga ana e bankave qendrore të ekonomive udhëheqëse.

Në strukturën e rezervave valutore, pjesëmarrja mesatare e **arit** u zvogëluar në mënyrë të moderuar, prej 10,4% në vitin 2020 në 9,1% në vitin 2021, e cila për shkak të ndryshimit të sasisë dhe vlerës më të lartë të shprehur në euro, në tërësi është rezultat i rritjes së rezervave valutore.

Grafikoni 80


Struktura e investimeve sipas instrumenteve, mesatarisht në vit



Burimi: BPRMV.

Grafikoni 81

Struktura sipas llojeve të letrave në vlerë, mesatarisht në vit



6.4. Rezultatet nga menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore

Për rezultate financiare pozitive në vitin 2021 kontribuan realizimit e favoursme nga menaxhimi aktiv me ar, monedhat , repo dhe pero anasjallas- transaksione si dhe transaksionet e të ardhmes, ashtu që **norma totale e kshimit nga investimi dhe menaxhimi me rezervat valutore ishte 0, 15%**. Përsa i përket investimeve, kthimi negativ i instrumenteve në kohën e investimit ka kontribuar shumë në kthimin e portofolit të rezervave valutore, i plotësuar nga rritja e kthimit në vitin 2021, e cila shkaktoi një rënie të moderuar të vlerës së tregut të letrave me vlerë me të ardhura fikse. Menaxhimi aktiv i rezervave valutore, duke marrë pozicione të ndryshme nga ato të portofolit të referencës, ndikoi pozitivisht në ecurinë dhe kontribuoi në mbivlerësimin e moderuar të rezultateve të portofolit të tregtimit në raport me portofolet përkatëse të referencës. Në pjesën më të madhe, kthimi relativisht më i lartë ka ardhur si pasojë e zgjedhjes së instrumenteve, pra instrumenteve me të hyra të dobishme më të larta në të cilat janë investuar rezervat valutore, në krahasim me instrumentet që përmbajnë portofolet e referencës.

Analizuar sipas portofoleve, portofoli operativ në euro ka një kontribut negativ në të hyrat nga investimi në rezerva valutore, duke pasur parasysh nevojën e mbajtjes së menjëhershme të fondeve të disponueshme në euro në llogaritë rrjedhëse te bankat qendrore dhe afariste, ndërsa të cilat zbatohet norma negative e interesit. Portofoli i investimeve në euro⁶⁷ i cili mbulon pjesën më të madhe të rezervave valutore dhe përfshin instrumente me afatizues më të gjata (edhe përkundër instrumenteve më të sigurta përmban edhe investime në instrumente të cilat ofrojnë premi për rrezikun kreditor), nën ndikim të lëvizjeve të çmimeve ka pasur norma pozitive të kthimit. Realizimi në të gjitha portofolet në euro ishin më të larta se portofolet përkatëse të referencës, të cilat përmbajnë vetëm instrumentet më të sigurta me kthime të konsiderueshme negative.⁶⁸


Portofoli i likuiditetit në dollarë amerikanë ka pasur një kthim pozitiv, si pasojë e kthimeve pozitive në SHBA, si dhe për shkak të përfitimeve pozitive nga menaxhimi aktiv i rezervave valutore nëpërmjet kontratave të së ardhmes me norma interesi.

⁶⁷ Të cilat janë të dedikuara për kënaqjen e të daljeve kontratura dhe potenciale gjatë një viti.

⁹³ **Niveli i parë mbrojtës** përbëhet nga njësitë organizative të cilat në mënyrë operative i zbatojnë funksionet bazë dhe funksionet mbështetëse, menaxhojnë rreziqet që rrjedhin nga funksionimi i tyre dhe kanë kuptimin më të thellë të proceseve të punës dhe ndryshimeve në mjedis në zonat për të cilat ata janë përgjegjës. **Niveli i dytë mbrojtës** zbatohet nëpërmjet identifikimit, analizës dhe menaxhimit të rrezikut, trajnimit, këshillimit dhe ngritja e ndërgjegjës të të punësuarve për rreziqet, mekanizmat e kontrollit dhe masat, si dhe mënyrën e zbatimit të rregulloreve në punën e tyre. **Niveli i tretë mbrojtës** auditimi i brendshëm, kryen veprimtari auditimi të funksionimit të nivelit të parë dhe të dytë të mbrojtjes.

⁹⁴ Banka Popullore vazhdimisht punon në përmirësimin e kapaciteteve të menaxhimit të rrezikut operativ duke mbajtur kontakte të rregullta me bankat e tjera qendrore, duke ndjekur risitë në fushën e rreziqeve operative që ndodhin përmes Shoqatës Ndërkombëtare IORWG dhe zbatimi i propozimeve të përvetësuar në bashkëpunim ndërmjet FMN-së dhe BQE-së. Grupi Ndërkombëtar i Punës për Rrezik Operativ (IORWG - International Operational Risk Working Group) është i përkushtuar për avancimin e menaxhimit të rrezikut operativ në veprimtarinë e bankave qendrore.

strategjia dhe plani i veprimit me masa për menaxhimin, raportimin dhe monitorimin e rrezikut. Gjithashtu u konstatua se Banka Popullore monitoron rregullisht ekspozimin ndaj rreziqeve operative (faktori njerëzor, proceset e menaxhimit dhe të punës, sistemet dhe faktorët e jashtëm) dhe në mënyrë aktive menaxhon dhe zbaton masat dhe aktivitetet e përcaktuara, të cilat synojnë të sigurojnë uljen e rreziqet e mundshme operative, pavarësisht kushteve të jashtëzakonshme dhe të vështira të punës për shkak të shfaqjes së valëve të reja dhe mutacioneve të koronavirusit.

11.3. Menaxhimi me rreziqe në kohë krize

Në përputhje me Politikën për mosndërprerje në punë, në Bankën Popullore është vendosur një sistem për planifikim të koordinuar, përditësimin dhe testimin e masave të nevojshme për të siguruar mosndërprerjen e proceseve të punës në situatë krize. Infrastruktura e mirë e vendosur në këtë drejtim paraqet një mjet shumë i rëndësishëm për sigurimin e funksionimit papenguar të Bankës Popullore në periudhën e pandemisë. Kështu, **me fillimin e pandemisë globale në vitin 2020, Banka Popullore miratoi protokolle pune dhe aktivizoi planet për funksionim të pandërprerë**, me çka u mundësuar mosndërprerja e proceseve dhe realizimit të tyre në cilësi të lartë, madje pa e rrezikuar sigurinë e njerëzve, sistemit dhe procesit

Digjitalizimi i përshpejtuar dhe ndryshimet teknologjike kontribuojnë në tendencën në rritje të kërcënimeve kibernetike, gjë që kërkon nevojën për monitorim të shpeshtë dhe identifikimin në kohë të rreziqeve të reja, forcimin e masave për të garantuar sigurinë e sistemit të informacionit, përfshirë rezistencën kibernetike, si dhe mosndërprerje në punë. Për këtë shkak, Banka Popullore edhe më tej vazhdon të ndërmarrë aktivitete për rritjen shtesë të sigurisë së sistemit informativ, ndërgjegjësimin dhe njohuritë për lloje të ndryshme të sulmeve kibernetike, zbulimin në kohë të mesazheve të dyshimta (fishing), monitorimin e trendit, formave dhe burimeve të sulmeve kibernetike dhe të ngjashme.⁹⁵ Gjithashtu, investimet e vazhdueshme në infrastrukturën informative dhe në proceset e teknologjisë informative i siguruan Bankës Popullore kushte për menaxhim efikas të rreziqeve të IT-së. Kriza Covid-19 theksoi gjithashtu përpjekjet e vazhdueshme të Bankës Popullore për të shikuar ndërvarësinë midis operacioneve të saj dhe operacioneve të **furnitorëve të jashtëm** (palë të treta) për menaxhimin në kohë të rreziqeve dhe kryerjen efektive të punës afariste. Për këtë shkak, janë ndërmarrë masa për përmirësimin e bashkëpunimit me furnitorët e jashtëm për shkak të kryerjes efektive të aktiviteteve të saja, si dhe për të përmbushur mandatin e saj.

Në të njëjtën kohë, për të zbutur efektet e mundshme në ekonomi të shkaktuara nga kriza shëndetësore, Banka Popullore në përputhje me kompetencat e saj solli disa vendime dhe ndërmori veprime konkrete për ruajtjen e stabilitetit monetar dhe financiar, si dhe për përmirësimin e përgjithshëm të mjedisit të punës të kompanive dhe përkrahje të ekonomisë së Maqedonisë. Për aktivitetet dhe masat e ndërmarra Banka Popullore vazhdimisht ka raportuar për çka është hapur [pjesë e veçantë](#) në ueb faqen e saj.

⁹⁵ Më hollësisht në kapitullin XII. Realizimi i Programit për punë për vitin 2021, qëllimi strategjik 10, pika 10.4 Strategjia dhe preventiva dhe qëllimi strategjik 11 -- Ruajtja e sistemi informativ stabil dhe përmirësimi i tij në përputhje me kapacitetet ekzistuese dhe standardet ndërkombëtare

11.4. Rreziqet financiare

Rreziqet financiare paraqesin rrezik nga humbjet e mundshme financiare. Rreziqet financiare ndaj të cilave është e ekspozuar Banka Popullore në pjesë më të madhe janë në sferën e investimeve në rezervat valutore të Republikës së Maqedonisë Veriore, ndërsa mund të rrjedhin edhe nga realizimi i operacioneve monetare⁹⁶.

Korniza për menaxhim me rrezik gjatë menaxhimit dhe investimit të rezervave valutore është dhënë në [Politikën për menaxhim dhe investim me rezervat valutore](#) dhe ka për qëllim të vendos kufizime dhe mekanizma kontrolluese për llojet individuale të rreziqeve, që të mundësohet realizim efektiv dhe efikas të objektivave gjatë menaxhimit dhe investimit me rezervat valutore. Në bazë të kornizës së miratuar, menaxhimi i rrezikut financiar kryhet në baza ditore nëpërmjet një sistemi të vendosur të kontrollit të brendshëm dhe proceseve dhe procedurave të automatizuara që mundësojnë vlerësimin e rrezikut në kohë reale, mirëmbajtjen e tyre brenda kornizës së dhënë dhe mbështetjen në marrjen e vendimeve për investime bazuar në informacion.

Me fillimin e pandemisë globale në vitin 2020, ndryshimi i të hyrave dhe normave të interesit në tregjet financiare ndërkombëtare është rritur. Në vitin 2021, në kushtet e hapjes graduale të ekonomive ndërkombëtare dhe normalizimit të aktivitetit ekonomik, lëvizjet e tregut u stabilizuan, ku ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit të rezervave valutore u mbajt në nivel të ulët, dukshëm më i ulët se niveli i pranueshëm i rrezikut të normës së interesit. Likuiditeti i rezervave valutore sigurohet duke investuar në instrumente likuide, përkatësisht letra me vlerë për të cilat ekziston treg sekondar. Gjatë vitit 2021, niveli i mjeteve më likuide është ruajtur në një nivel relativisht të lartë dhe ka mundësuar ecurinë normale të funksioneve të rezervave valutore. Në vitin 2021, u zbatua një qasje e kujdesshme dhe aktive në menaxhimin e rezervave valutore, e cila përfshinte fokusimin në instrumentet më të sigurta financiare, për shkak të plotësimit të parimit të sigurisë së rezervave valutore.

Gjatë vitit 2021, Banka Popullore nuk ka kryer operacione monetare për sigurimin e mjeteve likuide në denarë për sistemin bankar. Sido që të jetë, të gjitha operacionet monetare për sigurimin e likuiditetit për nevojat e sistemit bankar nga ana e Bankës Popullore kryhen si repo- transaksione, përkatësisht në baza të siguruara, ashtu që si instrument për sigurimin e rregullt të operacioneve monetare janë pranuar letrat me vlerë me cilësi të lartë. Rreziqet financiare janë përshkruar në mënyrë të detajuar në [Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare të Bankës Popullore për vitin 2021](#).

11.5. Rreziqet nga ndryshimet klimatike⁹⁷

Rreziqet e ndryshimeve klimatike, si një nga kërcënimet më të mëdha globale, po fitojnë gjithnjë e më shumë rëndësi në veprimtarinë e bankave qendrore, si institucione me përgjegjësi shoqërore. Duke pasur parasysh këto trende, Banka Popullore plotësoi Planin Strategjik për periudhën 2020 - 2022⁹⁸ me përfshirje të aktivitete për monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga ndryshimet klimatike, si dhe analizën e ndikimit të rreziqeve të

⁹⁶ Ekspozimi ndaj llojeve individuale të rreziqeve financiare që rrjedhin nga menaxhimi me rezervave valutore përshkruhet në kreun VI të këtij raporti.

⁹⁷ Informacione për aktivitet lidhur me menaxhimin me rreziqet klimatike mund të gjendet në kapitullin XII. Realizimi i Programit për punë për vitin 2021, qëllimi strategjik 2 - Ruajtja e sistemit bankar stabil dhe të sigurt, si parakusht themelor për stabilitetin financiar dhe rritje të qëndrueshme ekonomike të vendit, si dhe në [Programin për punë për vitin 2022](#).

⁹⁸ Plani strategjik i Bankës Popullore për vitin 2020-2022.


ndryshimeve klimatike në sistemin bankar, stabilitetin financiar dhe ekonominë në tërësi. Për shkak të rëndësisë së menaxhimit të rrezikut nga ndryshimet klimatike, Banka Popullore në [Planin e ri strategjik për vitin 2022-2024](#), ndahu një objektiv të veçantë strategjik për **rritjen e ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike dhe kontributin në ekonominë e "blerët" dhe të qëndrueshëm**, e cila në fund do të siguronte një standard më të lartë jetese dhe do të përmirësonte cilësinë e jetës së qytetarëve. Me ndarjen e një objektivit të veçantë strategjik, Banka Popullore, si institucion shoqëror përgjegjës, ka treguar se ka përqendrim të qarta dhe të forta në kuadër të kompetencave të saj për dhënien e kontributit në zhvillimin e menaxhimit të rrezikut në sektorin financiar që rezulton nga ndryshimet klimatike. Gjithashtu, në fillim të këtij viti, [Banka Popullore u bë anëtare e rrjetit ndërkombëtarë të sistemit financiar të blerët](#), i cili aktualisht ka 100 anëtarë dhe 16 mbikëqyrës nga radhët e bankave qendrore dhe institucionet supervizione në mbarë botën, të cilat mbështetën deklaratën ndërkombëtare në kuadër të Konferencës së OKB-së për ndryshimet klimatike. Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj çështjeje, parashikohen disa aktivitete specifike në fushën e hulumtimit mbi ndryshimet klimatike dhe ndikimin e tyre në ekonominë vendase⁹⁹, ndërsa do të krijohet një sistem për raportimin e rregullt të kredive "të blerta" dhe burimet e financimit. Gjithashtu, do të shikohen mundësitë dhe kapacitetet për kryerjen e stres- testimit për rreziqet financiare nga ndryshimet klimatike mbi bankat, ndërsa do të fillohet edhe me aktivitete për përgatitjen e udhëzimeve për bankat për menaxhimin e duhur të rreziqeve nga ndryshimet klimatike. Gjithashtu u bënë përpjekje për rritjen e investimeve në "obligacionet e blerta", të cilat mundësoi diversifikimin e portofolit të rezervave valutore, përmes investimit në instrumente financiare të lëshuara në tregjet financiare botërore, si një kontribut konkret në ruajtjen e mjedisit jetësor dhe përmirësimin e përgjegjësisë shoqërore.

⁹⁹ Në fund të vitit 2021, u përgatit **Sondazh për bankat me pyetje lidhur me ndryshimet klimatike**, në përputhje me nismat e ndërmarra nga bankat e tjera qendrore për të zbutur pasojat negative ekonomike të ndryshimeve klimatike, përfshirë edhe efektet mbi sistemin financiar, të cilat po fitojnë gjithnjë rëndësi më të madhe. Rezultatet e sondazhit do të përpunohen në muajt e parë të vitit 2022 dhe do të jenë bazë për të shikuar praktikën dhe politikat e bankave për menaxhimin e rrezikut nga ndryshimet klimatike, si dhe ndërgjegjësimin e tyre për sfidat (rreziqet) që rezultojnë nga ndryshimet klimatike, ndërsa gjithashtu do të shërbejnë për përgatitjen e udhëzimeve/pritjeve të Bankës Popullore në pikëpamje të menaxhimit të rreziqeve nga ndryshimet klimatike nga ana e bankave.


XII. Realizimi i Programit për punën për vitin 2021

Hyrje

Pandemia e Covid-19 vazhdoi gjatë vitit 2021, ashtu që edhe për vitin 2021 ishte një kontekst karakteristik i pasigurisë dhe paparashikueshmërisë së zgjatur. Në rrethana të tilla, Banka Popullore i realizoi edhe qëllimet strategjike¹⁰⁰ dhe ndërmori disa aktivitete specifike të cilat mundësonin vazhdimësinë në funksionimin e saj dhe realizimin e përditshëm të qëllimeve dhe funksioneve të dhëna ligjore.



[Programi i punës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021](#) përmban 159 aktivitete programore për realizimin e 11-të qëllimeve strategjike të përcaktuara me [Planin Strategjik të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2020-2022](#). Programi zbatohet duke drejtuar në mënyrë optimale resurset në dispozicion në fushat prioritare, përforsimi i kapacitetit në të gjitha segmentet e punës, përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së punës, madje duke mundësuar njëkohësisht monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve dhe efektivitetit të masave dhe aktiviteteve të ndërmarra.



Aktivitetet programore përfshijnë zbatimin e proceseve të rregullta të punës dhe aktiviteteve të lidhura me projektet që mundësojnë futjen e ndryshimeve në punë, nga aspekti i rritjes së efikasitetit, cilësisë, transparencës dhe besueshmërisë, përputhshmërisë me kërkesat e reja ligjore, rregulloret evropiane, standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e Fondi Monetar Ndërkombëtar.

¹⁰⁰ Objektivat e Bankës Popullore janë të përcaktuara në Ligjin për Bankën Popullore.

Emërtimet

“Banka Qendrore që me vendime fleksibile, të menduara në mënyrë përkatëse dhe në kohë, në një kohë ndryshimeve të shpejta dhe transformimi digjital, kontribuon në një standard më të lartë jetese të qytetarëve duke krijuar një mjedis zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës”. *Vizioni* i Bankës Popullore është që të njihet si *“institucion i pavarur, përgjegjës, profesional, inovativ dhe transparent, i cili ka besim dhe kredibilitet të lartë tek publiku”*.



Denari ishte dhe do të jetë një nga shtyllat kyçe të stabilitetit të ekonomisë së Maqedonisë



Niveli i lartë i rezervave valutore i mundësoi Bankës Popullore të veprojë me shpejtësi në përgjigje të pandemisë



Nota më të larta për politikën monetare dhe Bankën Popullore në Raportin e Progresit të KE-së për vitin 2021



Rregullativa bankare dhe supervizioni i bankave është në përputhje me standardet e larta të BE-së



Cilësi e lartë e funksionit statistikor të Bankës Popullore



Infrastruktura e pagesave po zhvillohet dhe po modernizohet: fintek -sektori po zgjerohet me shpejtësi në industrinë e pagesave

Me Planin e ri strategjik përkundër qëllimeve tradicionale të ndërlidhura me mandat të bankës qendrore, theksi do t'i vihet sfidave dhe trendeve të reja të cilave do t'ju kushtohet vëmendje në tre vitet e ardhshme.



Rritja e ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike dhe kontributi për një ekonomi të gjelbër dhe të qëndrueshme



Banka Popullore u bë anëtare e rrjetit ndërkombëtar për sistemin financiar të gjelbër



U miratua strategjia e parë kombëtare për edukimin financiar dhe gjithëpërfshirjen



Theks i veçantë në mbrojtjen e konsumatorit dhe edukimin financiar



Strategjia për fintek-sektorin: përsheptimi i digjitalizimit dhe aplikimi i teknologjive më të reja në financa




Forcimi i menaxhimit të rrezikut me theks në qëndrueshmërinë kibernetike dhe qëndrueshmërinë operative

Qëllimi strategjik 1 - Ruajtja e stabilitetit të çmimeve përmes kursit stabil të denarit kundrejt euros



Gjatë vitit 2021, aktivitetet në lidhje me ruajtjen e stabilitetit makroekonomik u kryen në kushte specifike që kërkonin një projektim të kujdesshëm dhe të detajuar për marrjen e vendimeve në kohë dhe ekzekutimin e vendimeve të duhura. Në kuadër të zbatimit operativ të **politikës monetare**, Banka Popullore ka kryer rregullisht operacionet monetare për arritjen e sukseshëm të mëtutjeshme të qëllimit themelor. Në periudhën e analizuar kanë përfunduar aktivitetet lidhur me vendosjen e rregullave nënligjore dhe aspektet operative të përdorimit të repo-linjeve të Bankës Qendrore Evropiane (BQE) për sigurimin e likuiditetit në euro për Bankën Popullore për sistemin bankar vendas. [Në mars 2022, BQE solli vendim likuiditeti shtesë valutor prej 400 milionë euro të vihej në dispozicion të Bankës Popullore përmes repo-linjes deri më 15 janar 2023.](#)

Repo-linja është vetëm një shtresë tjetër mbrojtëse, duke pasur parasysh nivelin e lartë të rezervave valutore dhe likuiditetin e lartë të bankave, të cilat garantojnë stabilitetin e denarit dhe stabilitetin makrofinanciar.



Si përgjigje të efekteve të pafavorshme të krizës shëndetësore, **Banka Popullore edhe në vitin 2021 aplikoi një masë jo standarde për rezervën e detyrueshme të bankave, me të cilën stimulohet mbështetja kreditore për veprimtaritë aktuale më të prekura.** Rregulloret nënligjore të kësaj mase në baza të rregullta janë harmonizuar me paketat fiskale të masave të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në procesin e zbatimit operativ të politikës monetare, Banka Popullore rregullisht i monitoroi zhvillimet në tregun valutor, ndërsa aktivitetet për ruajtjen e mëtutjeshme të stabilitetit të kursit të denarit përfshinin: analizën dhe monitorimin aktiv të trendeve të ofertës dhe kërkesës për valutat në tregun valutor të brendshëm; komunikimet me bankat për të kuptuar më mirë lëvizjet me klientët e tyre; dhe ndërhyrjet me bankat mbështetëse për plotësimin e kërkesës ose akumulimin e tepriçës së valutës.

Shumica e aktiviteteve programore në fushën e përcaktimit të politikës monetare lidhur me përgatitjen e projeksioneve makroekonomike, sondazhet dhe analizat e rregullta hulumtuese të cilat përdoren gjatë miratimit të vendimeve të politikës monetare u zhvilluan me ritëm të rregullt dhe kontribuan në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve përmes kursit stabil të denarit kundrejt euros, si synim kryesor strategjik i Bankës Popullore.

Aktivitetet programore për zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës analitike të projeksioneve makroekonomike janë realizuar rregullisht. Në fakt, krahas kontrolleve të zakonshme të modeleve për dizajn afatshkurtër, gjatë vitit janë përmirësuar modelet ekzistuese, ndërsa janë ndërtuar modele të reja me përdorimin e qasjeve të reja dhe variablave të reja. Gjatë vitit janë bërë kontrolle të zakonshme të modelit MAKPAM, ashtu që projeksionet në prill dhe tetor 2021 janë bërë tërësisht me infrastrukturën e re softuerike (në kodet e modelit Matlab dhe Iris). Përveç kësaj, u

vazhduan aktivitetet¹⁰¹ për përmirësimin e performancës dhe strukturës së modelit. Janë bërë edhe “projeksione në hije”, për shkak të kalimit të plotë të modelit të ri nga viti 2022. Përmirësimet dhe pasurimet e bëra në modelin MAKPAM rritet mundësia për analiza më gjithëpërfshirëse, konsistencë më të madhe, fuqi më të mirë të shpjegimit dhe projektimit, ndërsa me këtë edhe rekomandime më të mira të politikave.

Gjatë vitit 2021, është bërë azhurimi i treguesve bazë në të cilat bazohet strategjia ekzistuese monetare, përmes rivlerësimit të transmissioinit monetar të normave të interesit dhe vlerësimit të përputhshmërisë së kursit valutor real efektiv me fundamentet e saja me zbatimin e dy qasjeve (BEER dhe FEER)¹⁰². Gjatë vitit janë shqyrtuar treguesit për cenueshmërinë e ekonomisë së Maqedonisë dhe për vendet e caktuara të rajonit, ndërsa u realizua edhe auditimi i rregullt i qëndrueshmërisë së borxhit të jashtëm, si dhe qëndrueshmërisë së borxhit publik. Në bazë të rregullt u realizuan Anketat e aktivitetit kreditor, si dhe Anketa e inflacionit të pritur dhe për pritjet zhvillimeve të PBB reale për shkak të marrjes së elementeve kyçe hyrëse gjatë parashikimit të flukseve të ardhshme makroekonomike. Për nevojat e projekcionit të bilancit të pagesave, janë kryer anketa mbi planet e biznesit të eksportuesve dhe importuesve më të mëdhenj.

Për të kuptuar më mirë zhvillimet e fundit ekonomike në ekonominë vendase, si dhe vlerësimi i ndikimeve të tyre në politikën monetare, gjatë vitit janë përgatitur raportet e rregullta mujore dhe tremujore, si dhe gjithashtu edhe [Raporti vjetor për punën e Bankës Popullore](#). Në kuadër të përpjekjeve **për rritjen e transparencës së politikës monetare**, u përgatitën rregullisht dhe **publikuan lajmërimi dhe prezantime për publikun** në të cilat në mënyrë të sintetizuar janë dhanë pasqyra të detajuara të situatës aktuale dhe pritshmërive për periudhën e ardhshme në lidhje me situatën ekonomike dhe politikën monetare. Njëkohësisht, në kuadër të raporteve të rregullta tremujore u publikuan disa analiza makroekonomike, në formën e shtojcave analitike¹⁰³, ndërsa disa prej tyre lidheshin me efektet e pandemisë mbi tregun këmbimor dhe kreditor dhe mbi ekonominë në tërësi.

Qëllimi strategjik 2 - Ruajtja e sistemit bankar stabil dhe të sigurt, si parakusht themelor për stabilitetin financiar dhe rritje të qëndrueshme ekonomike të vendit



Në vitin e kaluar 2021, Banka Popullore ka punuar me përkushtim në **promovimin e të gjitha elementeve në fushën e bankave dhe supervizionin**, ndërsa në përputhje me dispozitat e normave ligjore të brendshme dhe dispozitat e direktivave të Bashkimit Evropian. Me qëllim të forcimit të sistemit bankar, Banka Popullore ndërmori aktivitete të shumta për ndryshimin e akteve nënligjore për të zbutur pasojat e shkaktuara nga kriza e koronës dhe për t'iu përshtatur në mënyrë aktive situatës së re.

Shtojca 3. Përmirësimi i vazhdueshëm i rregullativës bankare dhe supervizionit ër shkak të harmonizimit me dispozitat e Bashkimit Evropian

Komisioni Evropian gjatë vitit 2021 ka miratuar një vendim me të cilën vlerësoi se rregullativa bankare dhe supervizioni të cilën e zbaton Banka Popullore është në përputhje me standardet e larta të Bashkimit Evropian. Me Vendimi konfirmon se rregullativa bankare, si dhe mënyra e kryerjes së supervizionit të bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut është e barabartë me atë që zbatohet

¹⁰¹ Veprimtaritë lidhur me riponderimin, rikalibrimin e variablave/ekuacioneve ekzistuese dhe pasurimin (ekuacioni i shtuar për kreditë) të cilat kanë përfunduar deri në fund të vitit.

¹⁰² BEER-Behavioral Equilibrium Exchange Rate: FEER-Fundamental Equilibrium Exchange Rate.

¹⁰³ https://www.nbmr.mk/analitichki_prilozi_vo_kvartalnitie_izvieshtai.nsp

në BE. Me këtë vendi ynë përfshihet në listën e 26 vendeve të botës, me të cilave SHBA-ja, Kanadaja, Japonia dhe Zelanda e Re, të cilat përmbushin këto standarde të larta.

Vlerësimi u bë nga ana e Organit Bankar Evropian, ku për një periudhë më shumë se një vjeçare u studiuuan rregullativat e brendshme bankare dhe supervizioni nga ana e ekspertëve evropianë. Vlerësimi pozitiv i marrë tregon se rregullativa dhe supervizioni bankar vendas kanë arritur të njëjtat synime me ato të vendosura në Union në lidhje me ruajtjen e stabilitetit dhe integritetit të sistemit financiar, efikasitetit dhe përshtatshmërisë së mbrojtjes së përdoruesve të shërbimeve financiare, bashkëpunimit ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm në tregun financiar, pavarësia dhe efikasiteti i supervizionit dhe zbatimi efektiv i standardeve ndërkombëtare. Më pas, vlerësimi i Organit Bankar Evropian, u miratua nga ana e Komisionit Evropian.

Vlerësimi pozitiv i harmonizimit të rregullativës bankare dhe supervizionit me atë të BE-së është konfirmim i përpjekjeve dhe aktiviteteve të vazhdueshme të Bankës Popullore për respektimin e normave të BE-së. Marrja e një trajtimi ekuivalent është i rëndësishëm për sa i përket perceptimeve të investitorëve potencialë dhe lidhjes më të lehtë dhe më efikase të sistemit bankar vendas me tregjet financiare ndërkombëtare. Vlerësimi pozitiv lehtëson qasjen e institucioneve vendore në tregun financiar ndërkombëtar, sjell përparësi në udhëheqjen e politikës monetare të Bankës Popullore dhe lehtëson bashkëpunimin me organet supervizione të BE-së.

Vendimi i datës 1.10.2021 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe gjendet në linkun e mëposhtëm. Për përafrimin e mëtejshëm të praktikave supervizione me udhëzimet e EBA-së dhe praktikat e BQE-së, gjatë gjysmës së parë të vitit 2021 ka përfunduar procesi i vlerësimit të procesit të përcaktimit të likuiditetit të brendshëm nga bankat (PIL), aktivitet ky që u zhvillua në kuadër të Twinning projektit të mbështetur nga Bashkimi Evropian. Aktivitetet rezultuan në zhvillimin e një instrumenti supervizion për vlerësimin e këtij procesi, përkatësisht Banka Popullore zhvilloi një metodologji të brendshme, e cila përmban parime, udhëzime për sigurimin e zbatimit të qëndrueshëm të qasjes në vlerësimin supervizionin e këtij procesi, si dhe përmirësimi i kornizës dhe menaxhimi i këtij procesi në banka. Janë mbajtur takime pune me përfaqësues të bankave ku janë shkëmbyer parashikimet fillestare për raportet e para të PIL-it, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të procesit të PIL-së, ndërsa në të njëjton kohë edhe procesit të menaxhimit të rrezikut të bankave.

Gjatë vitit, janë kompletuar disa aktivitete për **projekt zgjidhje ligjore**: Projekt-ligji për Bankën Popullore, Projekti-ligji për shlyerjet bankare, Projekt-ligji për shërbimet pagesore dhe sistemet e pagesave dhe pritet të miratohet së shpejti. Në këto procese u përfshinë një sërë grupesh punuese, me përfaqësues të Bankës Popullore dhe të institucioneve të tjera, të cilat hartuan akte të shumta nënligjore. Lidhur me **Projekt-ligji për Shlyerjen Bankare**, ai është kompletuar në kuadër të asistencës teknike të organizuar nga FinSAK (Banka Botërore), e cila do të mundësojë vendosjen e kornizës ligjore për zbatimin e këtij funksioni të ri nga Banka Popullore, si dhe do të përcaktohen veprimet përgatitore për shlyrjen bankare, kushtet për fillimin e procedurës së shlyerjes bankare dhe instrumentet dhe mekanizmat për zbatimin e saj.

Veçanërisht e rëndësishme ishte edhe **misioni teknik me FMN-në në fushën e stres-testimit**, i cili paraqet bazë për përmirësimin e mëtejshëm të kornizës ekzistues të stres-testimit në nivel të sistemit bankar, por edhe për rritjen e kapaciteteve të bankave për vetë stres-testime dhe zbatimi i rezultateve për bankat individuale si nga bankat, ashtu edhe nga ana e Bankës Popullore. Për shkak të përforsimit të mëtejshëm të gatishmërisë dhe qëndrueshmërisë së bankave për reforma të mundshme, u bë një analizë e reformave që lidhen me normat referencë të interesit në nivel global, me qëllim njohjen e bankave me udhëzimet e përgjithshme në lidhje me aktivitetet që duhet (ose priten) të ndërmerren në lidhje me këto reforma.

Në vitin 2021, , **dy nënkomitetet takoheshin rregullisht në kuadër të Komitetit të Stabilitetit Financiar.** Puna e këtyre nënkomiteteve jep një kontribut të rëndësishëm në monitorimin e rreziqeve në të gjitha segmentet e sistemit financiar, i cili është një nga mjetet në procesin e përgjithshëm të monitorimit dhe ruajtjes së stabilitetit financiar. Me ndryshimin e Planit Strategjik të Bankës Popullore, në vitin 2021, për herë të parë, , **aktivitetet lidhur me ndryshimet klimatike u vendosën si prioritet strategjik, me qëllim të jepet kontribut në krijimin e një ekonomie “të blerët” dhe të qëndrueshme.** Aktivitetet fillestare të Bankës Popullore kanë për qëllim **ngirtjen e ndërgjegjësimin për rreziqet e ndryshimeve klimatike dhe kuptimin e rëndësisë së ndryshimeve klimatike në kontekstin e punës bankare dhe stabilitetit financiar, si dhe për ekonominë në tërësi.** Kështu, në fund të vitit 2021, u përgatit një Anketë **për Bankat me pyetje lidhur me ndryshimet klimatike** ¹⁰⁴, në përputhje me nismat e ndërmarra nga bankat e tjera qendrore për të zbutur pasojat e padëshirueshme ekonomike e ndryshimeve klimatike, duke përfshirë efektet mbi sistemin financiar, të cilët po fitojnë rëndësi gjithë një më të madhe.

Për sa i përket **aktiviteteve supervizione jashtë vendit**, gjatë vitit 2021 është kryer rregullisht vlerësimi i profileve të përgjithshme të rrezikut të bankave, i cili përfshinte vlerësimin e procesit të përcaktimit të likuiditetit të brendshëm nga bankat, procesin e përcaktimit të kapitalit të brendshëm, vlerësimin e planeve për rimëkëmbjen e bankave me rëndësi sistematike, përgatitjen dhe monitorimin e masave korrigjuese bazuar në mospërputhjet dhe parregullsitë e konstatuara në funksionimin e bankave dhe kursimoreve, mbajtjen e takimeve të rregullta vjetore me shoqëritë e auditimit të jashtëm dhe anëtarët e bordit drejtues dhe mbikëqyrës të bankave. Janë realizuar rregullisht aktivitetet për licencimin e anëtarëve të organeve të bankave dhe kursimoreve, si dhe dhënien e licencave për kryerjen e punëve të këmbimit dhe transferimit të shpejtë të parave. Gjatë këtij viti, Banka Popullore ka vazhduar me forcimin e kapaciteteve institucionale për vlerësimin e procesit të përcaktimit të likuiditetit të brendshëm nga bankat. Për shkak të digjitalizimit të proceseve të punës, si dhe për të shfrytëzuar njëkohësisht përparësitë e shumta që ofron teknologjia, në periudhën e kaluar është punuar në mënyrë aktive në projektin për futjen e raportit elektronik të personave fizik në Regjistrin Kreditor, me të cilën do të rritet efikasiteti i këtij procesit përmes ndërrimit të faktorit njerëzor dhe lehtësimin e qasjes së qytetarëve deri te këto raporte. Vëmendje e veçantë iu kushtua përgatitjes së rregullativave nënligjore për licencimin e institucioneve pagesore dhe pjesëmarrjes në përgatitjen e rregullativave nënligjore për supervizion dhe mbikëqyrje të institucioneve pagesore.

¹⁰⁴ Rezultatet e anketës do të përpunohen në muajt e parë të vitit 2022 dhe do të jenë bazë për të shikuar praktikën dhe politikat e bankave për menaxhimin e rrezikut nga ndryshimet klimatike dhe ndërgjegjësimin e tyre për sfidat (rreziqet) që rrjedhin nga ndryshimet klimatike, ndërsa gjithashtu do të shërbejnë për përgatitjen e udhëzimeve/pritjeve të Bankës Popullore lidhur me menaxhimin e rreziqeve nga ndryshimet klimatike nga ana e bankave.

Tabela 4

Kërkesat e shqyrtuara për lëshimin e pëlqimit paraprak në vitin 2021

Llojet e lejeve/pajtueshmërive (bankat)	lëshuara	refuzuara	ndërprera
Pajtueshmëri për përvetësimin e aksioneve në bankë	1	/	/
Pajtueshmëri për fillimin e kryerjes së aktivitetit financiar	1	/	1
Pajtueshmëri për ndryshim të statutit	1	/	/
Pajtueshmëri për ndryshim të emrit dhe selisë	1	/	/
Pajtueshmëri për ndryshim dhe plotësim të statutit	10	/	2
Pajtueshmëri për emërimin e anëtarit në bordin mbikëqyrës	23	/	5
Pajtueshmëri për emërimin e anëtarit në bordin drejtues	21	/	1
Pajtueshmëri për përfshirjen e fitimit në kapitalin bazë të rregullt	3	/	/
Llojet e lejeve/pajtueshmërive (kursimoreve)	lëshuara	refuzuara	ndërprera
Pajtueshmëri për emërimin e drejtorit	/	/	/
Gjithsej:	61	0	9

Drejtorja për supervizion në terren gjatë vitit 2021 ka vazhduar të kryejë **kontrolle të rregullta në terren**, në kushte të vështira pune për shkak të pandemisë Covid-19. Megjithatë, pavarësisht kufizimeve aktuale dhe mjedisit të jashtëzakonshëm, gjatë vitit 2021 janë kryer 11 inspektime të rregullta, nga të cilat 9 në bankat afariste dhe 2 në kursimore, kontroll tematik në nivel të sistemit bankar lidhur me vlerësimin rrezikut të hapësirës digjitale dhe 104 kontrolle të drejtpërdrejta te këmbimoret e autorizuara, me çka është realizuar Plani për vitin 2021. Gjithashtu, u realizua edhe procesi i përmirësimit të kornizës ekzistues metodologjik për vlerësimin e rrezikut përmes përmirësimit të procedurave interne për vlerësimin e rreziqeve individuale në bankat afariste, u realizua edhe harmonizimi i tyre me ndryshimet më të reja ligjore dhe rregullativat ligjore, si dhe me rregullat e Bankës Qendrore Evropiane.

Lidhur me aktivitetet për **forcimin e kornizës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit**, është kryer një anketë te këmbimoret e autorizuar dhe ofruesit e shërbimit të transfertave të shpejta të parave në lidhje me mënyrën e zbatimit të procesit SPPFT. Në bazë të anketës së kryer, është përgatitur projekt-verzion të Qarkores për praktikën më të mira për ofruesit e shërbimeve të transfertave të shpejta të parave dhe këmbimoreve të autorizuara për shkak të harmonizimit të punës me rregulloret e SPPFT-së, e cila duhet të miratohet nga Këshilli i Bankës Popullore në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2022.

Tabela 5
Kontrollet e kryera në terren gjatë vitit 2021

1.1.2021-31.12.2021				
Lloji i lëndës	Numri total i lëndëve	Numri total i kontrolleve në terren	Numri i kontrolleve tematike në sferën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit	Numri i kontrolleve në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të kombinuara me kontrollet e rrezeqeve të tjera
SEKTORI FINANCIAR				
Bankat dhe kursimoret	13 banka dhe 2 kursimore	9 banka dhe 2 kursimore	/	8 banka
Ofruesit e shërbimit të transferimit të shpejtë të parave dhe këmbimoret e autorizuara	8 ofrues të shërbimit të transferimit të shpejtë të parave, 242 nënagjentë dhe 244 këmbimore të autorizuara	2 ofrues të shërbimit të transferimit të shpejtë të parave dhe 104 këmbimore të autorizuara	/	2 ofrues të shërbimit të transferimit të shpejtë të parave dhe 104 këmbimore të autorizuara

Duke ndjekur trendin e bankave të tjera qendrore në BE dhe rajon në fushën e menaxhimit të rrezikut të TI-së dhe hapësirës digjitale, në dhjetor 2021, Banka Popullore themeloi **Zyrën e supervizionit të sistemeve informative** si njësi e re organizative në kuadër të Sektorit për supervizion. Departamenti i ri organizativ do të bëjë monitorimin dhe harmonizimin me rregulloret e BE-së në fushën e menaxhimit të rrezikut të TI-së dhe kërcënimeve të hapësirës digjitale në subjektet e licencuara nga Banka Popullore, duke hartuar rregulloret përkatëse në këtë fushë, si dhe zbatimin e praktikave më të mira në pjesën e bankave dhe institucionet për shërbime pagesore. Njëkohësisht do të vazhdojë me supervizionin e kujdesshme të sistemeve të informacionit të bankave duke kryer mbikëqyrje të rregullta në terren dhe jashtë terrenit.

Gjatë vitit 2021 vazhduan aktivitetet për përgatitjen e **Strategjisë së parë Kombëtare për fintek-sektorin**, e cila përmban rekomandimet për mbështetjen e fintek-sektorit, ndërsa zbatimin është në kompetencë të rregullatorëve financiarë¹⁰⁵. Paralelisht është përgatitur **Memorandum për bashkëpunim në krijimin e kushteve për mbështetjen e zhvillimit të inovacioneve në sistemin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut**. Sipas memorandumit, po krijohet një kornizë për bashkëpunim në fushën e fintek-sektorit ndërmjet rregullatorëve financiarë në vend. Më konkretisht, është vendosur një sistem nëpërmjet të cilit rregullatorët do të veprojnë në mënyrë të koordinuar, secili në kompetencën e tij, në lidhje me zbatimin e Strategjisë kombëtare për fintek-sektorin, versioni i parë i së cilës është përgatitur tashmë nga Banka Popullore.

Në pajtim me aktivitetet e parashikuara për përfshirje financiare dhe mbrojtje të konsumatorëve në shërbimet financiare në **Strategjinë për edukim financiar dhe përfshirje financiare 2021 – 2025**, grupi punues për mbrojtjen e konsumatorëve në Bankën Popullore gjatë vitit 2021 ndërmori disa aktivitete. Nga fillimi i gushtit, të gjitha bankat dhe kursimoret kanë filluar me zbatimin e Udhëzuesve për përmbajtjen, formën dhe mënyrën e publikimit të të dhënave për kreditet më të prezantuara

¹⁰⁵ Pritet që dokumenti të miratohet shumë shpejtë.

dhe produktet e depozitave për personat fizik, të miratuara nga Banka Popullore dhe Asociacioni i Bankave të Maqedonisë në korrik 2021. Synimi është të arrihet transparencë dhe krahasueshmëri më e madhe e të dhënave për depozitat dhe kreditë për popullatën, në të gjitha bankat dhe kursimoret, përfshirë edhe normat e interesit, për informim më të mirë të qytetarëve dhe vendimmarrje bazuar në informacione më të detajuara¹⁰⁶. Gjithashtu, është bërë analiza e përvojave të vendeve me Avokat financiar të Popullit, si dhe janë ndërmarrë aktivitetet fillestare për përgatitjen e Projektligji për Avokatin Financiar të Popullit, i cili në aktivitetet e mëtutjeshme do të shqyrtohet së bashku me rregullatorët e tjerë financiarë. Me qëllim të përforcimit të aktiviteteve në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, në dhjetor 2021 u krijua një njësi e veçantë organizative për mbrojtjen e konsumatorëve dhe edukimin financiar.

Qëllimi strategjik 3 - Ruajtja dhe menaxhimi i rezervave valutore në përputhje me parimet e sigurisë dhe likuiditetit dhe sigurimi i kthimit optimal¹⁰⁷



Ndryshimi i lëvizjeve në tregjet financiare ndërkombëtare dhe seria e pasigurive të lidhura me zhvillimet rreth krizës globale shëndetësore, e plotësuar nga presionet në rritje inflacioniste, të cilat u intensifikuan në fund të vitit për shkak të krizës energjetike, imponuan nevojën për menaxhim aktiv të portofolit të rezervave valutore, në përputhje me kushtet e ndryshuara të tregut, por edhe monitorim të mëtejshëm aktiv dhe reagim me kohë të Bankës Popullore për zbutjen e efekteve të rreziqeve që rrjedhin nga rrethanat e ndryshuara. Në këtë kuptim, pozicioni i investimit dhe ekspozimi ndaj rreziqeve të tregut rishikohet në kontekst të kushteve të tregut, mbi bazën e të cilave propozohen ndryshime investimi, të cilat përfshinin uljen e ekspozimit ndaj rrezikut valutor, ruajtjen e një niveli të lartë të portofolit operativ, u bënë përpjekje për rritjen e investimeve në "obligacionet e blerta" dhe u shqyrtua mundësia për ndryshime në politikën e investimeve në përputhje me rrethanat e ndryshuara të tregut dhe tendencat e investimit të rezervave valutore në nivel global

Qëllimi strategjik 4 - Rritja e efikasitetit të sistemit të furnizimit dhe përpunimit të kartëmonedhave dhe monedhave dhe rritja e cilësisë dhe funksionalitetit të parave të gatshme në qarkullim¹⁰⁸



Gjatë vitit 2021, Banka Popullore në baza të rregullta **furnizon bankat dhe qendrat e parave të gatshme me kartëmonedha dhe monedha**. Për shkak të kushteve specifike të punës të shkaktuara nga kriza shëndetësore, është marrë parasysh efikasiteti i sistemit të krijuar të furnizimit me para të gatshme, si dhe ndërmarrja në kohë të masave përkatëse. Në kuadër të aktiviteteve të rregullta, Banka Popullore ka ndjekur kërkesat për parave të huaja efektive për nevojat e Bankës Popullore, institucioneve shtetërore dhe organeve drejtuese dhe ka intervenuar me kohë për plotësimin adekuat të nevojave

Në pajtim me masat për ballafaqim me pandeminë, **kontrolli i zbatimit të standardeve dhe kriterëve për punë me para të gatshme** në banka dhe qendra për para të gatshme është i kufizuar në kontrole indirekte, derisa të krijohen kushte të plota sigurie për kryerjen e këtyre aktiviteteve përmes kontroleve të drejtpërdrejta në terren. Në pajtim me ndryshimin dhe plotësimin e bërë në Ligjin për Bankën Popullore në vitin 2021,

¹⁰⁶ Të dhënat në këtë formë të unifikuar janë të disponueshme në faqet e internetit të bankave dhe kursimoreve, si dhe në mënyrë qendrore në pjesën e re të faqes së internetit të Bankës Popullore, e destinuar për informimin e konsumatorëve

¹⁰⁷ Më detalisht në kapitullin VI. Menaxhimi dhe investimi në rezervat valutore.

¹⁰⁸ Më detalisht në kapitullin VIII. Lëshimi dhe menaxhimi i kartëmonedhave dhe monedhave të Republikës së Maqedonisë së Veriut – operacionet e thesarit.

është siguruar baza ligjore për kryerjen e mbikëqyrjes mbi kushtet dhe mënyrën e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha. Procedurat e rregullta për testimin e makinerive të përpunimit të parave kryhen sipas dinamikës së përcaktuar, dhe lista e përditësuar e makinerive të testuara me sukses publikohet rregullisht në faqen e internetit të Bankës Popullore.

Ka përfunduar plotësisht projekti për përmirësimin e aplikacionit për ekspertizë të falsifikimit në pjesën e modulit për zëvendësimin e parave të dëmtuara. Për shkak të masave për mbrojtje nga pandemia, aktivitetet për zbatimin e platformës së standardizuar për trajnimin e kuadrove të bankave dhe qendrave për para të gatshme për kontrollin e vërtetësisë dhe përshtatshmërisë së parave në qarkullim, si dhe për realizimin planit kombëtarë për trajnim, në pajtim me rekomandimet nga Twinning projektit i realizuar "Përforsimi i kapaciteteve të sistemit për luftën kundër falsifikimit të euros". Këto aktivitete do të vazhdojnë kur të krijohen kushtet për mbajtjen e trajnimeve të tilla me praninë e më shumë pjesëmarrësve.

Qëllimi strategjik 5 - Funksionimi i sigurt dhe efikas i sistemeve të pagesave dhe zhvillimi i tregut të shërbimeve të pagesave¹⁰⁹



Në vitin e kaluar 2021, Banka Popullore u angazhua veçanërisht për rolin e saj zhvillimor dhe katalitik **në fushën e sistemeve të pagesave**. Madje, Banka Popullore në bashkëpunim me Ministrinë e Financave është përfshirë në mënyrë aktive në plotësimin e Projektligjit për shërbimet e pagesave dhe sistemet e pagesave, duke vazhduar procesin e konsultimit me sektorin bankar dhe palët tjera të interesuara dhe institucionet shtetërore. Projektligji është harmonizuar me Sekretariatit për Legjislacion dhe është miratuar nga Qeveria në fund të vitit. Në kushtet e krizës së zgjatur shëndetësore, Banka Popullore organizoi në mënyrë të sigurt dhe pandërprerje punën e saj në operacione kritike të ndërlidhura me: funksionimin e sistemeve të pagesave në vend, zbatimin e operacioneve monetare dhe operacionet për menaxhimin e rezervave valutore dhe kryerjen e qarkullimit të pagesave me vendet e jashtme për organet shtetërore, me çka në mënyrë të suksesshme e ka kryer rolin operativ në këtë fushë në kushte të pandemisë. Në këtë mënyrë, me këtë qasje dhe masat mbrojtëse të ndërmarra për qëndrueshmëri në hapësirën digjitale, Banka Popullore zbatoi praktikën më të mira të bankave qendrore moderne. Nga aspekti i rolit mbikëqyrës **në sistemet e pagesave**, Banka Popullore ka kryer mbikëqyrje direkte dhe indirekte nga e cila shihet se operatorët e sistemit të pagesave në kushtet e pandemisë vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre papenguar e cila i detyrohet procedurave të përcaktuara dhe të testuara më parë për ofrimin e pandërprerë në funksionim në përputhje me standardet për funksionimin e tyre të përcaktuara nga Banka Popullore.

Gjithashtu, për përforsimin e kapaciteteve, Banka Popullore ka përfunduar Twinning projektit e BE-së në kuadër të të cilit janë realizuar një numër i madh e-trajnimeve në bashkëpunim me bankat qendrore të vendeve anëtare të BE-së, të cilat janë mbështetje në hartimin e rregullativave nënligjore për zbatimin e Ligjit me të cilin pritet hyrje të ofruesve të ri të shërbimeve pagesore, a paragjithash nga fintek-sektori, si dhe inkurajim të transformimit digjital të ofruesve ekzistues të shërbimeve pagesore.

¹⁰⁹ Më delalisht në kapitullin VII. Shërbimet pagesore dhe sistemet e pagesave.

Qëllimi strategjik 6 - Mbështetja e zhvillimit të tregjeve financiare të vendit



Lidhur me **tregjet e brendshme financiare**, vazhduan aktivitetet e rregullta, duke përfshirë: monitorimin e rregullt të tregtimit të depozitave ndërbankare, tregtimin e këmbimit valutor si dhe tregun sekondar të letrave me vlerë, publikimin e rregullt të të dhënave për lëvizjet e tregjeve financiare. Banka Popullore vazhdoi me analizat e rregullta mujore të lëvizjeve në tregun valutor, veçanërisht në segmentin ndërmjet bankave dhe këmbimoreve si dhe personave fizik ndërsa me dinamikë të rregullt monitorohet pozita valutore e bankave. Anketa e tregut valutor, e cila filloi t'u dorëzohej bankave që mbështesin tregun valutor në fillim të krizës shëndetësore, vazhdoi të realizohet në baza mujore për të marrë njohuri mbi pritshmëritë e bankave për trendin e tregut valutor për periudhën e ardhshme. Në tremujorin e katërt të vitit 2021, në kushtet e rritjes së vëllimit të tregtimit në tregun valutor dhe sigurimit të një pjese të likuiditetit valutor të nevojshëm nëpërmjet ndërhyrjeve të Bankës Popullore për shitjen e valutës bankave mbështetëse, është përgatitur analizë më e detajuar e lëvizjeve të të gjitha segmenteve të tregut valutor dhe u mbajt takim pune me pjesëmarrësit më të rëndësishëm në tregun valutor, në të cilin u shqyrtuan perceptimet e pjesëmarrësve të tregut për lëvizjet aktuale dhe pritshmëritë për periudhën e ardhshme. Lidhur me lëvizjet e bursës, ka vazhduar përgatitja e përmbledhjes së shkurtër javore të lëvizjeve më të rëndësishme të bursës dhe në gjysmën e parë të vitit monitorohej çdo ditë lëvizja e çmimeve të aksioneve të bankave tregtare vendase. Në përputhje me proceset globale për reformimin dhe forcimin e normave referente të interesit në tregjet e parasë, Banka Popullore përgatiti analizë të mundësive për vendosjen e një norme të re referente të interesit në tregjet e brendshme të parasë, duke marrë parasysh praktikën aktuale të bankave në përcaktimin e normave të interesit në aktivitetet me klientët e tyre si dhe lëvizjet aktuale në tregjet e brendshme të parasë. Në vitin 2021, Banka Popullore mori pjesë në Grupin rajonal të punës për tregjet financiare të organizuar nga RCC (Regional Cooperation Council- RCC), por edhe në Këshillin për zhvillimin e tregut të kapitalit në vendin tonë, përmes të cilit Banka Popullore kontribuoi në përgatitjen e Strategjisë për liberalizimin dhe zhvillimin e tregjeve financiare me referencë të veçantë për tregun e kapitalit.

Qëllimi strategjik 7 - Nxitja dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i veprimtarisë hulumtuese në fushat që janë vendimtare për arritjen efikase të qëllimeve të Bankës Popullore



Banka Popullore i kushton vëmendje të madhe përpjekjeve për arritjen efikase të qëllimeve të saj. Në kuadër të këtyre përpjekjeve, **rëndësi kyçe ka veprimtaria kërkimore në fushat e politikës monetare, stabilitetit financiar dhe politikës makroprudente**. Përmes aktiviteteve të tilla, Banka Popullore është një nga bankat qendrore që vazhdimisht investon dhe përmirëson veprimtarinë e saj kërkimore në mënyrë që të krijojë bazë solide analitike që përdoret në marrjen e politikave dhe vendimeve për nevojat e Bankës Popullore. Kështu, gjatë vitit 2021, Banka Popullore ka punuar në disa materiale pune në fushën e makroekonomisë.¹¹⁰

Për shkak të përforsimit të transparencës së Bankës Popullore, është përpunuar edhe analizë për nivelin e kuptimit të komunikimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut me opinionin.

¹¹⁰ Materiale pune: "Transmisioni monetar kundrejt atij makroprudent: efikasitet dhe efektivitet"; "Efektet nga rritja e pagës minimale ndaj performancave të kompanive", si dhe analiza për "Euroizimin e amvisërive në Maqedoninë e Veriut".

Në suazat e tuining projektit të BE-së "Përforcimi i kapacitetit institucional të Bankës Popullore në rrugën drejt anëtarësisë së saj në sistemin evropian në bankat qendrore" është realizuar punimi hulumtues për ["Modelin dinamik stokastik i baraspeshës së përgjithshme \(modeli DSGE\) me euroizim të pjesëshëm: rasti i ekonomisë së Maqedonisë"](#). Qëllimi i këtij hulumtimi është që të vërtetohet lidhja mes cikleve reale dhe financiare në ekonominë e Maqedonisë, nëpërmjet zbatimit të modelit dinamik stokastik të baraspeshës së përgjithshme (modeli DSGE), i aftësuar me specifikat e ekonomisë së Maqedonisë.

Modeli është plotësues domethënës i infrastrukturës analitike të Bankës Popullore, duke qenë se modeli përfshin lidhjet ndërmjet sektorëve individual të ekonomisë, duke përfshirë bankat, amvisëritë, ndërmarrjet. Kështu, nëpërmjet këtij modeli mund të simulohen efektet e goditjeve të ndryshme dhe të vlerësohen efektet në ekonomi në tërësi, por edhe në sjelljen e sektorëve të veçantë. Mund të përdoret për analiza dhe kërkime ekonomike, por edhe për simulime, që ka kontribut të madh në formulimin e politikës monetare, si dhe për bartës të tjerë politik sepse mundëson **analizën e ciklit ekonomik në vendin tonë në 15 vitet e fundit**. Në të njëjtën kohë, është i pari i këtij lloji, i cili do të jetë referencë e rëndësishme për kërkime dhe analiza të mëtejshme të ndikimit të zhvillimeve të sektorit financiar në ekonomi. Gjithashtu, gjatë vitit 2021 në mënyrë aktive është punuar në analiza kërkimore në fushat e konsumit të mallrave të qëndrueshme në Maqedoninë e Veriut, është shqyrtuar ekzistimi i asimetrive në përshtatjen e normave të interesit dhe janë analizuar marzhat në ekonominë vendore duke përdorur të dhëna makroekonomike dhe mikroekonomike.

Sa i përket aktiviteteve kërkimore në fushën e stabilitetit financiar, janë përgatitur edhe disa punime të cilat kanë përmirësuar mundësitë analitike dhe njohuritë dhe përvojën e përgjithshme. Për të mbështetur politikat dhe praktikën makroprudente dhe për të ruajtur stabilitetin financiar, janë bërë disa analiza në fushën e përmendur më parë. Në tremujorin e fundit të vitit 2021, është përgatitur pyetësor në lidhje me politikat dhe praktikën e bankave në kreditimin e banesave si dhe pikëpamjet e tyre mbi zhvillimet aktuale në tregun e pasurive të patundshme. Pas përmbledhjes së rezultateve, u bë analizë e hollësishme nga aspekti i kreditimit të këtij segmenti për të perceptuar rreziqet për sistemin bankar në këtë fushë të kreditimit dhe rishikimin e masave të propozuara në rast nevojë për marrjen e masave parandaluese, makroprudente apo masave të tjera në këtë fushë.

Për t'i parë pasojat e krizës së koronës në punën e kompanive me borxhe më të mëdha gjatë vitit 2020, në përfitimin, likuiditetin dhe borxhin e tyre gjegjësisht ndikimin në profilin e përgjithshëm të borxhit të tyre dhe në fund në rreziqet që rrjedhin nga këto kompani, për bankat vendore, është bërë analiza e 20 kompanive nga sektori i korporatave vendore ndaj të cilave bankat vendase kanë ekspozimin më të madh të kredisë.

Për të kuptuar të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me kompetencat dhe rolin e Këshillit mbikëqyrës në udhëheqjen korporative të bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në periudhën nga dhjetori 2020 deri në janar 2021, Banka Popullore ka kryer Anketën për mënyrën e punës të Këshillave mbikëqyrës në banka. Bazuar në përgjigjet e marra nga analiza, u fitua pasqyrë e përgjithshme e karakteristikave bazë, pikëve të forta apo të dobëta në udhëheqjen korporative të bankave në vend, e cila është vendimtare për stabilitetin e bankave dhe për performancën efikase të rolit të ndërmjetësve financiarë. Ajo mund të shërbejë si udhërrëfyes për mbikëqyrjen, por mbi të gjitha për bankat, në identifikimin e fushave në punën e Këshillave mbikëqyrës ku analiza tregon nevojën për përmirësime apo ndryshime të caktuara.

Në vitin 2021, Banka Popullore vazhdoi me organizimin tremujor të [Klubit të hulumtuesve](#), në format virtual, ku prezantohen dhe shqyrtohen materialet e punës dhe punimet kërkimore për temat përkatëse. Banka Popullore ndau edhe këtë vit Çmimin vjetor për hulumtues të rinj ndërsa punimi i shpërblyer u prezantua në [39 sesione të Klubit të hulumtuesve](#). Në vitin 2022, Banka Popullore do të vazhdojë të promovojë veprimtarinë kërkimore dhe të organizojë Klubin e hulumtuesve.

Qëllimi strategjik 8 - Sigurimi i të dhënave kualitative statistikore, në përputhje të plotë me standardet statistikore ndërkombëtare dhe evropiane, duke marrë parasysh peshën e raportimit dhe përhapjen e tyre efikase, në kohë dhe të lehtë për përdoruesit



Gjatë vitit 2021, tronditja negative e shkaktuar nga pandemia Covid-19 nuk ka ndikuar në cilësinë dhe rrjedhën e procesit të përpilimit, e me këtë edhe në shpërndarjen e të dhënave statistikore në Bankën Popullore. Ndryshe, në këtë vit të pasigurisë për shkak të krizës shëndetësore, **janë mbledhur, përgatitur dhe publikuar vazhdimisht statistika në fushën e statistikave të jashtme, monetare dhe statistikave të llogarive financiare**, në përputhje me kalendarin për publikimin e të dhënave pa vonesa kohore ndërsa fushëveprimi dhe cilësia e burimeve dhe prodhimit të të dhënave kanë mbetur të pandryshuara në nivel të lartë.

Përkundër rrethanave specifike, Banka Popullore vazhdoi me **aktivitete për përmirësimin e cilësisë së të dhënave statistikore dhe bashkëpunimin me institucionet vendore dhe ndërkombëtare**, të cilat më së shumti iu referuan aktiviteteve në kuadër të projekteve ndërkombëtare, nga të cilat do të veçonim më të rëndësishmet:

- **Projekti për harmonizimin e mëtejshëm të statistikave të llogarive financiare me standardet e ESCB/ECB** (komponenti 3 i projektit të twinningut të BPRMV), shënoi përfundimin me sukses të të gjitha aktiviteteve të planifikuara. Rezultatet kryesore të këtij projekti janë: a) përpilimi i një versioni pilot/eksperimental të të dhënave për llogaritë financiare vjetore-rrjedhat, sipas sektorëve/nënsektorëve; b) identifikimi i burimeve të të dhënave dhe metodave të vlerësimit për hartimin e pasqyrave financiare tremujore fillestare për gjendjet dhe rrjedhat, sipas sektorëve dhe nënsektorëve; c) zhvillimi i metodave për konsolidimin e të dhënave nga llogaritë financiare ndërmjet njësive institucionale të të njëjtit sektor/nënsektor, për vitin 2018;
- **Projekti IPA 2017 i Entit Shtetëror të Statistikave (ESSH)** për treguesit e disbalancës makroekonomike (tregues për MIP), në kuadër të të cilit u përgatitën tre tregues shtesë në fushën e llogarive financiare (për kreditë e sektorit privat) dhe dy tregues në fushën e mbikëqyrjes, me shpjegime të përshtatshme metodologjike (meta të dhëna);
- **Pjesëmarrje në projektin IPA 2017 të ESHS-së për statistikën e tregtisë së jashtme të shërbimeve**, qëllimi kryesor i të cilit është zëvendësimi i burimit ekzistues të të dhënave për eksport dhe import të shërbimeve dhe vendosja e raportimit të drejtpërdrejtë;
- **Pjesëmarrja në projektin e KB-së "Diskursi i migracionit, politika dhe planifikimi i bazuar në dëshmi"**, qëllimi kryesor i të cilit është të ofrojë mbështetje për menaxhimin e migracionit dhe dinamikën demografike në RMV. Në kuadër të

projektit u përcaktuan nevojat e Bankës Popullore për kryerjen e anketës për transferet private si dhe u përgatit draft- metodologji dhe pyetësor anketues. Anketa është planifikuar për gjysmën e parë të vitit 2022;

- Gjatë vitit ka vazhduar **bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet Bankës Popullore, Ministrisë së Financave (MF) dhe Entit Shtetëror të Statistikave (ESHS)** në fushën e statistikave të llogarive financiare, statistikave të Qeverisë për borxhin dhe deficitin e tepërt si dhe projekte të përbashkëta për ndihmë teknike për zhvillimin e mëtejshëm të më shumë fushave statistikore. Pjesëmarrja e Bankës Popullore në **Projektin e statistikave qeveritare të FMN-së me MF-në dhe ESHS-në është veçanërisht e rëndësishme.**

Njëkohësisht, gjatë vitit është punuar në mënyrë aktive në zhvillim dhe ngritje të mëtejshme në segmente të caktuara, që kanë të bëjnë me shpërndarjen e të dhënave statistikore dhe përmirësimin metodologjik të tyre. Aktivitetet e rëndësishme që shënuan vitin 2021 janë:

- Në fushën e **statistikave të llogarive financiare**, krahas prodhimit të të dhënave vjetore për gjendjet, gjatë vitit është punuar për përgatitjen e të dhënave eksperimentale për llogaritë financiare tremujore, sipas sektorëve/nënsektorëve dhe instrumenteve financiare. Aktivitetet zhvillimore u zhvilluan në sistemin e ri për prodhimin e llogarive financiare. Në të njëjtën kohë, është punuar intensivisht për zhvillimin e treguesit "letrat me vlerë të borxhit" të standardit SDDS plus. Janë përgatitur të dhënat për letrat me vlerë të borxhit, sipas sektorëve të lëshuesve dhe poseduesve (seri kohore të të dhënave për periudhën nga tremujori i parë 2016 deri në tremujorin e katërt 2020). Të dhënat dhe metodologjia e përgatitur i dorëzohen FMN-së për shqyrtim fillestar dhe miratohen nga përfaqësuesi zyrtar për standardin SDDS plus.
- Në fushën e **statistikave të jashtme**, për vendosjen e një sistemi efikas të raportimit, janë përpunuar disa projekte për riorganizimin e procesit të mbledhjes së të dhënave (për operacionet e kreditimit të huaj dhe investimet direkte) përmes prezantimit të raportimit elektronik. Aktivitetet e BPRMV për zhvillimin e një depoje të vetme statistikore të të dhënave për statistikën e jashtme, përmes një projekti të ri, vazhduan edhe në vitin 2021, me qëllim përfshirjen e këtij projekti në kuadër të IPA III, për çka u përgatitën dokumentet e nevojshme të projektit.
- Në fushën e **statistikave monetare**, në kuadër të projektit afatgjatë për ngritjen e një sistemi të integruar të raportimit për nevojat e statistikave dhe mbikëqyrjes ISIDORA, janë ndërmarrë disa aktivitete që lidhen me: a) përcaktimin e nivelit të detajimit që do të raportohet sipas instrumenteve individuale (kryesisht huatë dhe depozitat); b) përgatitjen e dokumenteve fillestare të raportimit- udhëzimit teknik dhe specifikimit funksional; c) janë mbajtur disa seminare me bankat për harmonizimin e mëtejshëm të kërkesave të raportimit.

Gjatë vitit 2021, përveç publikimit të rregullt të njoftimeve statistikore, janë ndërmarrë aktivitete shtesë për **përmirësimin e komunikimit me publikun dhe forcimin e transparencës, edhe atë:**

- Përmirësimi i mënyrës së komunikimit me publikun, nëpërmjet vizualizimit më të mirë, publikimit të artikujve me përmbajtje statistikore në media dhe rrjetet sociale;

- Si pjesë e projektit për përmirësimin e qasjes dhe kuptimit të statistikave të publikuara nga Banka Popullore, u mbajt një e-punëtori për gazetarët dhe ligjeratë nga Fakulteti Ekonomik pranë USHKM, kushtuar statistikave mbi llogaritë financiare;
- Përfshirja e Bankës Popullore në shënimin e Ditës së statistikave evropiane, nëpërmjet mbajtjes së ligjeratës për studentët në disa institucione të arsimit të lartë në vend (Fakulteti i Ekonomisë dhe Bujqësisë në USHKM, Fakulteti Ekonomik në Universiteti Goce Dellçev dhe Universiteti Kolegji amerikan- Shkup).

Gjithashtu, në tetor 2021 është realizuar **hulumtimi i dytë anketues për atë se sa janë të kënaqur informuesit dhe shfrytëzuesit nga statistikatat në kompetencë të Bankës Popullore** ndërsa rezultatet e marra tregojnë se është mbajtur cilësia e lartë e funksionit statistikor në Bankën Popullore dhe se ekziston niveli i kënaqshëm si te shfrytëzuesit ashtu edhe te dorëzuesit e informacioneve.

Qëllimi strategjik 9 - Përgatitja e Bankës Popullore për qasje dhe anëtarësim në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore



Gjatë vitit 2021, aktivitetet lidhur me përcaktimin strategjik të Bankës Popullore për miratimin e praktikave më të mira evropiane u zhvilluan pavarësisht rrethanave të vështira për shkak të krizës shëndetësore. Kështu, në kuadër të **Programit rajonal të financiar nga BE për ngritjen e kapaciteteve të vendeve candidate dhe kandidatëve potencial për anëtarësim në BE nga Ballkani Perëndimor**, i cili zyrtarisht përfundoi në dhjetor 2021, përfaqësues të Bankës Popullore morën pjesë në shtatë trajnime në fushat e: supervisionit bankar, stabilitetit financiar, rimëkëmbjes dhe zgjidhjes së bankave, statistikës, revizionit të brendshëm dhe harmonizim me rregullativën dhe integrimin evropiane. Gjithashtu, është mbajtur punëtori e nivelit të lartë për çështje në fushën e menaxhimit si dhe dy masa bilaterale¹¹¹ dhe një trajnim praktik¹¹².

Twinning projekti „Forcimi i kapacitetit institucional të BPRMV në rrugën drejt anëtarësimit në SEBQ” formalisht përfundoi në mars 2021. Në tremujorin e fundit të projektit u mbajtën takimi i gjashtë dhe i shtatë i Këshillit drejtues të projektit, punëtorja përfundimtare dhe punëtorja e qëndrueshmërisë si dhe [konferenca përfundimtare e projektit](#). Në kuadër të katër komponentëve të projektit- shërbimet e pagesave dhe sistemet pagesore, rregullimi dhe mbikëqyrja bankare, statistikatat e llogarive financiare dhe njohuritë dhe aftësitë në analizën e politikave, janë kryer nëntë misione virtuale të ekspertëve dhe një vizitë studimore virtuale. Gjithashtu për secilin komponent është mbajtur ngjarje për dukshmëri. Krahas kësaj, për projektin u realizua një video, e cila u nda me publikun gjatë marsit 2021 si dhe u përgatit dhe u publikua edicioni i fundit i buletinit të rregullt tremujor të projektit¹¹³.

¹¹¹ Masa e parë bilaterale u zbatua në bashkëpunim me Bankën Popullore Kroate (HNB) dhe kishte për qëllim përfundimin e mëtutjeshëm të funksionit të marrëdhënieve ndërkombëtare, sidomos në procesin eurointegruar të vendit. Ekspertët e HNB së bashku me ekspertët e BPRMV përpunuan draft- udhërrëfyes për BPRMV në rrugën e anëtarësimit të saj në sistemin evropian të bankave qendrore (SEBQ), i përpiluar në bazë të përvojës së HNB në procesin e aderimit në SEBQ si dhe bashkëpunimin e tyre me institucionet evropiane pas hyrjes në BE. Masa e dytë bilaterale u zbatua në bashkëpunim me Bankën qendrore të Portugalisë dhe kishte për qëllim harmonizimin e mëtutjeshëm me kërkesat statistikore të SEBQ ("Baza e të dhënave të llogarive").

¹¹² Trajnimi praktik u mbajt në mënyrë virtuale, me Bankën qendrore të Irlandës në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve. Në projekt, ishte paraparë ky aktivitet të realizohet si punë praktike, por për shkak të rrethanave të shkaktuara nga pandemia, është mbajtur në mënyrë virtuale, në formë të trajnimit virtual.

¹¹³ Buletinet janë të kapshëm në faqen e internetit të Bankës Popullore: [Buletine magedonase për projekte \(nbrm.mk\)](#)

Në kuadër të **Programit për bashkëpunim statistikor të financuar nga Programi shumëpërdorues IPA**, përfaqësues të Bankës Popullore në bashkëpunim me Entin Shtetëror të Statistikave dhe Eurostat-in morën pjesë në projekte në fushën e statistikave. Gjithashtu, përfaqësues të BPRM-së morën pjesë në aktivitetet e rregullta në kuadër të procesit të integrimeve evropiane (takimet e rregullta të Nënkomitetit për çështje ekonomike dhe financiare dhe statistikore dhe Nënkomisionit për tregun e brendshëm dhe konkurrencën, pjesëmarrje në përgatitjen e Programit të reformës ekonomike si dhe pjesëmarrje në përgatitjen e kontributit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Raportin vjetor të progresit të Komisionit Evropian për periudhën tetor 2020 - mars 2021 dhe për periudhën prill 2021 - qershor 2021).

Gjatë vitit 2021, bashkëpunimi teknik dypalësh i BPRMV me bankat e tjera qendrore është realizuar në format virtual me intensitet dhe numër të reduktuar të trajnimeve. Në kuadër të Memorandumit të bashkëpunimit me **Bankën qendrore të Malit të Zi**, BPRMV shkëmbeu përvoja në fushën e menaxhimit të rezervave valutores, rolin e bankave qendrore si agjent fiskal dhe aspektet kontabël në matjen e fondeve në kuadër të rezervave valutores.

Qëllimi strategjik 10 - Përmirësimi i mëtejshëm i menaxhimit të korporatës, transparenca dhe përgjegjësia sociale e institucionit



Realizimi i aktiviteteve programore të ndërlidhura me përmirësimin e menaxhimit korporativ, transparenca dhe përgjegjësi sociale përfshinë shumë aspekte të punës së Bankës Popullore¹¹⁴.

12.1. Komunikimi me publikun

Në vitin 2021, vazhduan aktivitetet e Bankës Popullore për rritjen e **transparencës dhe të përmirësimit të komunikimit me publikun** (media, gazetarët, komuniteti i biznesit, qytetarët, publiku i gjerë dhe profesional, organizatat përkatëse ndërkombëtare). Banka Popullore mundësoi njoftim të publikut me informacione, aktivitete dhe risi në punën e saj përmes shpalljes së rregullt të kumtesave për publikun, ashtu që ky kanal komunikues ishte veçanërisht i përdorur me shpalljen rreth 4 kumtesave javore. Banka Popullore forcoi gjithashtu praninë e medias sociale dhe përmirësoi gjithashtu cilësinë e postimeve. Gjatë vitit, filluan të aplikohen standardet e vendosura për montimin dhe transferimin e përmbajtjeve të përshtatshme për mediat sociale. Për transferimin e aktiviteteve të Bankës Popullore nëpërmjet këtyre kanaleve të komunikimit, të dedikuara për publikun e gjerë, thjeshtojnë ndjeshëm gjuhën dhe konceptin e përmbajtjes. Në të njëjtën kohë, u fillua me përdorim të ilustrime të dizajnuara për të inkurajimin e ndërveprimit me audiencën dhe për të rritur vizitën e faqes¹¹⁵.

Gjatë vitit, pyetjeve të drejtuara Bankës Popullore kanë marrë përgjigje të rregullta, si nga media ashtu edhe nga persona të tjerë fizikë dhe juridikë të adresuar përmes kanaleve zyrtare të komunikimit të Bankës Popullore. Banka Popullore ishte në dispozicion të publikut edhe përmes intervistave të shumta me personave udhëheqës të Bankës Popullore

¹¹⁴ Aktivitetet të ndërlidhura me auditimin e brendshëm dhe resurset njerëzore janë pjesë e kësaj qëllimi strategjik në pjesën IX dhe X të Raportit vjetor të BPRMV.

¹¹⁵ Numri i postimeve në mediat sociale në Facebook ishte rreth 250, me një numër të ngjashëm postimesh në Instagram dhe Twitter. Numri i ndjekësve në rrjetet sociale në Facebook ishte 19.164 (31.12.2021), në Instagram 1277 ndjekës, ndërsa në Twitter 495 ndjekës. Numri i vizitave në faqen e Bankës Popullore është më i madh se numri i ndjekësve, për shembull në profilin e Facebook-ut, pa sponzorim të postimeve, vizita arrin deri në 40 mijë vizita nga përdorues të ndryshëm për 28 ditë, sipas analizës së rrjetit.

për tema të lidhura me punën e Bankës Popullore, ndërsa gjithashtu u realizuan edhe pjesëmarrje në një sërë ngjarjesh.

Krahas aktiviteteve të rregullta të planifikuara, në fushën e marrëdhënieve me publikun, Banka Popullore vazhdoi të realizojë një sërë aktiviteteve projektuese me qëllim të përmirësimit të nivelit të kuptuarit të temave që ndikojnë në punën e bankës qendrore. Madje, ndër të tjera, në vitin 2021, Banka Popullore organizon dy punëtori për gazetarë – [punëtori për të dhënat statistikore për llogaritë financiare](#) dhe [punëtori për funksionin supervizion të Bankës Popullore](#). Gjithashtu u mbajt një takim i rregullt vjetor me gazetarë dhe u prezantuan gjetjet nga misioni i Kodit të Transparencës të FMN-së.

Gjatë vitit 2021, **Banka Popullore ishte banka e dytë qendrore në botë, për të cilën FMN bëri një vlerësim të praktikave të zbatuara të transparencës, me parimet e parashikuara në Kodin e rishikuar të Transparencës të FMN-së**, i miratuar në korrik 2020. Ky vlerësim është bërë me iniciativën e Bankës Popullore. FMN-ja kreu një mision në të cilin shqyrtoi në detaje tërësinë e praktikave dhe proceseve që mundësojnë transparencën e Bankës Popullore në aspektin e punës, raportimit për politikën, aktivitetet, rezultatet, si dhe në aspektin e marrëdhënieve afariste. Gjithashtu, në kuadër të misionit, përfaqësues të Fondit zhvilluan disa intervista me disa palë të interesuara, si institucione të tjera shtetërore, përfaqësues të ofruesve të shërbimeve financiare dhe media. Sipas konstatimeve të Misionit të Fondit¹¹⁶, nga gjithsej 90 parime për transparencë, për gjysmën e parimeve Banka Popullore zbaton praktika më gjithëpërfshirëse se sa parashikon Kodi, dhe në segmentet e tjera praktikave të transparencës janë brenda kërkesat e Kodit. Pajtueshmëria e lartë e praktikave të zbatuara nga Banka Popullore me atë të paraparë në Kodin, është një konfirmim domethënës i përpjekjeve të Bankës Popullore në periudhën e kaluar për përmirësimin e komunikimit, transparencës në punë, ndërsa me këtë edhe kredibilitetit të institucionit në opinion.

12.2. Edukim dhe inkluzion financiar

Në vitin 2021, Banka Popullore vazhdoi me zbatimin e rregullt të aktiviteteve që kontribuojnë në ngritjen e mëturësive të kapaciteteve për zhvillimin e edukimit financiar dhe përmirësimin e mëtejshëm të përfshirjes financiare të popullatës. Gjithashtu, u ndërmorën aktivitete për finalizimin e dokumentit strategjik të Strategjisë kombëtare pesëvjeçare [Strategjia për edukimin financiar dhe përfshirjen financiare 2021 - 2025](#), e cila u miratua nga rregullatorët financiarë dhe u promovua më 8 korrik 2021 në e-ngjarjen në të cilën morën pjesë të gjitha subjektet e përfshira - rregullatorët e sektorit financiar, sektori civil dhe privat. Strategjia¹¹⁷ duhet të kontribuojë në rritjen e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet rregullatorëve financiarë, sektorit civil dhe privat, si dhe qasjes sistematike të të gjithë subjekteve të përfshira për shkak të forcimit të edukimit financiar të popullatës, përmirësimi i shkallës së përfshirjes financiare, në të njëjtën kohë siguri të mbrojtjes përkatëse të konsumatorëve. Banka Popullore, së bashku me rregullatorët e tjerë financiarë, në bashkëpunim me INFE-OECD dhe Ministrinë e Financave të Holandës, më 16 dhe 17 shtator 2021 realizuan punëtori për promovimin e Strategjisë me temë: ["Përpjekje të koordinuara për përfshirjen e arsimit financiar në Maqedoninë e Veriut"](#). Në punëtori janë

¹¹⁶ Raporti është i disponueshëm në faqen e internetit të FMN-së: <https://www.imf.org/external/datamapper/CBT/reports/>.

¹¹⁷ Strategjia është përgatitur në kuadër të projektit rajonal për edukimin financiar të mbështetur nga Ministria e Financave e Holandës dhe INFE-OECD.

shqyrtuar edhe çështje për arsimimin financiar në raport me shërbimet financiare digjitale, si dhe aspekte që lidhen me edukimin financiar digjital.

Në përputhje me aktivitetet e parapara me Strategjinë, Banka Popullore në bashkëpunim me Trupin koordinues të rregullatorëve financiar për edukimin financiar dhe përfshirjen financiare (TK), punuan në përgatitjen e [Kodit të praktikave të mira për edukim financiar](#), e cila ishte e miratuar në shtator 2021. Kodi përcakton parimet që duhet të zbatohen të gjitha subjektet e përfshira nga sektori publik, privat dhe civil gjatë realizimit të edukimit financiar të popullsisë. Për zbatimin e Strategjisë është formuar **Grupi Punues për monitorimin e zbatimit të Strategjisë** i përbërë nga përfaqësues të rregullatorëve financiarë, sektorit privat dhe civil, i cili ka mbajtur seancën e parë në dhjetor 2021.

Banka Popullore edhe më tej vazhdon aktivitetet e edukimit financiar për popullatën e rritur, duke publikuar **tekste edukative** nga seria "*Ekonomia për të gjithë*", **video materiale edukative** nga seria "*Me Bankën Popullore në botën e financave*", ndërsa në të njëjtën kohë filloi me përgatitjen dhe publikimin e [infografikeve edukative](#). Gjithashtu, gjatë vitit janë realizuar një numër i shtuar i prezantimeve elektronike edukative për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme (102 ligjëratat edukative për 6007 nxënës dhe 264 mësues dhe profesorë). Në periudhën nga shkurti deri në prill 2021 janë zhvilluar aktivitete për **"Kuizi Evropian i parave"**, me të cilave është edhe takimi i punës me mësuesin dhe profesorët për përgatitjen e këtij kuizi. Në mars 2021 u shënuar **"Java Globale e Parasë"** përmes e-ligjëratave të mbajtura për nxënës të shkollave fillore dhe të mesme dhe publikimit të materialeve edukative. Në muajin tetor u organizua Konkursi tradicional **për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme me rastin e "Ditës Botërore të Kursimit - 31 Tetori"**, e cila edhe këtë vit hasi në interes të madh të popullatës. Në kuadër të **"Ditëve të arsimit financiar"**, e cila u zhvillua nga 1 deri më 3 dhjetor, u realizuan katër prezantime virtuale me tema: "Politika monetare e Bankës Popullore"; "Informacionet e nevojshme gjatë përzgjedhjes së kredive"; "Sistemi i pagesave dhe shërbimet e pagesave" dhe "Supervizionet bankare", të cilat u ndoqën nga qytetarët që u paraqitën në thirrjen publike.

12.3. Puna e muzeut, bibliotekës dhe arkivit

Muzeu gjatë vitit 2021 ka zhvilluar aktivitetet e tij aktuale lidhur me proceset e punës të cilët kanë të bëjnë me punën profesionale muzeale, por në të njëjtën kohë janë përgatitur intensivisht dhe një sërë aktivitetesh edukative muzeale lidhur me shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Muzeut. Për këtë qëllim, në gjysmën e dytë të muajit maj muzeu mbajti edhe **18 e-takime interaktive edukative** me nxënës nga klasa e 3 deri në klasën e 9-të nga gjashtë shkollat fillore të Komunës së Qendrës, ku **morën pjesë rreth 100 nxënës**. Veç kësaj, aktivitetet edukative të Muzeut përfshinin **publikimin promovues të gjashtë videoregjistrimeve për çështjet më ekskluzive dhe më të rëndësishme monetare**, të cilat janë prodhuar në territorin e shtetit modern maqedonas, duke filluar nga shekulli 6 p.e.s., deri në periudhën osmane. Videoregjistrimet, të realizuara tërësisht nga kuratorët e Muzeut, janë të disponueshme në [ueb-faqen zyrtare të Bankës Popullore](#) dhe në faqet zyrtare të rrjeteve sociale, të cilat i ofrojnë publikut të gjerë videoqasje deri te vlerat më të rëndësishme dhe më vlefshme e Koleksionit Numizmatik.

[Biblioteka](#) e Bankës Popullore **është e vetmja bibliotekë në vend, fondi i së cilës pasurohet rregullisht me botimet më të fundit të bankave qendrore të vendeve të tjera dhe publikime të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare**, siç janë

Banka Botërore, Fondi Ndërkombëtar Monetar, Banka Qendrore Evropiane, Banka për Shlyerjet Ndërkombëtare, etj. Kështu, Biblioteka dhe arkivi i Bankës Popullore, gjatë vitit 2021, pasuruan fondin e bibliotekës me literaturë profesionale të periodikëve dhe titujve monografikë të autorëve të huaj dhe vendas. Katalogimi dhe regjistrimi i rregullt në aplikacionin e bibliotekës dhe në COBISS kontribuan në disponueshmëri më të madhe të literaturës profesionale si për të punësuarit e Bankës Popullore ashtu edhe për përdoruesit e jashtëm. [Fondi arkivor](#) u pasurua me lëndë arkivore të digjitalizuar nga puna e Bankës Popullore, me kontrolle të rregullta për çdo hyrje të re. Disa funksionalitete në aplikacionin e arkivit digjital janë përmirësuar dhe është krijuar një regjistër i materialeve konvencionale për regjistrim më të mirë të materialeve arkivore të cilat jo vetëm janë në formë digjitale, por edhe ruhen fizikisht si pjesë e fondit të Bibliotekës dhe arkivit të Bankës Popullore.

12.4. Strategjia dhe preventiva

Zyra për Strategji dhe Preventivë, si njësi e veçantë organizative e pavarur në Bankën Popullore për **linja e dytë e mbrojtjes**, gjatë vitit 2021 edhe përkundër rrethanave të jashtëzakonshme ka vazhduar të kryejë funksionet e saj të planifikimit strategjik, menaxhimit të rrezikut operativ, sigurimi i pandërprerë të punës, siguri të sistemit të informacionit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacione të klasifikuar, si dhe kontroll të përputhshmërisë së punës. Edhe gjatë vitit 2021, Banka Popullore ka monitoruar në mënyrë aktive situatën me pandeminë në vend, si dhe shkallën e imunizimit të të punësuarve në Bankën Popullore, në bazë të të cilave në mënyrë proaktive **ndërmori masa për zbutjen e rrezikut të ndërprerjes së proceseve të punës për shkak të humbjes së personelit kyç për të siguruar funksionalitetin e plotë të proceseve të punës.**

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2021 janë harmonizuar planet e rishikuara për vazhdimësinë e proceseve të punës, është përgatitur Raporti vjetor për zbatimin e Politikës për sigurimin e vazhdimësisë së punës, i cili është shqyrtuar në seancën XXII të Shtabit të Krizave. Në përputhje me konkluzionet e miratuara në seancë, në qershor 2021 është përgatitur dhe miratuar Plani i rishikuar për sigurimin e vazhdimësisë së punës së Bankës Popullore. Gjithashtu, për të vërtetuar plotësinë dhe realizueshmërinë e Planit për sigurimin e vazhdimësisë së punës, gjatë vitit 2021 janë kryer të gjitha testet e planifikuara të planeve për mosndërprerje të 19 proceseve kritike të punës në kompetencë të 11 njësive organizative.

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes të të punësuarve për **sigurinë e sistemit informativ, mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë e informacionit të klasifikuar**, gjatë vitit 2021 janë zhvilluar trajnime për më shumë se 119 të punësuar në Bankën Popullore. Rregullisht kontrollohej përputhshmëria e punës me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, gjendja dhe siguria e informacionit të klasifikuar, si dhe përputhshmëria e Bankës Popullore me kontrollet e detyrueshme të sigurisë tek klientët e SWIFT¹¹⁸. Të dhënat për përputhshmërinë e Bankës Popullore me të gjitha kontrollet e detyrueshme të përcaktuara në Kornizën për kontrolle të sigurisë tek klientët SWIFT ishin të publikuara në kohë në regjistrin përkatës¹¹⁹. Incidentet e raportuara janë trajtuar gjithashtu në baza të rregullta. Në vitin 2021 vazhduan aktivitetet e filluara për harmonizim me Ligjin e ri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nga viti paraprak. Për këtë qëllim është kontrolluar përputhshmëria e mbi 100 akteve, si dhe janë përgatitur propozim-udhëzimet për ndryshime në rreth 60 akte, të cilat janë zbatuar nga njësitë organizative kompetente.

¹¹⁸ (CSCF Assessment Template for Mandatory Controls 2020 v3).

¹¹⁹ KYC Registry Security Attestation.

Në vitin 2021, me ftesë të **Qendrës Koordinuese për Rezistencën Kibernetike**¹²⁰ në Bankën për Shlyerje Ndërkombëtare (BIS), Banka Popullore mori pjesë në pilot-projektin për Vlerësimin e Rezistencës Kibernetike, ashtu që rezultatet e vlerësimi treguan se **Banka Popullore menaxhon në mënyrë aktive pozicionin e saj të sigurisë, me përdorimin e proceseve të mira të vendosura për menaxhim me rrezik dhe mosndërprerje në punë, duke çuar në nivele më të larta të qëndrueshmërisë.** Gjithashtu, gjatë vitit 2021, Banka Popullore ka nisur projektin **për përforcimin e Qendrës Operative të Sigurisë (Security operation center)** në fushën e monitorimit dhe aftësisë së reagimit ndaj incidenteve kibernetike. Duke ndjekur zhvillimin dinamik të teknologjive informative dhe transformimit të përsheptuar digjital, Banka Popullore edhe më tej do të vazhdojë të monitorojë dhe harmonizohet me standardet e fushës së sigurisë së informacionit dhe sistemit të informacionit, rregullativat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë e informacionit të klasifikuar.

Aktivitetet rregullta të ndërlidhura me procesin për **planifikimin e strategjive** janë duke vijuar në pajtim me kornizën e parashikuar. Realizimi i qëllimeve strategjike në Bankën Popullore u arrit përmes programeve të aktiviteteve dhe projekteve, si dhe në vendosjen **misionit dhe vizionit**. Rregullisht janë njoftuar për rezultatet e arritura, përmes raporteve për realizim të programit të punës ¹²¹. Nga ana e Këshillit të Bankës Popullore u miratua **Plani strategjik i ri**¹²² **për periudhën 2022 – 2024**, si dhe **Programi për punë për vitin 2022**, me të cilat u përcaktuan më konkretisht proceset e punës dhe aktivitetet projektuese, të cilat do të kontribuojnë për realizimin e qëllimeve strategjike. Banka Popullore monitoron rregullisht ndryshimet në mjedis për të identifikuar segmentet të cilave duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë dhe në të cilat, si bankë qendrore, duhet të investojë resurse dhe energji shtesë.

Kështu, në Planin e fundit Strategjik 2022 - 2024, u përcaktuan disa **qëllime të reja strategjike (transparenca, edukimi dhe përfshirja financiare, ndryshimet klimatike dhe krijimi i një ekonomie "të blerët" dhe të qëndrueshme**¹²³, **forcimi i menaxhimit me rrezikun)** të cilave do t'u kushtohet vëmendje në tre vitet e ardhshme. Në seancat e NOIS¹²⁴ u monitorua statusi i realizimit të projekteve dhe u punua në përmirësimin e rregullativave për menaxhimin e projekteve¹²⁵ që janë mbështetja kryesore

¹²⁰ CRCC (Cyber Resilience Coordination Centre).

¹²¹ Raporti vjetor për realizim të Programit të punës të vitit 2020, është pjesë përbërëse e Raportit vjetor të Bankës Popullore, e cila miratohet nga Këshilli dhe dorëzohet deri te Kuvendi i RMV. Raportit i gjysëmvetorit për realizim të aktiviteteve programore dorëzohet deri te udhëheqësit strategjik

¹²² Plani i ri strategjik është rezultat i aktiviteteve të parapara zhvillimore për avancimin e procesit të planifikimit strategjik. U krye **ridefinimi i synimeve strategjike**, ku përfshiheshin projekte dhe aktivitete të rëndësishme që në tre vitet e ardhshme pritet të kontribuojnë në ndryshimet dhe përmirësimin e funksionimit, si dhe në realizimin e detyrave dhe funksioneve ligjore të Bankës Popullore. Janë bërë **ndryshime edhe në shtrirjen**, kështu që numri i qëllimeve strategjike është zvogëluar nga 11 në 9, me çka në qendër të kujdesit janë vënë pikat më të rëndësishme, kritike të punës së Bankës Popullore, të cilat janë bazë për përgatitjen e planeve të njësive organizative dhe Programit të punës të Bankës Popullore për vitin e ardhshëm. Gjithashtu, **janë bërë ndryshime në përmbajtje dhe dizajn**, ashtu që për çdo qëllim strategjik ka sfidë, aktivitete dhe rezultate të pritshme. Përveç **fjalimit të guvernatorit**, ekziston një seksion për **analizën e mjedisit, mësimet e nxjerra dhe përvojat e fituara**. Është bërë **riprecizimi i misionit, vizionit dhe vlerave**. Me qëllim të forcimit të transparencës dhe njohjes më të madhe të Bankës Popullore dhe për t'i afruar aktivitetet e saj me publikun, në faqen e internetit **u bënë ndryshime në pjesën e planifikimit strategjik**, ku jepej përshkrimi i motos së Planit të ri Strategjik, vizioni, misioni dhe vlerat organizative, renditen 9 qëllimet strategjike dhe çfarë pritet me realizimin e tyre, si dhe është vendosur edhe lidhje me të gjitha planet e mëparshme strategjike.

¹²³ Në fillim të vitit 2021, **Banka Popullore u bë anëtare e rrjetit ndërkombëtarë për sistemin financiar të blerët**, në të cilin aktualisht janë 100 anëtarë dhe 16 mbikëqyrës nga bankat qendrore dhe institucionet supervizione në mbarë botën, që mbështesin deklaratën ndërkombëtare në Konferencën e OKB-së për Ndryshimet Klimatike. Pra, është ndër bankat qendrore që kanë angazhime të qarta dhe të forta brenda kompetencave të tyre për të kontribuar në zhvillimin e menaxhimit të rrezikut në sektorin financiar që rezultojnë nga ndryshimet klimatike.

¹²⁴ Këshilli Mbikëqyrës për sistemin informativ të Bankës Popullore.

¹²⁵ Gjatë vitit 2021 është përmirësuar rregullativa për menaxhimin e projekteve, e cila parashikonte përfshirjen e funksionit për strategjinë për rreziqet strategjike dhe operacionale dhe funksionin e sigurisë së sistemit informativ, mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionit të klasifikuar në fazën e hershme të zhvillimit të projekteve për zhvillim të souferit për përcaktimin në kohë të masave të kontrollit të sigurisë që do të zbatohen për shkak të përmirësimit të menaxhimit me rreziqe dhe sigurinë kibernetike.

për realizimin e qëllimeve dhe detyrave të Bankës Popullore. Gjatë vitit 2021, **është monitoruar dhe raportuar rregullisht për ekspozimin e Bankës Popullore ndaj rreziqeve operative**. Raporti Vjetor¹²⁶ dhe raporti gjysëmvetor¹²⁷ për menaxhimin e rreziqeve operative janë shqyrtuar dhe miratuar nga Komiteti për menaxhim të rreziqeve operative, pas së cilës janë miratuar nga Këshilli i Bankës Popullore. Në fund të vitit 2021 filloi mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga vlerësimet e rreziqeve operative të njësive organizative për përgatitjen e Raportit vjetor të menaxhimit me rreziqet operative për vitin 2021¹²⁸. Qëllimi kryesor i këtij raporti është të paraqesë rezultatet e vlerësimit të thelluar të rreziqeve operative për vitin 2021. Raporti paraqet profilin e rrezikut të Bankës Popullore në lidhje me rreziqet operative, si dhe strategjitë dhe masat për menaxhimin e rreziqeve operative me qëllim të mbrojtjes nga ngjarjet që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave, rezultatit financiar dhe reputacionit të Bankës Popullore. Është konstatuar se Banka Popullore monitoron rregullisht ekspozimin ndaj rreziqeve operative dhe në mënyrë aktive menaxhon dhe zbaton masat dhe aktivitetet e përcaktuara, të cilat synojnë të sigurojnë zvogëlimin e rreziqeve të mundshme operative. Menaxhimi i rrezikut është një element i domosdoshëm i qeverisjes së mirë të korporatës që kontribuon në arritjen efikase dhe efektive të qëllimeve të përcaktuara strategjike, mandatit dhe vizionit.

Funksioni i pajtueshmërisë, në vitin 2021 vazhdoi me aktivitetet për zhvillimin dhe aplikimin e konceptit parandalues për arritjen e përputhshmërisë në Bankën Popullore. Në kuadër të funksionimit dhe burimeve të disponueshme, është kujdesur për përgjigjen në kohë dhe të duhur ndaj kërkesave, për të qenë shembull i punës së harmonizuar, për të kontribuar në mbrojtjen dhe ruajtjen e reputacionit dhe integritetit të institucionit, për funksionim efikas, komunikim të hapur dhe bashkëpunimin të brendshëm me njësitë organizative. Janë ndërmarrë aktivitete në fushën e edukimit dhe përforsimit të ndërgjegjësimit për parandalimin e paraqitjes eventuale të korrupsionit dhe konfliktit të interesit në Bankën Popullore. Në kuadër të shënimit të vitit 2021 si vit i luftës kundër korrupsionit në vend, me qëllim përfshirjen dhe demonstrimin e përkushtimit për parandalimin e korrupsionit dhe ndërmarrjen e veprimeve për parandalimin dhe uljen e rrezikut të korrupsionit, në Bankën Popullore në gusht të vitit 2021, u miratua Politika për parandalimin e paraqitjes së korrupsionit¹²⁹, zbatimi i mëtejshëm i së cilës kujdeset brenda institucionit nga funksioni i përputhshmërisë.

Gjithashtu janë dhënë mendime/rekomandime lidhur me zbatimin e rregullativave aktuale për pajtueshmërinë e të punësuarve/anëtarëve të Këshillit, si dhe është bërë shqyrtimi ex post i zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga ngacmimi në vend pune, në kuadër të të cilit janë dhënë rekomandime për përmirësim, sipas të cilave është vepruar në mënyrën e duhur. Një segment i rëndësishëm në veprimin parandalues ishte monitorimi i legjislacionit të ri dhe ndryshimeve të tij që ndikojnë në punën e Bankës Popullore dhe informimi i rregullt për të. Në të njëjtën kohë, funksioni i përputhshmërisë dha kontributin e tij duke përgatitur një analizë për projekt-zgjidhje konkrete ligjore, të cilat i referohen Bankës Popullore.

Varësisht nga nevojat e punës në Bankën Popullore, janë shqyrtuar edhe çështje juridike, për të cilat janë përgatitur mendimet përkatëse juridike, duke përfshirë edhe propozime për përmirësimin e funksionimit/rregullativës. Funksioni i përputhshmërisë edhe më tej do të vazhdojë të jetë i përkushtuar për zhvillimin e mëtutjeshëm të përputhshmërisë

¹²⁶ Ky raport ka të bëjë me menaxhimin e rrezikut operativ në vitin 2020.

¹²⁷ Ky është raporti i parë mbi monitorimin e rrezikut operativ në bazë gjysmëvjetori e cila është parashikuar me ndryshimet e fundit të Politikës për menaxhim me rreziqet operative nga tetori 2020, me qëllim intensifikimin e monitorimit të ekspozimit ndaj rreziqeve operative. Në të ëshët arsyetuar statusi i realizimit dhe aktivitetet e ndërmarra për zbatimin e masave për menaxhimin e rreziqeve operative të përcaktuara nga vlerësimi i thelluar vjetor i rreziqeve operative në vitin 2020.

¹²⁸ Raporti është miratuar në seancën e Këshillit të Bankës Popullore në fund të marsit 2022.

¹²⁹ P. nr. 02-15 / XIV-1/2021 më datë 26 gusht 2021.

në Bankën Popullore, veçanërisht si një mekanizëm shtesë të mbështetjes dhe forcimit të përputhshmërisë së të punësuarve dhe anëtarëve të Këshillit të Bankës Popullore.

12.5. Aktivitete të tjera të korporatës

Në sferën e **evidencave të kontabilitetit të transaksioneve, politikave kontabiliste dhe raportimit financiar, si dhe planifikimi dhe kontrolli**, Banka Popullore gjatë vitit 2021 i ka kryer aktivitetet në kohë dhe në përputhje me afatet e përcaktuara. Përkatësisht, është miratuar Politika për përzgjedhjen e një shoqate për auditim të jashtëm të raporteve financiare të Bankës Popullore¹³⁰, me çka formalizohet procesi i përzgjedhjes së një auditori të jashtëm në përputhje me rekomandimin e marrë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) gjatë realizimit të misionit në vitin 2020 (Safeguard Assessment Report, gusht 2020)¹³¹. Gjatë përgatitjes së Politikës për përzgjedhjen e shoqatës së auditimit, janë analizuar materiale nga disa institucione financiare, të cilat kanë kontribuar në perceptimin dhe njohjen më të madhe me proceset që kanë të bëjnë me auditimin dhe rolin mbikëqyrës të Komitetit të Auditimit. Në të njëjtën kohë, Banka Popullore ka bërë auditim të akteve për Komitetin e Auditimit dhe fushëveprimin e tij. Ky aktivitet lindi nga analiza e përbërjes së Komitetit të Auditimit dhe nevoja e respektimit të rekomandimeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira për rolin dhe detyrat e këtij organi në bankat qendrore. Detyrimet e llogaridhënies janë përmbushur rregullisht (përmes [raporteve vjetore financiare të Bankës Popullore](#) , [raporti i auditorit të pavarur](#) dhe bilanceve mujore) me zbatimin e standardve më të larta të transparencës dhe publicitetit gjatë raportit ligjor. Në vitin 2021, Banka Popullore i kushtoi vëmendje të veçantë projekteve që përmirësojnë zgjidhjet e kontabilitetit aplikativ për kryerjen e proceseve të planifikimit dhe punëve të integruara materiale.

Gjatë vitit 2021, **furnizimet publike** janë realizuar në mënyrë transparente dhe në kohë për shkak të funksionimit dhe punës së pandërprerë të Bankës Popullore, madje duke mbajtur llogari për përdorimin racional të mjeteve në Bankën Popullore. Vëmendje e veçantë i është kushtuar veprimit transparent, nxitjes së konkurrencës dhe ofrimit të trajtimit të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, si parime bazë të këtij procesi, të përcaktuara me ligj. Plani Vjetor për Furnizime Publike (PVFP) për vitin 2021 u publikua me kohë në Sistemin Elektronik për Furnizime Publike në janar 2021. Në përputhje me nevojat e Bankës Popullore, gjatë vitit 2021 janë zbatuar dy ndyshime në PVFP, edhe atë: në qershor (plotësuar me 1 furnizim publik të ri) dhe në dhjetor (plotësuar me 11 furnizime publike të reja). Raportimi i rregullt për zbatimin e planit vijonte në përputhje me aktet e brendshme, ashtu që kontrolleve mujore, janë përgatitur dhe prezantuar raportet e rregullta në baza tremujore, me paraqitjen e lëvizjet përmbledhëse për periudhën përkatëse, si dhe analiza e respektimit të afateve të planifikuara gjatë zbatimit të procedurave të caktuara dhe shkaqet për prolongimet eventuale. Gjatë vitit 2021, Byroja e Furnizimit publi ka kryer tre kontrolle administrative dhe në të tria nuk janë konstatuar parregullsi.

Mbështetja ligjore u zhvillua në mënyrë të rregullt dhe konsistente, nëpërmjet përgatitjes dhe/ose kontrollit të llojeve të shumta të akteve ligjore. Publikimi i rregullativave ligjore dhe nënligjore dhe akteve të përgjithshme të brendshme në Regjistrin e Rregulloreve në faqen e internetit të Bankës Popullore, si dhe përgatitja dhe publikimi i teksteve të spastruara të rregullativave është realizuar në bazë të rregullt.

¹³⁰ Politika për zgjedhjen e një shoqërie auditimi të jashtëm për raportet financiare të Bankës Popullore është miratuar nga Këshilli i Bankës Popullore në fillim të dhjetorit 2021.

Në fakt, emërimi i auditorit të jashtëm në Bankën Popullore bëhet në përputhje me Ligjin për Bankën Popullore dhe aktet e brendshme për furnizim publik. Edhe pse procesi i përzgjedhjes së një auditori të jashtëm i kryer nga Banka Popullore është i përshtatshëm, me Politin e përzgjedhjes së auditorit u formalizuan kriteret kryesore për përzgjedhje dhe rotacion të një auditori të jashtëm.

Aktivitetet për mirëmbajtjen teknike dhe sigurimin fizik janë zhvilluar në bazë të rregullt, me çka është mundësuar mbështetje dhe mirëmbajtje e nevojshme teknike për rrjedhën e vazhdueshme të proceseve të tjera të punës dhe sigurimin e funksionimit të pandërprerë. Pajisjet dhe të gjitha objektet janë mirëmbajtur në përputhje me standardet e punës. **Kanë mbetur në fuqi masat specifike në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë në kushtet e rrezikut të mëtejshëm të përhapjes së koronavirusit,** ku janë ndjekur dhe dhënë vazhdimisht masat, protokollet dhe rekomandimet e Qeverisë dhe Shtabit të Krizave të Bankës Popullore dhe u janë dhënë udhëzime për të punësuarit. Në aspektin e sigurisë vazhdimisht ndërmerren masa dhe aktivitete operative **të cilat mundësojnë mbajtjen e nivelit të duhur të sigurisë dhe mbrojtjes kundër zjarrit, menaxhimin dhe ruajtjen efikase të objekteve të Bankës Popullore,** dhe veçanërisht të atyre në të cilat kryhen aktivitetet e rregullta dhe krijimi i kushteve për ecurinë e pandërprerë të proceseve të punës.

Qëllimi strategjik 11 - Ruajtja e sistemi informativ stabil dhe përmirësimi i tij në përputhje me kapacitetet ekzistuese dhe standardet ndërkombëtare



Banka Popullore ndërmori të gjitha aktivitetet e nevojshme për **mirëmbajtjen e një sistemi informativ të sigurt dhe stabil,** me çka siguroi një shkallë të lartë të disponueshmërisë së sistemeve informative dhe mundësoi funksionimin të pandërprerë dhe zbatim të rregullt të detyrave të punës në të gjitha njësitë organizative në Bankën Popullore, pavarësisht kushtet jashtëzakonshme që vazhduan edhe në vitin 2021. Për shkak të efekteve të prolonguara nga pandemia Covid-19 në vend, të cilat ndikuan gjatë vitit 2021, Banka Popullore ofroi mundësi teknike për punë në distancë për proceset e punës që mund të kryhen pa praninë fizike në hapësirat e bankës dhe disponueshmërinë e aplikimet e nevojshme, për kryerjen e vazhdueshme të detyrave, me çka janë zvogëluar drejtpërdrejt kontaktet në mes punëtorëve në Bankën Popullore dhe ndihmuan në masat për parandalimin e përhapjes së koronavirusit. Me këtë mënyrë të veprimit u ruajtën resurset njerëzore kritike, të cilat mundësonin kryerjen e pandërprerë të detyrave aktuale dhe të jashtëzakonshme të punës dhe funksionimin e proceseve të punës.

Gjatë vitit 2021 është punuar në projekte të zhvillimit të softuerit dhe krahas aktiviteteve aktuale dhe jashtëzakonshme për shkak të krizës shëndetësore, është vazhduar në përmirësimin e infrastrukturës SWIFT, në përputhje me rekomandimet e SWIFT dhe procedurat e rregullta për mirëmbajtjen vjetore të pajisjeve dhe shërbimeve të nevojshme për punën e Bankës Popullore. Sa i përket ruajtjes së nivelit të lartë të sigurisë së informacionit përmes vendosjes dhe përmirësimit të masave për mbrojtje nga sulmet e mundshme informative, Banka Popullore ka kryer testimin e depërtimit të pajisjeve të bankës, e cila përfshinte testimin e serverëve, pajisjeve të rrjetit dhe aplikacioneve, ashtu që nuk është konstatuar asnjë mundësi për thyerje të sistemit nga jashtë. Përkundër asaj që u përmend, kanë vazhduar edhe kontrollet e brendshme, të cilat kontribuojnë në forcimin e sigurisë së bankës dhe përmirësimin e rregullt të serverëve, stacioneve të punës dhe pajisjeve të tjera të TI-së.